AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Analizë

e Tregjeve me Shumicë të Aksesit Broadband në Internet

dhe Linjave me Qira:

1. Tregu me shumice i aksesit ne nivel lokal ne vendndodhje fikse (WLA)
2. Tregu me shumice i aksesit ne nivel qendror per produkte te tregut te pergjithshem (WCA)
3. Tregu me shumice i aksesit me cilesi te larte ne vendndodhje fikse (WHQA);
4. Tregu me shumice i aksesit ne elementet passive te infratsruktures se rrjeteve ne nivel kombetar

Dokumenti Perfundimtar

Dhjetor 2016

(MIRATUAR ME VKD NR.2701, DATE 22.12.2016)

INDEKSI I PERMBAJTJES

I. PERMBLEDHJE **4**

II. HYRJE **11**

II.1 ANALIZAT E TREGUT TE AKSESIT BROADBAND DHE LINJAVE ME QIRA 2014 11
II.2 REKOMANDIMI I KE 2014/710/EU PER TREGJET PERKATES 13
II.3 PERCAKTIMI I SIPERMARRESVE ME FUQI TE NDJESHME NE TREG 14
I. Objektivat e Ligjit dhe kuadri rregullator *14*
II.Procesi i Konsultimit *15*
III. Bashkepunimi me Autoritetin e Konkurences *15*
IV. Struktura e Dokumentit *15*

III. ZHVILLIMET E TREGUT TE AKSESIT BROADBAND **17**

III.1 TREGU ME PAKICE I AKSESIT BROADBAND NE INTERNET 17
I.Numri i pajtimtareve te telefonise fikse dhe aksesit broadband *17*
II.Paketat e integruara (Bundles) *20*
III.Teknologjia *21*
IV.Shpejtesia e aksesit broadband *21*
V.Tarifimi i sherbimit te aksesit broadband *23*
VI.Pjeset e tregut *25*
III.2 INFRASTRUKTURA E RRJETEVE FIKSE DHE LINJAT ME QIRA 27
I.Fibra Optike *27*
II.Tubacione *31*
III.Linjat me qira dhe perdorimi i perbashket i infrastruktures pasive *32*

IV. ANALIZA E TREGJEVE ME SHUMICE TE AKSESIT LOCAL, QENDROR DHE ME CILESI TE LARTE **34**

IV.1 PERKUFIZIMI I TREGJEVE ME PAKICË 34
IV.2 PERKUFIZIMI I TREGJEVE ME SHUMICË 43
IV.3 ANALIZA PER FNT NE TREGJET ME SHUMICE 44

V. ANALIZA E TREGUT TE AKSESIT NE INFRASTRUKTURE PASIVE NE NIVEL KOMBETAR 46

V.1 PERKUFIZIMI I TREGUT 46
V.2. PANORAME E TREGUT ME SHUMICE TE AKSESIT NE INFRASTRUKTURE PASIVE NE NIVEL KOMBETAR 49
V.3. ZHVILLIME PAS KESHILLIMIT PUBLIK 55
V.4. PERFUNDIM PER ANALIZEN E TREGUT TE INFRASTRUKTURES PASIVE NDER-URBANE (KOMBETARE). 56

VI. MASAT RREGULLUESE PER FNT **59**

ANEKS 1: KOMENTET E KESHILLIMIT PUBLIK DHE QENDRIMI I AKEP **62**

INDEKSI I FIGURAVE DHE TABELAVE

TABELA II.1: TARIFAT MUJORE TE AKSESIT BITSTREAM TE ALBTELECOM 12
TABELA II.2: NDRYSHIMI I TREGJET PERKATES TE REKOMANDIMIT 2007 DHE 2014 TE KE 13
TABELA II.3: PERSHKRIMI I TREGJEVE ME SHUMICE REKOMANDIMI 2014 KE 13
FIGURA III.1 ECURIA E NUMRIT TË PAJTIMTARËVE TË TELEFONISE FIKSE 2000-2015 18
FIGURA III.2 – NORMA E PENETRIMIT TE TELEFONISE FIKSE 18
TABELA III.1 ECURIA E NUMRIT TË PAJTIMTARËVE TË AKESIT BROADBANDI NGA RRJETE FIKSE 2010-2015 .. 19
FIGURA III.3. ECURIA E PAJTIMATREVE TE TELEFONISE DHE TE AKSESIT BROADBAND NGA RRJETE FIKSE 20
TABELA III. 2: NUMRI I PAJTIMATRËVE ME SHËRBIME TË INTEGRUARA TË ALBTELECOM 20
FIGURA III.4: LIDHJET BROADBAND FIKS SIPAS TEKNOLOGJISE SHQIPERI V BE 2015 21
FIGURA III.5: SHPERNDARJA E PAJTIMTAREVE ME AKSES BROADBAND FIKS SIPAS SHPEJTESISE 2014-2015 .. 22
FIGURA III.6: KRAHASIMI I TARIFAVE MUJORE TE AKSESIT BROADBAND (STAND ALONE) 23
FIGURA III.7: KRAHASIMI I TARIFAVE MUJORE TE AKSESIT BROADBAND (TELEFONI DHE INTERNET) 23
FIGURA III.8: KRAHASIMI I TARIFAVE MUJORE TE AKSESIT BROADBAND (TELEFONI, INTERNET DHE TV) ... 24
FIGURA III.9 PJESËT E TREGUT SIPAS NUMRIT TË PAJTIMTARËVEME AKSES BROADBAND 25
FIGURA III.10 PJESËT E TREGUT AKSES BROADBAND SHQIPERI DHE BE 25
TABELA III.3: FIBRAT OPTIKE NDERURBANE TE OPERATOREVE NE SHQIPERI 27
FIGURA III. 11: FIBRA OPTIKE TE GJITHE OPERATORET 29
FIGURA III.12: FIBRAT OPTIKE TE ALBTELECOM DHE ATU 29
FIGURA III.13: FIBRAT OPTIKE NE TIRANE 30
TABELA III.4: TUBACIONE E RRJETEVE FIKSE 31
FIGURA III.14: TUBACIONE TE GJITHE OPERATORET 32
TABELA III.5: LINJAT ME QIRA DHE AKSESI NE INFRASTRUKTURE PASIVE (2014-2015) 32
TABELA V.1: AKSESI NE INFRASTRUKTURE PASIVE (2014-2015) 50
TABELA V.2: TARIFAT E AKSESIT NE TUBACIONE NE RRJETIN ALBTELECOM (2015-2016) 51
TABELA V.3: TARIFAT MUJORE TE AKSESIT NE TUBACIONE NE VENDET BE DHE RAJONIT 52
FIGURA V.1: TARIFAT MINIMALE MUJORE PER AKES NE TUB 52
FIGURA V.2: TARIFAT MAKSIMALE MUJORE PER AKES NE TUB 53

I. PERMBLEDHJE

Ligji nr.9918, date 19.05.2008 ”Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise” (i ndryshuar) ketu e me pas Ligji 9918 (i ndryshuar), ne nenin 1 te tij, percakton se: *Qëllimi i ligjit është që nëpërmjet parimit të asnjanësisë teknologjike të promovojë konkurencën dhe infrastrukturë efiçente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.*

Ky dokument perben versionin final te dokumentit te publikuar ne faqen web te AKEP per keshillim publik me palet e interesuara per nje periudhe 2 mujore me 15.06-15.08.2016. Dokumenti i nxjerre per keshillim publik permbante:

- perkufizimin e tregjeve perkatese te analizuar
- analize e konkurrences ne tregjet perkates dhe vleresimin nese ka operatore me fuqi te ndjeshme ne treg (FNT)
- masat rregulluese te propozuara per sipermarresit e vleresuar me FNT

Ne perfundim te keshillimit publik, ne AKEP kane depozituar komente disa pale te interesuara. Pas perfundimit te periudhes se keshillimit AKEP kreu takim me operatoret kryesore ne treg per te diskutuar mbi propozimet e AKEP dhe komentet e tyre. Komentet kryesore dhe qendrimi i AKEP per komentet jane publikuar si dokument me vete nga AKEP. Ky dokument perben versionin final te analizes se tregut per tregjet e marre ne shqyrtim, mbi te cilat bazohen dhe vendimet perkatese per FNT dhe masat rregulluese per FNT.

Ky dokument permban rishikimin e perfundimeve te dy dokumentave te analizes se tregjeve me shumice te aksesit ne broadband si dhe te linjave me qira, te kryera ne vitin 2014, duke marre ne konsiderate ri-perkufizmin e tregjeve perkates nga Komisioni Europian ne rekomandimin e vitit 2014. Tregjet e analizura nga AKEP ne vitin 2014 ishin:

1. Tregu me shumice i aksesit ne infrastrukturen e rrjeteve fizike (perfshire aksesin e ndare te pjesshem ose te plote) nga vendodhje fikse.
2. Tregu me shumice i aksesit broadband (bitstream).
3. Tregu me shumice i segmenteve terminuese te linjave me qira.

Per keto 3 tregje, AKEP percaktoi Albtelecom si sipermarres me FNT duke vendosur dhe masat perkatese rregulluese. Ne vijim te percaktimeve te Ligjit 9918 si dhe te Rregullores per Analizen e tregut, AKEP vlereson te arsyeshme ri-perkufizimin e tregjeve perkatese te lidhura me aksesin broadband duke marre ne konsiderate rekomandimin e vitit 2014 te KE. Bazuar ne kete rekomandim te KE si dhe ne kushtet e tregut te komunikimeve elektronike ne Shqiperi, tregjet perkates te analizuar ne kete dokument jane:

1. Tregu me shumice i aksesit ne nivel lokal ne vendndodhje fikse (WLA)
2. Tregu me shumice i aksesit ne nivel qendror per produkte te tregut te pergjithshem (WCA)
3. Tregu me shumice i aksesit me cilesi te larte ne vendndodhje fikse (WHQA);
4. Tregu me shumice i aksesit ne elementet passive te infratsruktures se rrjeteve ne nivel kombetar

Tregjet e mesiperm 1-3 jane pjese e rekomandimit te vitit 2014 te KE (tregjet me nr.3/a, 3/b dhe 4), ndersa tregu nr.4 me siper nuk eshte pjese e kesaj liste.

Ndryshime nga proceset e meparshme te analizave te tregut

Ne lidhje me masen rregulluese te kontrollit te tarifave te sipermarresve te percaktuar per status me FNT, AKEP ka zhvilluar nje proces te vecante keshillimi publik, ne perputhje me percaktimet e nenit 57 e ne vijim te Ligjit 9918, per te percaktuar metoden e kontrollit te tarifave te sipermarresve me FNT ne keto tregje perkates. Ky proces keshimi publik per rregullimin e tarifave te sipermarresin/sipermarresit me FNT zakonsiht eshte kryer ne te njejten kohe me keshillimin per dokumentin e analizes se tregut dhe masave rregulluese per FNT. Megjithate, AKEP edhe me pare ka kryer procese te vecanta keshillimi publik ne lidhje me specifikime te masave rregullatore si rregullimi i tarifave, orientimi ne kosto etj., te cilat nuk kane prekur perfundimet e analizave te tregut dhe masat rregulluese, por vetem metoda/specifikime te masave rregulluese.

Analiza e tregjeve perkates sipas perkufizimeve te reja (rekomandimi i KE 2014) kryhet per here te pare ne Shqiperi. Megjithate keto tregje jane te ngjashme me tregjet e analizuara ne vitet 2011 dhe 2014 nga AKEP, dhe lexuesi mund t'i referohet edhe Analizave te tregut te Shkurt 2014 per detaje me te hollesishme teknike. AKEP ka zgjedhur kete menyre thjeshtimi nga aspektet teknike te detajuara te dokumentit, me qellim fokusimin e lexuesit ne elementet me te rendesishem te rregullimit ex-ante te propozuar nga AKEP per stimulimin e sherbimeve te aksesit broadband ne Internet ne Shqiperi.

Tregu me pakice i aksesit broadband ne Shqiperi

Aksesi broadband ne Internet mund te sigurohet nga rrjete fikse dhe rrjete celulare. Te dy keto segmente kane pasur rritje te kenaqshme ne vitet e fundit. Tregu me pakice i aksesit broadband nga rrjete fikse ka pasur rritje te qendrueshme vjetore me 14-17% qe prej vitit 2010. Numri i pajtimtarëve me akses broadband fiks në fund të vitit 2015 arriti në rreth 243 mijë, që përbën një rritje me rreth 17% në krahasim me vitin 2014. Albtelecom dhe tre operatorët kryesorë alternativë patën rritje të numrit të pajtimtarëve me 5-18%. Për sa i përket pjesëve te tregut gjatë vitit 2015 nuk pati ndryshime të ndjeshme dhe Albtelecom vazhdon të zotërojë vetëm 40% pjesë tregu të numrit të pajtimtarëve me akses broadband.

Gjatë vitit 2015, numri i pajtimtarëve me shërbime të integruara në shporta triple play (Telefoni, Internet dhe TV), u rrit rreth tre herë në krahasim me vitin 2014. Albtelecom pati rritjen më të madhe të këtyre pajtimtarëve (me rreth 4 herë). Në fund të vitit 2015, 63% e pajtimtarëve me akses brodband të Albtelecom ishin pajtimtarë të shportave trefishe (Telefoni, Internet dhe IPTV). Te dhenat dhe ecuria e tregut tregojne se konkurrenca e operatoreve eshte e fokusuar ne paketat e integruara me 2 ose 3 sherbime, dhe IPTV eshte nje faktor nxites i rendesishem per rritjen e aksesit broadband fiks. Tarifat e paketave te integruara (bundles), te axhustuara sipas fuqise blerese (PPP Shqiperi dhe BE), jane te krahasueshme me tarifat mesatare te vendeve te BE.

Aksesi broadband nga rrjetet celulare nepermjet rrjeteve 3G/4G ka pasur rritje te konsiderueshme me fillimin e ofrimit te sherbimeve 3G ne 2010 dhe sidomos me 4G ne 2015. Numri i përdoruesve aktivë (përdorim ne 3 muajt e fundit) të shërbimeve me akses broadband nga rrjetet celulare 3G/4G në vitin 2015 ishte rreth 1.4 milion apo 43% më shumë se në vitin 2014. Rritja e ndjeshme e përdorimit të aksesit broadband nga rrjetet 3G/4G është vënë re sidomos në tremujorin e tretë 2015, që përkon me fillimin e ofrimit të shërbimeve në rrjetet 4G. Rritja e përdorimit të aksesit broadband nga rrjetet celulare 3G/4G në vitet e fundit vihet re dhe në rritjen e volumit të të dhënave të transmetuara në rrjetet celulare. Në vitin 2014 rritja vjetore e trafikut të të dhënave në rrjetet celulare ishte 148%, dhe kjo tendencë vazhdoi edhe në vitin 2015 ku rritja vjetore ishte 100%.

Megjithe zhvillimet pozitive te aksesit broadband fiks nder vite (rritje e numrit te pajtimtareve, zonave te mbulimit te Operatoreve Alternative (OA), zhvillimeve ne NGA/NGN, reduktimit te tarifave, rritjes se shpejtesise se aksesit etj), norma e penetrimit e pajtimtarëve me akses broadband fiks për popullsi dhe për familje në fund të vitit 2015 ishte 9% dhe 33% përkatësisht, qe jane shume me te uleta se ne vendet e BE dhe rajonit. Ky nivel penetrimi i ulet eshte i lidhur dhe me shkaqe historike, si niveli i ulet historik i mbulimit me rrjete telefonike fikse, perfshire dhe rritjen e madhe te sherbimeve celulare dhe efektin zevenduesues te tyre.

Nderkohe ne segmentin e aksesit broadband nga rrjetet celulare, Shqiperia megjithese kishte vonese ne fillimin e ofrimit te sherbimeve 3G/4G (dhe brezi 800 MHz nuk eshte ende ne dispozicion te operatoreve celulare per 4G), hendeku i perdorimit te ketyre sherbimeve ne Shqiperi krahasuar me nivelin mesatar te BE eshte ngushtuar ndjeshem ne vitin 2015.

Bazuar ne kushtet lokale te zhvillimit te konkurrences ne sherbimet e aksesit broadband ne Internet (rrjete fikse dhe celulare), si dhe per arritjen e objektivave te Ligjit 9918 dhe Strategjise Dixhitale te Shqiperise, AKEP vlereson se stimulimi i perdorimit te sherbimeve te aksesit broadband me pakice nga konsumatoret dhe bizneset eshte i nevojshem dhe mund te realizohet, pervec stimulimit ne anen e kerkeses (e-governemnet etj), edhe nepermjet masave rregulluese ex-ante ne nivel me shumice, te cilat adresojne problemet me te cilat ndeshen operatoret e komunikimeve elektronike ne ofrimin e ketij sherbimi per perdoruesit fundore nga rrjete fikse dhe celulare. Adresimi i problemeve/deshtimeve te tregut do te mundesoje nje rritje me te madhe te konkurrences midis operatoreve ne tregun me pakice dhe perfitimeve te perdoruesve fundore nga keto sherbime.

Analiza e tregjeve me shumice te aksesit ne te dhena dhe sherbimet e lidhura me to nga vendndodhje fikse

AKEP, bazuar ne rekomandimin e vitit 2014 te KE per tregjet perkates, ne Rregulloren e Analizes se tregut, si dhe ne kushtet e tregut ne Shqiperi, ka vleresuar si te arsyeshme qe te analizoje ne nje dokument te vetem, tregjet me shumice te inputeve qe kane lidhje me tregun me pakice te aksesit broadband ne Internet, duke e fokusuar edhe ne elementet pasive te infrastruktures se rrjeteve te komunikimeve elektronike, si tubacione dhe fiber e pandricuar (dark fiber).

1. Tregu me shumice i aksesit ne nivel lokal ne vendndodhje fikse (WLA)

Ky treg eshte i ngjashem me tregun e aksesit fizik ne infrastrukture te rrjetit fiks per LLU, por duke perfshire dhe akses virtual kur LLU nuk eshte e mundur.

Per aksesin ne infrastrukturen fizike (LLU) si sherbime me shumice, disa nga ceshtjet kryesore qe lidhen me perkufizimin e produkteve/sherbimeve qe bejne pjese ne kete treg perkates, jane:

- Ndertimi i rrjetit lokal te aksesit nga operatori ne vend te perdorimit te aksesit te hapur ne rrjetin incumbent (LLU);
- Akses LLU v Bitstream
- Vetfurnizimi;

Ne lidhje me perkufizimin e tregut, AKEP arrin ne perfundimin se:

- Ky treg perkates (WLA) perfshin te gjitha sherbimet/produket fizike dhe virtuale te cilat mundesohen nga aksesi ne nivel lokal (shared + full LLU, tubacione ne zona urbane etj), produkte dhe sherbime te cilat mundesojne perfituesin e aksesit te ofroje sherbime broadband perdoruesve te tregut masiv dhe me nivel te larte kontrolli ne QoS;
- Dimensioni gjeografik i tregut eshte kombetar, pavaresisht se ka variacion te madh te konkurrences/prezences me rrjete lokale te aksesit midis zonave te ndryshme gjeografike (qytete kryesore si Tirana v qytete te vogla)

Ne lidhje me aksesin e hapur ne qarkun lokal (LLU), AKEP ka percaktuar Albtelecom si operator me FNT duke vendosur detyrime per LLU qe ne vitin 2011, perfshire edhe detyrime per dhenie aksesi per LLU ne rrjetin NGA. Megjithe prezencen e masave rregullatore perkatese, rregullimin e cmimeve te aksesit, publikimi i ofertes reference RUO, etj., per produktet e LLU rezulton se nuk ka pasur interes nga operatoret. Nje nder arsyet kryesore te mungeses se interesit per LLU, vleresohet se eshte zoterimi nga operatoret alternative i rrjeteve te tyre te lokale aksesit, praktike qe eshte shume pak e ndeshur ne vendet e tjera per shkak te kostove te larta te ndertimit te ketij rrjeti.

Megjithese LLU nuk ka dhene rezultate ne keto 4-5 vite, AKEP vlereson qe me ri-perkufizmin e ketij tregu (qe tashme perfshin edhe aksesin virtual), si dhe me objektivin e normalizimit te ndertimit te rrjeteve lokale (reduktimin e kostove qe vjen nga shume rrjete paralele te aksesit lokal) te percaktoje **Albtelecom si operator me FNT ne tregun me shumice te aksesit ne nivel lokal (WLA)**.

Detyrimet e propozuara per FNT te Albtelecom ne WLA:

- Mos-diskriminim
- Transparence
- Akses per LLU ne nivel MSAN (detyrimet e Analizes 2014),
- Akses ne infrastrukturen fizike (tubacione/shtylla per lidhje te POI me MSAN per te lidhur klientet broadband)
- Kontroll/rregullim i tarifave te LLU dhe aksest ne tuba ne nivel lokal

Ne lidhje me aksesin ne tubacione ne nivel lokal, Albtelecom ka pasur detyrime per te dhene akses ne kuader te LLU dhe migrimit ne NGA, por pa detyrim te rregullimit te tarufave te tyre. Megjithe, reduktimin e ndjeshem te tarifave te aksesit ne tuba nga Albtelecom ne Shtator 2016, AKEP gjykon se keto tarifa duhet t ejene objekt kontrolli dhe rregullimi nga AKEP. Gjithashtu, Albtelecom do te duhet te perfshije keto tarifa te tubacioneve si dhe kushtet dhe procedurat e dhenies se aksesit ne tubacione per aksesin local ne oferten reference RUO.

Ne lidhje me aksesin virtual ne nivel lokal, AKEP gjykon se ky detyrim do te ishte jo-proporcional per Albtelecom per shkak te menyres se zhvillimit te rrjeteve fikse ne Shqiperi, si dhe perfitimeve te uleta nga ekonomite e shkalles.

2. Tregu me shumice i aksesit ne nivel qendror per produkte te tregut te pergjithshem (WCA)

Ne lidhje me perkufizimin e tregut, arrihet ne perfundimin se ky treg perfshin:

- Te gjitha sherbimet/produket fizike dhe virtuale si aksesi bitstream, te cilat i mundesojne perfituesit te aksesit te ofroje sherbime broadband perdoruesve ne zona te

ndryshme/te medha gjeografike per tregun masiv te aksesit broadband me pakice, te cilat nuk mundesohen nga aksesi ne nivel lokal.
- Dimensioni gjeografik i tregut eshte kombetar;

Nga analiza per kete treg, AKEP vlereson se **Albtelecom permbush kriteret per FNT ne kete treg.**

Detyrimet e propozuara per Albtelecom per WCA:

- Mos-diskriminim
- Transparence te tarifave dhe sherbimeve (publikim i tyre)
- Detyrime per akses bitstream (vazhdim i detyrimeve te analizes 2014)
  Albtelecom duhet te jape akses bitstream ne minimumi 12 pika ne rajonet kryesore te Shqiperise, sipas adresave aktuale te Pikave te Interkoneksionit (POI) te perfshira ne RIO/RUO
- Kontroll/rregullim i tarifave te aksesit bitstream

Ky eshte nje sherbim ne Nivel 2 (Layer 2) per ethernet Bitstream dhe Nivel 3 (Layer 3) per IP Bitstream dhe rezulton te kete pasur interes nga operatoret pasi mundeson ofrimin e sherbimeve ne nivel me pakice nje numri te madh te pajtimtareve nepermejt aksesit ne nje ose disa pika dorezimi (PoH) rajonale/kombetare, pra duke mundesuar ekonomi shkalle shume me te larta se aksesi ne nivel lokal.

3. Tregu me shumice i aksesit me cilesi te larte ne vendndodhje fikse

Tregu me pakice per sherbime me cilesi te larte perfshin produkte/sherbime qe jane te projektura per nevojat specifike te klienteve individuale duke perfshire nivele te larta te QoS, disponibilitet te larte, shpejtesi te larta download dhe upload, nivel te ulet te konfliktit (contention) ne transmetimin e te dhenave, etj. Keto jane sherbime qe kerkohen nga biznese te medha dhe qe kerkojne edhe lidhjen midis pikave te ndryshme te prezences se biznesit, dhe qe zakonisht ofrohen nepermjet linjave me qira apo lidhjeve broadband (LLU, ethernet etj). Ne kete treg me pakice perfshihen edhe institucionet publike me prezence ne shume qytete/fshatra qe kane nevoje per lidhje te ketyre pikave te prezences, kerkese e cila pritet te rritet me rritjen e dixhitalizmit te sherbimeve dhe games dhe cilesise se sherbimeve e-government.

Tregu i aksesit me cilesi te larte ne vendndodhje fikse eshte i lidhur me ofrimin e konektivitetit te bizneseve te mesme/te medha per akses broadband dhe sherbime te tjera te dhenash. Ne nivel me shumice ne rekomandimet e meparshme te KE, ky treg eshte perkufizuar si tregu i segmenteve terminuese te linjave me qira, nepermjet te cilave operatore te ndryshem kane mundesine te ofrojne sherbime me cilesi te larte bizneseve, pasi linjat me qira sigurojne bivele te larta QoS, bandwidth simetrik dhe te dedikuar.

Nga analiza e kryer, AKEP gjykon se Albtelecom permbush kriteret per FNT.

Detyrimet e propozuara per Albtelecom per WHQA:

- Mos-diskriminim
- Transparence te tarifave dhe sherbimeve (publikim i tyre)
- Detyrime per akses per linjat me qira (vazhdim i detyrimeve te analizes 2014)
- Detyrime per akses ne linja me qira ne nivel kombetar/lidhje nderurbane dhe local (segmented terminuese)
- Kontroll/rregullim i tarifave te aksesit ne tubacione/linja me qira

4. Tregu me shumice i aksesit ne infrastrukture pasive ne nivel kombetar

Rregullimi i aksesit ne elementet pasive te rrjeteve (tuba, shtylla, dark fibre etj) ka marre nje rendesi te vecante edhe ne nivel komunitar te BE, pasi ky akses mundeson zgjidhje per akses broadband me shpejtesi te larte dhe ne reduktim te kostove ketij sherbimi. KE ne Direktiven vitit 2014 (Directive 2014/61/EU), e njohur si Direktiva e reduktimit te kostove broadband, ka rekomanduar madje perdorimin e infrastruktures se rrjeteve te tjera te utiliteteve si energji elektrike, uje etj, per zhvillimin e rrjeteve broadband.

AKEP ne dokumentin e nxjerre ne keshillim publik, pervec rregullimit te aksesit ne tubacionet e Albtelecom ne rrjetin lokal (pjese e detyrimeve te WLA), propozoi rregullimin ex-ante te aksesit ne infrastrukture pasive ne nivel kombetar: tubacione dhe fiber optike e pandricuar ne akset e rrugeve kombetare (lidhjet nder-urbane) per Albtelecom dhe ATU.

Ne vijim te komenteve te keshillimit publik dhe zhvillimeve te ndodhura gjate kesaj periudhe, AKEP vleresoi si te arsyeshme qe te ri-konsideronte perfundimet per kete treg, nder te tjera per arsyet e meposhtme:

- Informacioni per infrastrukturen pasive (tubat) eshte marre nga Atlasi i AKEP sipas deklarimeve te operatoreve, por ky informacion rezulton te jete i kufizuar (nuk ka detaje per numrin e tubave ne nje interval te caktuar, apo per kapacitetin e lire ne tub, nuk ka ndarje ne zone urbane dhe inter-urbane etj.);
- Nje nder problemet kryesore te evidentuara ne dokumentin e keshillimit publik, niveli i larte i tarifave te aksesit ne tubacione te Albtelecom, eshte zbutur ndjeshem per shkak te reduktimit te madh (rreth 50%) te tarifave nga vet Albtelecom duke filluar nga muaji Tetor 2016;
- Rregullimi i aksesit ne tuba ne zonat kombetare/nder-urbane duket se eshte i parakohshem ne kushtet kur ne BE ky rregullim eshte i kufizuar ne zona lokale (rrjeti lokal) dhe kur ende ne AKEP nuk ka pasur kerkesa per zgjidhje mos-marrveshje midis operatoreve per kete lloj aksesi.
- Faktore te rendesishem ne perdorimin dhe kerkesen e kufizuar te tubave rezultojne te jene:
    - shume operatore zhvillojne rrjetet lokale me rrjet ajror si metode me cmim me te ulet fillestar;
    - ne zona kombetare operatoret mbeshteten fuqishem ne perdorimin e radiofrekuencave (ka perdorim shume te larte te radiofrekuencave mikrovalore).
    - Sherbimet e infrastruktures aktive (si linja me qira, lidhjet ethernet LAN etj) rezultojne te jene aktualisht alternativa me ekonomike, pasi aksesi ne tuba, pervec qirase mujore kerkon investime te tjera te medha si blerjen dhe instalimin e fibres optike dhe terminaleve perkates qe kane kosto te larta fillestare.
- Perdorimi i perbashket i tubave ne Shqiperi, rezulton se eshte nje sherbim qe eshte ne fillimet e veta, dhe eshte ende shume shpejt per te arritur ne konkluzione mbi deshtimin e ketij tregu. Ofrues te tjere te mundshem te aksesit ne infrastrukture pasive ne nivel kombetar, pervec Albtelecom dhe ATU jane dhe sipermarres ne sektore te tjere te ekonomise si operatori i transmetimit te energjise elektrike, ofrues te rrjeteve te ujesjellesit, autoritete rrugore dhe bashkite.
- Me 24.11.2016, Kuvendi i Shqiperise miratoi Ligjin Nr. 120/2016 "*Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit*". Ky ligj ka për qëllim të lehtësojë e nxisë ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë (broadband), dhe synon te rregulloje jo vetem aksesin ne infrastrukturen e rrjeteve te sipermarresve te komunikimeve elektronike por edhe aksesin ne llojet e tjera te infrastruktures qe zoterohen nga sipermarres ne sektore te tjere si energji, uje,

transport rrugor etj, dhe qe mund te perdoren per rrjetet e komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë. Ligji ne nenin 7 permban procedura per zgjidhjen e mosmarrveshjeve në rast refuzimi të së drejtës për akses në infrastructure dhe ne piken 6 te ketij neni, parashikon qe metodologjia e përcaktimit të çmimit dhe çmimet referuese (per aksesin ne infrastrukturen pasive) miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës. Çmimet referuese rishikohen periodikisht, por jo më pak se çdo dy vjet.

AKEP vlereson se perdorimi individualisht apo ne kombinim i procedurave te zgjidhjes se mosmarrveshjeve dhe transparences se tarifave sipas percaktimeve te ligjit 9918, Rregullores se AKEP me Nr.35, Datë 10.07.2015, "*Rregulla për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike*", Rregullores me Nr. 27 datë 21.09.2012 "*Mbi Publikimin e informacionit për tarifat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike",* si dhe percaktimeve te Ligjit Nr. 120/2016 "*Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit*", perfshire informacionin per tarifat e aksesit ne tuba dhe rregullimit te tyre ne nivel lokal/urban, jane aktualisht te mjaftueshme per adresimin e problematikes se mundshme per aksesin ne tuba ne nivel kombetar (zonat nder-urbane) ne rrjetet e operatoreve me FNT ose jo. Keto detyrime jane simetrike dhe aplikohen edhe per ATU, pavaresisht percaktimeve te lejes se dhene nga Ministria e Transportit dhe Puneve Publike ne vitin 2010.

AKEP do te rimarre ne shqyrtim kete treg ne nje periudhe afatmesme 1-2 vjecare per te pare zhvillimet dhe efektivitetin e zbatimit te akteve ligjore dhe nen-ligjore te cituara me siper, dhe nese eshte e nevojshme rregullimi ex-ante i ketij tregu.

II. HYRJE

II.1 Analizat e tregut te aksesit broadband dhe linjave me qira 2014

Në analizat pararendëse te vitit 2014, AKEP identifikoi dhe analizoi tre tregje të dyshuar për ndërhyrje ex ante në lidhje me shërbimin e aksesit në të dhëna nga rrjetet fikse.

1) Tregu me shumice i aksesit ne infrastrukturen fizike te rrjeteve nga vendodhje fikse (perfshire aksesin e plote dhe te perbashket-LLU);
2) Tregu me shumice i aksesit broadband (bitstream);
3) Tregu me shumice i segmenteve terminuese te linjave me qira.

Keto tregje u analizuan ne dy dokumenta te ndryshem te publikuar ne te njejten kohe, dhe ne perfundim te procesit te ketyre analizave ne Shkurt 2014, AKEP percaktoi Albtelecom sipermarres me FNT ne tre tregjet perkates me shumice te cituar me siper. Ne lidhje me masat rregulluese per keto tregje, AKEP vendosi per tregun 1 dhe 3 me siper.

- Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39)
- Detyrimi i transparencës (Neni 40)
- Detyrimi për ndarjen e llogarive (Neni 41)
- Detyrimi për akses dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42)
- Detyrimi për kontroll të tarifave dhe sistemin e mbajtjes së llogarive (Neni 45)

Ne lidhje me tarifat per LLU, Albtelecom duhet te aplikoje tarifat e miratuara me VKD nr.1365, date 13.04.2011, duke saktesuar qe per linjat e aksesuara ne MSAN per LLU, Albtelecom te aplikoje tarifat perkatese te aksesit (te plote dhe te perbashket) në **<u>nën-rrjetin lokal.</u>**

Ne lidhje me segmentet terminuese te linjave me qira Albtelecom do te duhet te jape akses per linja me qira me shumice ne rrjetin e vet, linja te cilat perfshijne:

- Linja me qira me shumice (end-to-end);
- Qarqe te pjesshme me qira (Leased line partial Cirquits);
- Linja me qira me shumice mbi Ethernet ne rrjet tradicional dhe/ose NGN;
- Akses ne linja me qira per lidhje te nyjes se agregimit te linjave lidhese te MSAN-ve me MSAN, si sherbim ndihmes per operatorin qe kerkon akses ne MSAN per LLU.

Tarifat e Albtelecom per kapacitetet me qira Ethernet ne rrjet tradicional dhe Ethernet ne NGN duhet te mos jene me te larta se tarifat e percaktuar ne Analize 2014 dhe te jene te pakten 20% me te lira se tarifat sherbimeve respektive me pakice.

Ne lidhje me detyrimet per FNT ne aksesin bitstream, AKEP vendosi detyrimet e meposhteme:

- Detyrimi per Aksesin (sipas *nenit 39 te* ligjit 9918);
- Detyrimi per mos-diskriminim (sipas *nenit 40 te* ligjit 9918);
- Detyrimi per transparence (sipas *nenit 42 te* ligjit 9918);
- Detyrimi per kontroll tarife (neni 45/57 i Ligjit 9918)

Albtelecom ka detyrimin te jape akses me shumice broadband (bitstream) ne nivel ATM/Ethernet dhe ne nivel IP, pra ne layer 2 dhe 3 te rrjetit NGN/NGA. AKEP hoqi detyrimin e Albtelecom per akses bitstrean ne nivel DSLAM, pasi ky akses eshte shume i perafert me aksesin per LLU. Detyrimi per kontroll te tarifave te sherbimeve te akses bitstream, u vendos sipas metodes “retail minus”, si me poshte:

Niveli i aksesit	Cmimi Maksimal
Ne nivel ATM/Ethernet;	Retail – 50%
Ne nivel IP	Retail -30%

Shenim: Tarifa retail me pakice pa TVSH

Cmimi per akses bitsream nuk mund te jete me i lire se cmimi per akses ne LLU. Ne vijim te argumentit ne pjesen e analizes per LLU, cmimi (tarifa mujore) per akses bitsteram nuk mund te jete me i ulet se 407 lek/muaj.

LLU

Ne lidhje me LLU, Albtelecom ka publikuar oferten reference RUO qe prej vitit 2012 dhe perditesuar disa here, perfshire pas vendimeve te vitit 2014. Megjithate, interesi per LLU ka qene i kufizuar dhe asnje operator nuk ka lidhur marrveshje me Albtelecom per akses ne linjat e bakrit te qarkut local (LLU i plote ose i pjesshem). Kjo mungese interesi per LLU rezulton te vije disa arsye:

- shumica e ofruesve te sherbimit te Internetit jane edhe operatore te rrjeteve fikse me rrjetin e vet lokal;
- disa nga operatoret kryesore ne treg jane operatore kabllore (rrjet local me kabllo koaksiale) dhe nuk jane te interesuar per linja bakri;
- migrimi i plote ne rrjetin NGA nga Albtelecom ka cuar ne numer shume te madh pikash aksesi per LLU (kabinetet ne rruge) krahasur me rrjetin tradicional PSTN (pika e aksesit ne central local).

Aksesi bitstream

Albtelecom ka publikuar oferten reference te aksesit bitstream dhe ka kryer 2 here rishikim te tarifave duke bere reduktime deri ne 90% te tyre krahasuar me tarifat fillestare. Ne Shtator 2016 Albtelecom ka njoftuar nje reduktim tjeter te tarifave te aksesit bitstream, me tarifat e reja qe hyjne ne fuqi me 1 Tetor 2016. Reduktimet e muajit Tetor 2016 variojne nga 7% per aksesin bitstream per shpejtesi 6 Mbps ne 17% per aksesin bitstream me shpejtesi 12 dhe 16 Mbps, dhe aplikohen per aksesin ne Ethernet dhe IP, per me pak se 100 porta dhe mbi 100 porta. Per sherbimet e aksesit bitstream, Albtelecom ka lidhur marrveshje me 4 operatore ne 2014-2015. Nga te dhenat rezulton se ne vitin 2014 Albtelecom ka dhene akses bitstream operatoreve te tjere per lidhje me 597 kliente, ndersa deri ne fund te 2015 per 1981 kliente.

TABELA II.1: TARIFAT MUJORE TE AKSESIT BITSTREAM TE ALBTELECOM (TETOR 2016)

	Opsioni 1: Bitstream ne Ethernet		Opsioni 2: Bitstream ne IP	
Shpejtesia Download	deri 100 porta	>100 porta	deri 100 porta	>100 porta
2 Mbps	468	421	549	494
4 Mbps	623	560	731	658
6 Mbps	766	690	900	810
8 Mbps	1,020	920	1,200	1,080
10 Mbps	1,100	990	1,292	1,163
12Mbps	1,213	1,090	1,425	1,283
16 Mbps	1,395	1,260	1,640	1,470

Shenim: Tarifat ne Lek pa TVSH

Linjat me qira

Ne permbushje te detyrimeve rregullatore per transparence dhe mos-diskriminim Albtelecom

ne Korrik 2015 perditesoi Oferten Reference, per tarifat e sherbimit te aksesit te linjave meqira, perditesim ky i cili konsistoi ne nje reduktim te ndjeshem me 70%-90% te tarifave per keto sherbime. Megjithe reduktimet e tarifave edhe per keto sherbime ka pasur interes te ulet nga ana e operatoreve, dhe Albtelecom ka lidhur vetem nje marrveshje me Abcom ne vitin 2015, per kapacitet transmetimi SDH 2xSTM1 dhe 1xE1. Nderkohe interesi me i madh per kapacitete transmetimi rezulton se eshte ne kuader te linjave te interkoneksionit, ku Albtelecom ka dhene kapacitete te linjave me qira per 23 operatore.

II.2 Rekomandimi i KE 2014/710/EU per tregjet perkates

Referenca ne analizat e tregut ne vitin 2014 ishte rekomandimi i vitit 2007 te KE (2007/879/EC) si dhe kushtet e tregut Shqiptar. Ne rekomandimin e vitit 2014 (2014/710/EU) per tregjet perkates, KE kreu nje rishikim te ketyre tre tregjeve ne lidhje me pershkrimin/perkufizimin e tyre duke percaktuar dhe ndarje te reja te kufijve te ketyre tregjeve si dhe produkteve dhe sherbimeve qe bejne pjese ne keto tregje perkates me shumice:

TABELA II.2: NDRYSHIMI I TREGJET PERKATES TE REKOMANDIMIT 2007 DHE 2014 TE KE

Rekomandimi 2007	Nr.	Rekomandimi 2014	Nr.
Tregu me shumice i aksesit (fizik) ne infrastrukure rrjeti ne vendndodhje fikse (perfshire LLU)	4	Tregu me shumice i aksesit ne nivel lokal ne vendndodhje fikse (WLA)	3a
Tregu me shumice i aksesit broadband	5	Tregu me shumice i aksesit ne nivel qendror per produkte te tregut te pergjithshem (WCA)	3b
Tregu me shumice i segmenteve terminuese te linjave me qira	6	Tregu me shumice i aksesit me cilesi te larte ne vendndodhje fikse	4

Keto tre tregje ne rekomandimin e 2007 ishin te perkufizuara ne baze te teknologjise dhe topologjise se rrjetit (hapja fizike e rrjetit local (LLU), bitstream dhe linja me qira), ndersa perkufizimet e reja te vitit 2014 kane bere nje strukturim te tyre bazuar ne:

- Funksionalitetin e menyres se aksesit, dhe jo menyren teknologjike te dhenies se tij;
- Ndryshimet ne nevojat e tregut me pakice te konsumatoreve dhe SME-ve krahasuar me kompanite e medha

TABELA II.3: PERSHKRIMI I TREGJEVE ME SHUMICE REKOMANDIMI 2014 KE

	Tregu me shumice i aksesit ne nivel lokal ne vendndodhje fikse (WLA)	Tregu me shumice i aksesit ne nivel qendror per produkte te tregut te pergjithshem (WCA)	Tregu me shumice i aksesit me cilesi te larte ne vendndodhje fikse
Mundeson	- Me shume kontroll per perfituesin e aksesit - Aksesi normalisht ofrohet ne centralin local ose me afer perdoruesit - Sherbim me kapacitet transmetimi uncontended - Nivel te mjaftueshem kontrolli dhe aksesi eshte zevendesues funksional i LLU (perfshire kontrollin ne CPE dhe cilesine e	- Nivel me i ulet dhe me i standartizuar kontrolli per perfituesin e aksesit - Aksesi normalisht ofrohet ne nivel rajonal ose kombetar	- Disponueshmeri e garantuar dhe sherbime me cilesi te larte - Menaxhim me cilesi te larte i rrjetit, perfshire backhaul - Akses ne rrjet ne pikat qe i duhen biznesit dhe jo perdoruesve te tregut masiv

	sherbimit)		
Zgjidhjet tipike	- LLU - WDM (nese eshte e aplikueshem) - VULA (nese ploteson funksionalitetin e nevojshem)	- Bitstream - VULA - Produkte te aksesit jo-fizik ose virtual me cilesi te permiresuar sherbimi te cilat mund te perdoren per te ofruar sherbime me pakice per perdoures biznesi qe nuk jane pjese e tregut nr.4/2014.	- Linjat me qira

Burimi: Cullen International

II.3 Percaktimi i sipermarresve me Fuqi te Ndjeshme ne Treg

I. Objektivat e Ligjit dhe kuadri rregullator

Ligji nr.9918, date 19.05.2008 ”Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise”, i ndryshuar, (ne vijim Ligji 9918), ne nenin 1 te tij, percakton se qëllimi i ligjit është që nëpërmjet parimit të asnjanësisë teknologjike të promovojë konkurrencën dhe infrastrukturë efiçente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.
Neni 7 i Ligjit 9918, Objektivat Rregullatore, percakton midis te tjerave se AKEP nxit konkurrencën efiçente për sigurimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, facilitetet shoqëruese dhe shërbimet e tjerapër t’u krijuar mundësinë çdo kategorie përdoruesish të shërbimeve të komunikimeve elektronike, përfshirë edhe përdoruesit me aftësi të kufizuara, të kenë përfitime maksimale nga aksesi në shërbimet e komunikimeve elektronike, në kuptimin e zgjedhjes së çmimit dhe cilësisë.
Kapitulli VI, Rregullimi i Konkurrences, permban percaktimet per rregullimin e konkurrences ne tregun e komunikimeve elektronike, dhe perfshin ndermjet te tjerave detyrimin e AKEP per kryerjen e analizes se tregut per vleresimin e konkurrences efektive dhe percaktimin e sipermarresve me fuqi te ndjeshme ne treg. Kreu VI, permban gjithashtu kriteret e perdorura nga AKEP per vleresimin e fuqise se ndjeshme ne treg, detyrimet/masat rregulluese ne rast te gjetjes se FNT.
Pika 4 e nenit 31, parashikon detyrimin per nje rregullore per analizen e tregjeve dhe percaktimin e FNT. AKEP me vendimin Nr.747, date 17.07.2009, ka miratuar Rregulloren per Analizen e Tregjeve (ne vijim referuara si Rregullorja), dhe me Vendimin nr.2342, date 31.07.2013 ka miratuar amendime te kesaj Rregulloreje. Rregullorja percakton midis te tjerave nje liste prej 7 tregje per tu analizuar nga AKEP per FNT, si dhe detyrimin per te kryer analizen e tre kritereve per tregjet qe nuk jane pjese e rekomandimit Rekomandimit te Komisionit Europian, te viti 2007.
Ligji 9918 eshte ne linje me direktivat e KE te vitit 2003 dhe 2009 dhe metodologjia e analizes se tregjeve e percaktuar ne Ligj dhe ne Rregullore, percakton se AKEP duhet te marre ne konsiderate rekomandimet e Komisionit Europian dhe BEREC.

Disa nga Rekomandimet dhe udhezimet e KE dhe BEREC (me pare ERG) te marra ne konsiderate nga AKEP jane si më poshtë:

- Udhëzuesi e komisionit për analizën e tregut dhe vlerësimin e FNT (2002/C 165/03) sipas kuadrit rregullator për komunikimet elektronike, rrjetet dhe shërbimet të komunikimit elektronik (ne vijim referuar si Udhezimi i KE);

- Rekomandimi i Komisionit, datë 17 Dhjetor 2007 për produktet dhe shërbimet përkatëse brenda sektorit të komunikimeve elektronike të rregulluara *ex ante* në përputhje me Direktivën 2002/21/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit në një kuadër të përgjithshëm rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik (2007/879/EC, OJ L 344, 28.12.2007);

- Rekomandimi i Komisionit, datë 9 Tetor 2014 për produktet dhe shërbimet përkatëse brenda sektorit të komunikimeve elektronike të rregulluara ex ante në përputhje me Direktivën 2002/21/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit në një kuadër të përgjithshëm rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik (2014/710/EC);

II.Procesi i Konsultimit

Ligji Nr.9918, parashikon ne Nenin 35 te tij, proceduren e keshillimit me palet e interesit per analizen e tregut duke vendosur si afat nje periudhe kohore prej 60 ditesh. Njekohesisht neni 36 percakton se AKEP vendos, ndryshon,mban ose heq detyrime per FNT pas keshillimit me palet e interesuara. Versioni draft i ketij dokumenti u publikua ne faqen e Internetit te AKEP per keshillim publik me palet e interesuara ne periudhen 15.06-15.08.2016, dhe ky version i dokumentit eshte versioni final pas marrjes ne konsiderate nga AKEP te komenteve te paleve te interesuara dhe zhvillimeve me te fundit ne sektor qe kane lidhje me objektin e kesaj analize tregu.

III. Bashkepunimi me Autoritetin e Konkurences

Sipas Nenit 38 të Ligjit 9918 AKEP duhet të bashkëpunojë me Autoritetin e Konkurrencës. Gjithashtu AKEP dhe Autoriteti i Konkurrencës kane nenshkruar nje Memorandum Mirëkuptimi me datë 29.08.2007, ku midis te tjerave "Neni 6", parashikon bashkepunimin midis dy autoriteteve per përcaktimin e tregut, përcaktimin e dominancës / përcaktimi i FNT.
Ne vijim te parashikimeve te Ligjit 9918 dhe memorandumit te bashkepunimit midis dy institucioneve, AKEP i ka kerkuar AK te shprehe opinionin e vet ne lidhje me kete dokument te nxjerre ne keshillim publik.

IV. Struktura e Dokumentit

Ky dokument permban analizen e tregjeve me pakice dhe me shumice te linjave me qira, dhe konkretisht:

1. Tregu me shumice i aksesit ne nivel lokal ne vendndodhje fikse (WLA)

2. Tregu me shumice i aksesit ne nivel qendror per produkte te tregut te pergjithshem (WCA)

3. Tregu me shumice i aksesit me cilesi te larte ne vendndodhje fikse (WHQA);

4. Tregu me shumice i aksesit ne elementet passive te infratsruktures se rrjeteve ne nivel kombetar

Ne kapitullin III, AKEP ka bere nje pershkrim te zhvillimve dhe karakteristikave te tregut me pakice te aksesit broadband ne Shqiperi si dhe nje pershkrim te rrjeteve fikse dhe infrastruktures se ketyre rrjeteve.

Ne kapitullin IV, AKEP ka analizuar tregjet nr.1-3 te cituar me siper, ne lidhej me perkufizimin e tregut dhe analizen per FNT.

Kapitulli V permban analizen e tregut te aksesit ne infrastrukturen pasive (tubacione/fiber e pandricuar) ne nivel kombetar (lidhjet nder-urbane).

Kapitulli VI permban masat rregulluese te propozuara nga AKEP per sipermarresit qe vleresohet te kene FNT ne tregjet perkates te analizuar.

III. ZHVILLIMET E TREGUT TE AKSESIT BROADBAND

III.1 TREGU ME PAKICE I AKSESIT BROADBAND NE INTERNET

Në shënimet shpjeguese për Rekomandimin për tregjet përkatëse të vitit 2014, analiza e secilit tregu me shumicë duhet të paraprihet nga një vlerësim i kushteve konkurruese në tregun me pakice te lidhur vertikalisht me tregun/tregjet perkatese me shumice. Tregu me pakicë i aksesit broadband ne Internet përfshin produkte standarde dhe shërbime të ofruara më vete ose/dhe në bundle me shërbime të tjera të komunikimeve elektronike në tregun masiv (përdoruesit e familjarë dhe biznes) nëpërmjet rrjetit telefonik tradicional (ADSL), rrjetit fibër-optike (FTTH, FTTB, FTTC / FTTN), rrjetit të transmetimit dhe / ose shpërndarjes së programeve të radios dhe televizionit, bazuar në teknologji kabllore (CaTV) me kabllo koaksiale ose sistemet koaksiale hibride (HFC) dhe rrjetit të bazuar mbi teknologjinë Ethernet LAN.

Me synimin për të vlerësuar konkurrencën në treg e përcaktuar me pakicë për aksesin në internet në këtë seksion janë analizuar dinamikat dhe treguesit kryesore te tregut me pakice te aksesit broadband nga rrjetet fikse, si numri i pajtimtareve, pjeset e tregut, tarifimi i sherbimeve etj. Vlerësimi i kushteve konkurruese në tregun përkatës të produktit me pakicë është bërë duke marrë parasysh përparësitë e shërbimeve të rregulluar të lidhura më tregjet më shumicë që ofrojnë operatorët e pranishëm në treg.

I.Numri i pajtimtareve te telefonise fikse dhe aksesit broadband

Ofrimi i sherbimeve te aksesit ne Internet nga rrjete fikse eshte ngushtesisht i lidhur me ofrimin e sherbimeve telefonike, per shkak se zhvillimet teknologjike (xDSL) kane bere te mundur ofrimin aksesit broadband nepermjet rrjeteve rrjetet tradicionale te telefonise fikse, dhe xDSL vazhdon te jete teknologjia dominante ne ofrimin e akseist ne internet, pavaresisht zhvillive te rrjeteve kabllore dhe atyre optike. Shërbimet e telefonisë fikse në Shqipëri ofrohen nga rreth 80 sipërmarrës, të cilët zotërojnë rrjetet/infrastrukturën e tyre, përfshirë rrjetin e aksesit apo të lidhjes direkte me përdoruesit fundorë. Siç vihet re edhe nga Figura II.1 numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse ka patur një rënie të vazhdueshme në katër vitet e fundit duke filluar nga viti 2012. Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2015 ishte rreth 227 mijë, që përbën një rënie me rreth 2% në krahasim me vitin 2014.[1] Rënien e theksuar ne 2014 erdhi edhe për shkak të ndryshimit të mënyrës së raportimit të këtij treguesi që në dy vitet e fundit i referohet numrit të përdoruesve aktive (me përdorim në 3 muajt e fundit të telefonisë fikse për përdorueist me parapagim). Numri i pajtimtarëve të Albetelecom në 2015 pati një reduktim të vogël me 1% në krahasim me 2014. Norma e pernetrimit për telefoninë fikse (numër pajtimtarësh për 100 banorë) arriti në 8%, që është shumë më e ulët se në vendet e BE apo edhe të rajonit. Per sa i perket pjeseve te tregut per pajtimtare te telefonise fikse, Albtelecom ka 80% pjesë tregu në 2015, ndërsa Abcom si operatori më i madh alternativ ka vetëm 5% pjesë tregu.

Edhe gjatë vitit 2016 ka vijuar tendenca e rënies së numrit të pajtimatrëve të telefonisë fikse, duke arritur në 223 mijë në fund të tremujorit të tretë 2016, që përbën një renie me 2% krahasuar me Tremujorine trete 2015. Ky reduktim nuk ka sjellë ndryshime të ndjeshme të pjesëve të tregut.

[1] Të dhenat e vitit 2014 të raportuara më parë janë rishikuar për shkak të ndryshimit të numrit të raportuar nga ASC dhe Nisatel.

FIGURA III.1 ECURIA E NUMRIT TË PAJTIMTARËVE TË TELEFONISE FIKSE 2000-2015



Megjithë efektin e ndryshimit të përkufizimit apo raportimit të këtij treguesi, tendenca në rënie është e dukshme per disa vite rradhazi tashmë. Të dhënat për numrin e pajtimtarëve sipas qarqeve tregojnë se rreth 46% e të gjithë pajtimtarëve të telefonisë fikse janë në qarkun Tiranë. Qarqet me penetrim më të madh të telefonisë fikse janë Tirana, Vlora, Gjirokastra dhe Korça me 9-13.4%, ndërsa qarqet me penetrim më të ulët janë Kukësi dhe Dibra me më pak se 3%.

Rënia e përdorimit të shërbimeve të telefonisë fikse vihet re edhe në reduktimin e sasisë totale të thirrjeve të gjeneruara nga rrjetet fikse. Sasia e thirrjeve telefonike të gjeneruara nga pajtimtarët e rrjetit fiks të Albtelecom në Tremujorin IV 2015 u reduktua me 19% në krahasim me Tremujorin IV 2014, ndërsa gjatë vitit 2015 një përdorues i rrjetit fiks të Albetelcom gjeneroi mesatarisht 67 minuta thirrje në muaj, një reduktim me 17% në krahasim me vitin 2014.

Figura e me poshte paraqet ecurine e normes se penetrimit te telefonise fikse per popullsi dhe paralelisht edhe ecurine e ketij treguesi ne bote. Nga te dhenat vihet re se Shqiperia ka nej norme shume te ulet penetrimi te sherbimeve te telefonise fikse ne krhasim me mesataren e vendev te zhvilluara, madje me te ulet edhe se mestaraja e vendev ne zhvillim.

FIGURA III.2 – NORMA E PENETRIMIT TE TELEFONISE FIKSE



Burimi: ITU dhe AKEP

Megjithëse shërbimet e telefonisë nga rrjetet fikse kanë pasur reduktim të ndjeshëm në vitet e fundit, shërbimet e aksesit broadband nga rrjete fikse kanë vazhduar të kene rritje të qëndrueshme në 5 vitet e fundit. Numri pajtimtarëve me akses broadband fiks në fund te vitit 2015 arriti në rreth 243 mijë, që përbën një rritje me rreth 17% në krahasim me vitin 2014. Norma e penetrimit për popullsi dhe për familje e pajtimtarëve me akses broadband fiks në fund të vitit 2015 ishte 9% dhe 33% përkatësisht. Albtelecom dhe 3 operatorët kryesorë alternativë patën rritje të numrit të pajtimtarëve me 5-18%. Ne vitin 2016 ka vijuar tendenca e rritjes se numrit te pajtimtareve duke arritur ne rreth 262 mije ne fund te tremujorit te trete 2016, qe perben nje rritje me 8% krahasuar me vitin 2015. Pjesët e tregut të këtyre operatorëve kanë qenë të qëndrueshme dhe Albtelecom zotëron 40% të tregut.

TABELA III.1 ECURIA E NUMRIT TË PAJTIMTARËVE TË AKESIT BROADBAND NGA RRJETE FIKSE 2010-2016/QIII

	Albtelecom	Abcom	Abissnet	ASC	OA te tjere	Total Broadband Fiks
2010	70,597	13,575	7,000	5,666	23,162	120,000
2011	60,055	29,321	15,321	10,129	24,871	139,697
2012	66,757	35,870	17,719	11,777	27,965	160,088
2013	73,242	43,430	20,562	15,432	29,890	182,556
2014	82,747	47,480	23,259	28,489	25,956	207,931
2015	97,597	51,093	24,497	31,357	38,326	242,870
2016_QIII	105,112	49,136	28,847	37,799	40,853	261,747
Ndryshimi 2015/2013	**18%**	**8%**	**5%**	**10%**	**48%**	**17%**
Ndryshimi 2016QIII/2015	**8%**	**-4%**	**18%**	**21%**	**7%**	**8%**

Tabela e mesiperme jep në mënyrë më të detajuar ecurine e numrit te pajtimtareve me akses broadband ne periudhen 2000-2016_QIII si dhe per operatoret kryesore ne treg. Te gjithe operatoret kryesore vihet re se kane ecuri pozitive ne 3-4 vitet e fundit.

Tendenca e kunderta te zhvillimit te aksesit broadband nga rrjete fikse dhe telefonise fikse vihen me qarte ne figuren me poshte, ku vihet re se pavaresisht se ne 2010 numri i pajtimtareve me akses broadband ishte shume me i vogel se numri i pajtimtareve te telefonise fikse, ne vitin 2015 numri i pajtimatrve me akses broadbannd nga rrjete fikse eshte me i madh se numri i pajtimtareve te telefonise fikse.

FIGURA III.3. ECURIA E PAJTIMATREVE TE TELEFONISE DHE TE AKSESIT BROADBAND NGA RRJETE FIKSE



II.Paketat e integruara (Bundles)

Te dhenat e mesiperme tregojne se sherbimi telefonik per disa vjet tashme rezulton te kete marre rol dytesor ne sherbimet nga rrjete fikse, ndersa nxitesi kryesor i zhvillimit te ketyre rrjeteve jane sherbimet e akesit broadband dhe sidomos sherbimet e integruara. Ofrimi i sherbimeve te rrjeteve fikse me paketa (bundles) te sherbimeve te aksesit ne Internet, telefonise fikse dhe TV (CaTV ose IPTV) rezulton te jete forma predominuese e konkurrences midis operatoreve te rrjeteve fikse.

Gjatë vitit 2015, numri i pajtimtarëve me shërbime të integruara në shporta triple play (Telefoni, Internet dhe TV), u rrit rreth 3 herë në krahasim me vitin 2014. Albtelecom pati rritjen më të madhe të këtyre pajtimtarëve (me rreth 4 herë). Tabela e mëposhtëme paraqet ecurinë e numrit të pajtimtarëve të Albtelecom me akses broadband dhe shërbime të integruara. 63% e pajtimtarëve me akses brodband të Albtelecom në fund të vitit 2015 ishin pajtimtarë të shportave trefishe (Telefoni, Internet dhe IPTV).

TABELA III. 2: NUMRI I PAJTIMATRËVE ME SHËRBIME TË INTEGRUARA TË ALBTELECOM

	2013	2014	2015	Ndryshimi 2015/14
Numri total i pajtimtarëve me akses broadband	73,242	82,747	97,597	18%
Numri i pajtimtareve qe kane akses ne sherbime te integruara (TV, Internet, telefoni)	70,961	76,230	93,873	23%
Telefoni fikse dhe Internet	70,961	60,939	32,293	-47%
Telefoni fikse, Internet dhe IPTV		15,291	61,580	303%

III.Teknologjia

Në tregun e aksesit broadband me pakicë ekzistojnë mundësi të ndryshme për realizimin e shërbimeve të aksesit nëpërmjet rrjetit telefonik tradicional (ADSL), aksesit nëpërmjet rrjeteve optike fibër (FTTH, FTTB, FTTC / FTTN), Wired (CATV). Te dhenat e tregut tregojne se teknologjia mbizoteruese eshte DSL e ndjekur nga kabllor koaksial. Shumica e lidhjeve DSL jane me rrjete te kombinuar fiber otike dhe bakri (FTTN/FTTC). Figura e meposhteme parqet shperndarjen e lidhjeve broadband fiks sipas tekonologjise ne Shqiperi dhe mesataren ne vendet e BE. DSL eshte teknologjia kryesor ne Shqiperi dhe ne BE. Ne Shqiperi lidhjet DSL perbejne 63% te totalit te lidhjeve broadband fiks, dhe shumica e tyre eshte me kombinim fiber optike + linje bakri apo FTTN/FTTC.

FIGURA III.4: LIDHJET BROADBAND FIKS SIPAS TEKNOLOGJISE SHQIPERI V BE 2015



Burimi: AKEP dhe Digital Agenda Scoreboard KE

Lidhjet me fiber optike ne Shqiperi (FTTH/B) perbejne 7% te totalit te lidhjeve, nivel i krahasueshem me BE me 9%. Lidhjet kabllore ne Shqiperi perbejne 23%, ndersa NGA kabllor (DOC SIS 3.0 dhe me shume) perben vetem 14% te totalit et lidhjeve kabllore, ndersa ne vendet e BE atp perbejne 80%. Pajtimtaret me lidhje ne NGA (FTTx + NGA kabllore) ne Shqiperi perbejne 63% te te gjitha lidhjeve broadband, ku shumica e tyre jane ne ADSL ne FTTN/C, ndersa ne vendet e BE ky proporcion eshte 35% ku shumica jane VDSL, FTTH/B dhe Cable DOC SIS 3.0.

IV.Shpejtesia e aksesit broadband

Figura e mëposhtëme tregon shpërndarjen e pajtimtarëve me akses broadband në internet ne rrjetet fikse sipas shpejtesive të përdorura ne 2014 dhe 2015. Sic mund te vihet re shpejtesia me e perdorur eshte 4-10 Mbps me 64% ne 2015 nga 53% ne 2014. Ne keto dy vite vihet re se eshte reduktuar pjesa e pajtimtareve me shpejtesi me pak se 4 Mbps: nga 36% ne 2014 ne 30% ne 2015.

FIGURA III.5: SHPERNDARJA E PAJTIMTAREVE ME AKSES BROADBAND FIKS SIPAS SHPEJTESISE 2014-2015



V.Tarifimi i sherbimit te aksesit broadband

Sherbimi i aksesit broadband mund te tarifohet si sherbim me vehte (stand alone) ose si pjese e paketave me disa sherbime te tjera si Telefoni dhe/ose TV, te integruara ne nje pakete dhe me nje tarife te vetme mujore (bundles). Ecuria e numrit te pajtimtareve dhe politikat tarifore te operatoreve tregojne per nje rritje te ndjeshme te tarfimit me paketa te integruara ne vitet e fundit. Me poshte paraqiten krahasime te tarifave te paketave te ndryshme te aksesit broadband te Albtelecom me vendet e BEREC. Tarifat jane ne Euro me TVSH dhe te axhustuara me kursin e kembimit per fuqine blerese (PPP) dhe per Shqiperine eshte perdorur kursi 1 Euro=62 lek. Pra ne terma nominale me kursin e kembimit te tregut tarifat e paraqitura ne figurat e meposhteme jane me shume se dy here me te lira, por per krahasueshmeri me fuqine blerese te njejte me vendet e BEREC perdoret kursi i cituar PPP.

Aksesi broadband (stand alone)

Si tarife krahasuese per Albtelecom eshtte marre tarifa standarde ADSL 4799 lek/muaj per akses 8Mbps pa limit. Nga krahasimi vihet re se kjo tarife e korrektuar per fuqine blerese ne Shqiperi (PPP) eshte 77 Euro dhe rreth 3 here me e larte se mesatarja e vendeve te BEREC.

FIGURA III.6: KRAHASIMI I TARIFAVE MUJORE TE AKSESIT BROADBAND (STAND ALONE)



Paketa te integruara Internet dhe telefoni

Perdorimi i paketave te integruara eshte tendence globale qe vitet e fundit ka pasur rritje te madhe edhe ne Shqiperi. Nga te dhenat e Albtelecom ne seksionin e meparshem rezulton se vetem nje pjese shume e vogel e perdoruesve jane ne paketa standalone broadband, dhe krahasimi i tarifave te paketave te integruara eshte me i rendesishem se paketat standalone. Per krahasimin e tarifave te paketave te Integruara per Albtelecom jane marre ne kosniderate paketat I+fiks dhe paketat e integruara me IPTV, sipas shpejtesive perkatese te aksesit ne Internet.

FIGURA III.7: KRAHASIMI I TARIFAVE MUJORE TE AKSESIT BROADBAND (TELEFONI DHE INTERNET)



FIGURA III.8: KRAHASIMI I TARIFAVE MUJORE TE AKSESIT BROADBAND (TELEFONI, INTERNET DHE TV)





Nga krahasimi i tarifave te mesiperme te axhustuara per fuqine blerese vihet re se:

- Tarifat per sherbimin (standalone) akses ne Internet me shpejtesi 8-12 Mbps eshte shume e larte ne Shqiperi krahasuar me vendet e BEREC;
- Tarifat per sherbime te integruara jane te krahasueshme me nivelin mesatar te BEREC

Vlen te theksohet se paketat standarde (standalone) ADSL te Albtelecom kane perdorim shume te kufizuar, pasi shumica e pajtimtareve jane ne paketa te integruara (Internet, telefoni dhe/ose IPTV) te cilat per te njejten shpejtesi aksesi ne Internet kane tarifa shume me te lira se paketat standarde ADSL. Kjo vihet re edhe nga tarifat e paketave te Albtelecom ne figurat III.6 dhe III.7 me siper. Gjithsesi figurat e mesiperme evidentojne se tarifat ne vendet europiane dhe tarifat mesatare ne nivel BE shfaqin tendencat normale te permbajtjes se

paketave: paketat standalone kane tarifa me te lira se paketat e integruara, dhe paketat dyfishe (Internet +telefoni) jane me te lira se paketat trefishe (Internet, Telefoni dhe IPTV).

Niveli shume i larte i tarifave standarde per aksesin ne Internet standalone ADSL te Albtelecom, eshte problematik dhe i ngjashem me situaten e evidentuar ne tregun celular ne analizen e tregut te publikuar nga AKEP ne Dhjetor 2016, dhe ka nevoje per adresim.

VI.Pjeset e tregut

Ndarja e tregut është një nga treguesit më të rëndësishëm në vlerësimin e gjendjes së konkurrencës në tregun përkatës. Pjesët e tregut llogaritet në bazë të numrit të pajtimtarëve për operatorët që operojnë në tregun përkatës të shitjes me pakicë broadband në internet. Figura më poshtë na paraqet trendin për përiudhen 2010-2015.

FIGURA III.9 PJESËT E TREGUT SIPAS NUMRIT TË PAJTIMTARËVEME AKSES BROADBAND



Pjesa e tregut e Albtelecom ka ardhur ne renie ne periudhen 2010-2013 dhe ka qendruar ne nivelin 40% qe prej vitit 2013, pavareisht rritjes se ndjeshme te numrit te perdoruesve te Albtelecom ne kete periudhe.

Ndarja e pjeset te tregut midis Albtelecom dhe operatoreve alternative (40% v 60%) eshte e ngjashme me nivelin mesatar te vendeve te BEREC (41% v 59%). Njekohesisht dhe treguesi i perqendrimit te tregut me pakice te aksesit broadband ne Shqiperi eshte 2347 krahasuar me 3100 ne vendet e BEREC.

FIGURA III.10 PJESËT E TREGUT AKSES BROADBAND SHQIPERI DHE BE



Nga të dhënat e paraqitura vihet re për periudhën që mbulohet nga kjo analizë së pjesa e tregut për Albtelecom nga 2011 ka pësuar rënie, por numri i pajtimtarëve ka pasur rritje. Kjo rritje ka ardhur si rrjedhim i politikave marketing dhe procesit të vazhdueshem për disa vjet të ndërtimit të një infastrukture NGA. Rritje në numrin e pajtimatrëve u vu re edhe tek pjestarët e tjerë të tregut.

Albtelecom në tregun relevant me pakicë është nën ndikimin e kushteve të rregullimit të tregjeve të lidhura vertikalisht me shumicë. Në lidhje me këtë periudhë deri në analizën e ardhshme të tregut, pritet që incumbent të mbajtur një pozicion drejtues në drejtim të pjesës së tregut në bazë të numrit të pajtimtarëve në tregun me pakicë të aksesit broadband internet.

Pjesët e tregut kane rëndësi në analizat që zhvillohen. Nga ato varet gjendja e mëvonshme e konkurrencës në treg. Diferenca ndërmjet pjesës se tregut të incumbent dhe të lojtarëve të tjerë është një faktor ndikues për hyresit e rinj potenciale. Rezultatet për llogaritjen e indeksit Herfindahl-Hirschman treguan se tregu me pakicë është relativisht konkurrues në krahasim me nivelin mesatar të përqendrimit të vendeve antarë të BE.

III.2 INFRASTRUKTURA E RRJETEVE FIKSE DHE LINJAT ME QIRA

Karateristike e rrjeteve fikse ne Shqiperi eshte ofrimi i tyre nga nje numer i madh operatoresh. Ne ndryshim nga vendet e BE apo edhe te rajonit, ku operatoret alternative bazohen kryesisht ne infrastrukturen e rrjetit fiks incumbent per te ofruar sherbime te telefonise fikse dhe aksesit broadband, sidomos ne rrjetin lokal (lidhja direkte me premisat e perdoruesit fundor), ne Shqiperi shumica e operatoreve alternative kane ndertuar rrjetet e tyre, sidomos ne nivel loka ne qytetet krueosre apo ne zonat rurale me atraktive. Ne drejtim te ofrimit te sherbimeve te aksesit broadaband per perdoruesit fundore, jane te rendesishme nje sere inputesh, dhe nder to jane dhe infrastruktura aktive dhe pasive, ne nivel lokal dhe kombeatar (nder-urban) si dhe lidhjet me boten per akses ne konektivitetin nderkombetar. Ne kete seksion paraqitet informacion per rrjetet kryesore te Fibres optike dhe tubacioneve dhe lojtaret me te medhenj qe zoterojne dhe ofrojne akses ne kete infrastrukture.

I.Fibra Optike

Tabela e meposhteme paraqet informacion mbi sipermarresit qe kane instaluar fiber optike (FO) ne qytetet dhe akset kryesore rrugore nderurbane ne Shqiperi, sipas te dhenave te sjella nga operatoret per ndertimin e Atlasit.

TABELA III.3: FIBRAT OPTIKE NDERURBANE TE OPERATOREVE NE SHQIPERI

Operatori	Gjatesia e FO te instaluar (km)	Prezenca
Albtelecom	1,409	Ne qytetet kryesore dhe akset rrugore kryesore nder-urbane.
ATU	752	Akset rrugore kryesore nder-urbane
Abcom	240	Qytetet: Tirane, Durres, Shkoder. Aksi Tirane-Rinas
Primo	230	Qytetet: Tirane, Durres, Shkoder, Golem (Kavaje)
Abissnet	152	Qytetet: Tirane, Durres, Shkoder, Golem (Kavaje)
Itel	147	Qyteti: Tirane
Nisatel	129	Qyteti: Vlore, Durres
ITirana	92	Qyteti: Tirane
Tring	69	Qyteti: Tirane
Tvm_Devolli	64	Devoll
Apollnet	42	
Keminet	16	
Artan_Zhiva	12	
Telkom	8	

Enada_online	4
Esde	1
Plus	1
Totali	3,369

Figurat e meposhteme paraqesin shtrirjen e rrjeteve optike ne Shqiperi sipas te dhenave te hedhura ne Atlas.

FIGURA III. 11: FIBRA OPTIKE TE GJITHE OPERATORET

Fibra Optike te Gjithe Operatoret



Fibra optike te gjithe pa Albtelecom dhe ATU



FIGURA III.12: FIBRAT OPTIKE TE ALBTELECOM DHE ATU

Fibra Optike Albtelecom

Fibra optike ATU



FIGURA III.13: FIBRAT OPTIKE NE TIRANE

Fibra Optike te gjithe operatoret: Tirane



Fibra optike Albteelecom Tirane



Sic mund te vihet re ne qytetet kryesore ka disa operatore qe jane prezent me infrastrukture fiber optike dhe ne akset rrugore qe lidhin qytetet kryesore jane present vetem Albtelecom dhe ATU. Keto kapacitete sherbejne per operatoret perkatese per ofrim sherbimesh te komunikimeve elektronike, ne nivele me pakice por edhe ne nivel me shumice. Fibra optike sherben per transport trafiku ne kapacitete shume te medha dhe ne baze te ndarjes se segmenteve trank dhe terminuese, fibrat optike qe lidhin qytetet kryesore dhe brenda tyre perbejne mundesi ofrimi kapacitetesh ne nivel trank. Pervec fibres optike, operatoret kryesore ne rrjetet e tyre kryeosore perdorin edhe lidhje me radiofrekuenca. Harta e lidhjeve me radiofrekuenca eshte me e dendur dhe numri i operatoreve qe kane lidhje me radifrekuenca eshte me i madh.

Albtelecom zoteron 42% te totalit te fibres optke te instaluar ndersa ATU 22%, dhe te dy se bashku zoterojne rreth 64% te totalit te fibres optike ne Shqiperi, ne rrjete urbane dhe nder-urbane. Nderkohe, Albtelecom dhe ATU zoterojne 100% te lidhjeve me fibra optike ne zonat nderurbane.

II.Tubacione

Per sa i perket tubacioneve, te dhenat e Atalsit kane te dhenat e meposhteme.

TABELA III.4: TUBACIONE E RRJETEVE FIKSE

Operatori	Gjatesia e tubacioneve (km)	Prezenca
Albtelecom	1,645	Urbane dhe nderurbane
Nisatel	236	Urbane
Tring (ASC)	9	Urbane
Vivo	15	Urbane
ATU	755 x 6	Nder-urbane
Abissnet		Urbane
Totali	2,660	

Shenim: ATU nuk ka depozituar te dhena dhe shifra e mesiperme eshte e gjatesise se FO nderurbane te ATU. Vlersohet se ka dhe kapacitete te tjera shtese ne Tubacione.Te dhenat e Abissnet nuk jane compatible me Atlasin

FIGURA III.14: TUBACIONE TE GJITHE OPERATORET

Tubacione te gjithe operatoret

Tubacione te gjithe operatoret pa Albtelecom dhe ATU

<u>Sic mund te vihet re edhe per Tubacione, Albtelecom zoteron 62% te gjithe tubacioneve ne zona urbane dhe nder-urbane, ndersa Albtelecom dhe ATU zoterojne 100% te tubacioneve ne zona nder-urbane.</u>

III.Linjat me qira dhe perdorimi i perbashket i infrastruktures pasive

Tabela e meposhteme paraqet te dhena per perdorimin e infrastruktures aktive per linjat/kapacitet me qira ne nivel me shumice dhe me pakice si dhe te infratsruktures pasive (tubacione dhe dark fiber) .

TABELA III.5: LINJAT ME QIRA DHE AKSESI NE INFRASTRUKTURE PASIVE (2014-2015)

	2014				2015			
	Total	Albtelecom	Abcom	ATU	**Total**	Albtelecom	Abcom	ATU
Ofrimi me pakice Linja/kapacitete me qira								
Numri I klienteve biznes	**116**	2	85	9	**147**	4	89	18
Numri I linjave/lidhjeve te dhena	**977**	14	711	93	**1,130**	21	750	125
Kombetare	**942**	1	697	89	**1,008**	1	736	121

Nderkombetare	**35**	13	14	4	**38**	20	14	4
Kapaciteti total I dhene me qira	**7,727**	5	2,400	4,045	**14,320**	16	2,400	11,560
Kombetare	**7,427**	4	2,170	4,006	**13,666**	4	2,170	11,148
Nderkombetare	**300**	1	230	39	**654**	12	230	412
Ofrimi me shumice Linja/kapacitete me qira								
Numri I operatoreve	**39**	23	7	9	**47**	23	8	5
Numri I linjave/lidhjeve te dhena	**345**	186	120	39	**508**	248	130	36
Kombetare	**328**	172	120	36	**489**	230	130	35
Nderkombetare	**17**	14	-	3	**19**	18	-	1
Kapaciteti total I dhene me qira	**34,793**	15,311	1,300	18,182	**36,826**	22,226	1,500	13,100
Kombetare	**33,392**	14,130	1,300	17,962	**35,346**	20,846	1,500	13,000
Nderkombetare	**1,401**	1,181	-	220	**1,480**	1,380	-	100
Ofrim Akses ne Infrastrukture Pasive	-							
Dark fiber	**927**	621	124	152	**924**	622.00	132.00	137
Akses ne tubacione	**19**	19	-	-	**61**	36.00	-	-

Burimi: Te dhenat periodike statistikore te raportuara nga operatoret

Nga te dhenat vihet re se Albtelecom ka presence te ulet ne tregun me pakice te linjave me qira, por eshte ofruesi kryesor ne nivel me shumice, duke rritur ndjeshem kapacitet e dehna me qira ne 2015. Abcom ka presence te larte ne tregun me pakice te linjave me qira, port e vogel ne nivel me shumice. ATU eshte ofruesi kryesor i linjave me qira ne nivel me pakice per sa i perket kapaciteteve te dhena, dhe eshte ofruesi i dyte me i madh pas Albtelecom ne nivel me shumice. Perdorimi i dark fiber eshte ne nivel te larte, ndersa i tubacioneve ne nivel shume te ulet, megjithe rritjen ne 2015.

IV. ANALIZA E TREGJEVE ME SHUMICE TE AKSESIT LOCAL, QENDROR DHE ME CILESI TE LARTE

IV.1 Perkufizimi i Tregjeve me pakicë

AKEP, bazuar në zhvillimet e tregut, ndryshimeve te ndodhura pas analizave te tregut ne 2014 ne keto tregje dhe Rekomandimeve te KE, gjykon të arsyeshme të rishikojë vleresimin e përkufizimit të tregjeve përkatës të aksesit të kryer ne analizat e vitit 2014.

Ne percaktimin e tregut perkates te produktit, AKEP gjykon te marre ne konsiderate perkufizimet e rekomandimit te KE te vitit 2014, i cili ka grupuar perdoruesin fundor te produktit dhe te sherbimit te cilat kane nje qellim. Tipet e grupeve te konsumatoreve fundore që jane marra parasysh jane konsumatore rezidenciale dhe biznes. Keta te fundit mund te kategorizohen ne te vegjel, te mesem dhe te medhenj me ose pa shume qendra vendodhje biznesi.

Nga perspektiva e kerkeses, vleresohet se ka ndryshime midis kerkesave per broadband dhe sherbime qe lidhen me të, në nivel me pakicë midis konsumatoreve fundore. Kuptohet ka kerkesa te ndryshme per nje konsumator individ, per nje SME dhe nje kompanie te madhe me kerkesa te sofitikuara dhe me shume pika prezence vendndodhje. Keto ndryshime ne kerkese rezultojne nga fakti se konsumatori biznes zakonisht ka nevoje per nivel kapaciteti transmetues te larte dhe siguri ne cilesine e sherbimit, por ka raste kur nje konsumator biznes te mund te plotesoje kerkesat e tij me bundle sherbimesh standarde. Nisur nga keto mund ti ndajme ne dy grupe konsumatoresh te cilen kane kerkesa te ndryshme ne nilevin e cilesise se sherbimit, ne kapacitetin e dedikuar, ne mundesine e ofrimit, ne numrin e difekteve dhe koha e nevoshme per ti riparuar ato. Nga ana tjeter eshte e veshtire qe nje ofrues i ketyre sherbimesh te ofroje sherbime te personalizuar ne mase te per te plotesuar kerkesat e tregut pa pesuar kosto shtese. Ne këtë kuptim AKEP ka percaktuar dy tregje te ndare pakice:

- Tregu me pakice per sherbime te standartizuara
- Tregu ne pakice per sherbime te dedikuara me cilesi te larte

a. Tregu me pakice per sherbime te standartizuara(tregu masiv)

Tendenca e konsumatoreve rezidenciale dhe e disa bizneseve per sherbime bundle te cilat kane perfshire disa lloje sherbimesh ka pesuar rritje. Ne pergjithesi keto bundle kane te perfshire ne nje pagese, telefoni fikse dhe celulare, akses ne te dhena, TV. Megjithë kerkesen e madhe per bundle, shumica e operatoreve ofrojne pervec bundle edhe sherbimin e te dhenave vecmas, pavaresisht se disa operatore kane tendence ta perfshijne aksesin ne broadband me telefonine fikse.
Ne nivel pakice ekzistojne nje numer mundesish per aksesin ne broadband nga rrjetet fiks. Ketu permendim rrjete me baze DSL, rrjete me fibra dhe rrjetet kabllore. Gjithashtu edhe rrjetet satelitore dhe rrjetet tokesore TV jane te mundur te ofrojne sherbimin e dhenave dhe aksesin ne internet broadband.
Pervec kesaj, parë edhe nga prespektiva e perdoruesi fundor sherbimet e ofruar nga rrjete jo celulare si WiFi dhe celulare, ne disa rrethana te caktuara mund te konsiderohen te zevendesueshme me sherbimet nga rrjete fikse, por teknologjie qe ofrojne celularet eshte larg kerksese per kapacitete te larta, duke qene se sherbimet e aksesit ne broadband nga rrjete celulare jane dizenjuar per te krijuar mudesi aksesi jo nga nje pozicion fiks, ndaj dhe mund te kene kufizime ne lidhje me shpejtesine dhe brezin. Hedhja ne treg dhe mbulimi i territorit shqiptar me teknologji LTE do jete nje faktor qe do te ndikoje ne zevendesuseshmeri. Kjo teknologji pritet te zbuse barrierat e kufizimeve te shpejtesise dhe brezit per aksesin ne broadband nga rrjete celulare duke e bere te krahasueshme me ate nga rrjete fikse. Faktor tjeter qe duhet marre ne shqyrtim do te jete krahasueshmeri e cmimit midis ketyre akseseve

nga te dyja rrjetet, menyra e ofrimit te sherbimit nga operatoret(ofrojne sherbime te ngjashme me siguri rrjet te larte apo sherbime te dedikuara apo te personalizuar me cilesi te larte). Për këtë cështje AKEP ka zhviluar një analizë të detajuar ne kapitujt në vijim.

b. Tregu ne pakice per sherbime te dedikuara me cilesi te larte

Shumica e konsumatoreve rezidenciale kane tendencen të kerkojne sherbime komunimimesh te standartizuar (mundes per telefoni fikse dhe mobile, akses interneti dhe IPTV). Por edhe shumë konsumatoreve jo rezidente mund te perpumushin kerkesat e tyre me po këto shërbime të standartizuar duken nisur se edhe shpetjtesia e ofruar ne treg per konsumatore rezidenciale eshte rritur se tepermi brenda ketyre viteve. Per vitin 2014 numri me i madhi pajtimatrëve broadband është vënë re të jëtë përqëndruar në shpejtesitë nga 4-10 Mbps.
Vec kategorise që përshkruam më sipër kemi edhe konsumatorin biznes, i cili ka nevojë për shërbimë më të avancuara mbi të cilat të mbështesi një komunikim të brendshëm të sigurt midis njësivë të biznesit që mund të jenë lokalizuar në vende të ndryshme. Shërbimet që ka nevojë kjo kategori mund të ofrohen me QoS të lartë dhe nilev të lartë sigurie, të jenë të vijueshëm dhe shpejsh të kënë shpejtesi simetrike Up and Download. Si rrjedhim një shërbim i standartizuar i dedikuar për tregun e pakice nuk do të plotesonte kerksat e këtij grupi.
Ky treg pra përfshin produktet që janë dizenjuar drejt kerkesave specifike që mund të plotësojë nevojat konsumatorit. Një cilësi e larte QoS-i, një garanci për vijueshmëri, një norma e mjaftueshme Up and Download, një kapacit për të përballuar një numër të caktuar paijshjesh ose përdoruesish në të njëjtën kohë pa kufizime, janë disa nga karateristikat e produkteve të këtij tregu me pakice. Këto shërbime janë tipike e sipermarresve që kerkojnë cilësi të lartë, brez të gjërë në internet pa kufizime teknike(limitited contention), IP telefoni, data center dhe back up, suport teknik shtesë, kohë të shkurtër riparimi të difekteve, telefoni celulare për punonjësit, kapacitet për të përballuar te dhena te pakushtezuara(uncontended data) midis vendodhjes se qendrave ku janë lokalizuar godinat etj. Shume prej tyre mund të kenë kërkesa edhe për shërbime të shtuara si psh. virtual private networks.
Këto shërbime jane tipikë të ofruara nga lidhjet te realizuara nga linjat me qira ose nga platfoma me baze baker ose nga platfomat fiber, sic mund te jene LLU dhe Ethernet. Duke qene se kërkohet shërbimet me këto cilesi atehere ne kete treg nuk do te perfshihen sherbimet e ofruara nga wirëless dhe kablloret duke qene se ato nuk mund te plotesojne nevojat e nje biznesi per nje kapacitet te larte dhe bandëidth simetrik (një analizë më të detajuar është zhvilluar në kapitjt pasardhës).

Analiza e tregut me pakicë

Në mungesë të rregullimit në nivel me shumice të dy tregjet e pakicës do të shfaqnin problem të konkurences efektive. Analiza e zhvilluar në tregun e shumicës, per te cilin produktet e pakicës shërbejne si input për shumicën dhe detyrimet e vendosura në të, do të adresojne edhe problemet e mundshme të konkurencës në tregun me pakice. P.sh. në rastin e aksesit te dhenave dhe sherbimeve qe jane të varura nga ato, nga vendodhje fikse mund te jete tregu i shumicës të aksesit lokal nga vendodhje fikse.

Për të ofruar tek një përdorues fundor, akses interneti në broadband dhë në shërbimet që lidhen me të dhënat, nga rrjete fikse, duhet një kanal trasmetimi që të jëtë i përshatshëm kalimi i të dhënavë në të dyja drejtimet dhe më norma që janë të përshatshmë për të ofruar shërbimin e kërkuar. Ndaj cdo sipërmarrës që kërkon rë ofrojë një shërbim të tillë përdoruesit fundor duhet të zgjedhe ose të ndërtojë një rrjet ose të mbështete tek një infrasturkturë ekzistuese në mënyrë që të arrijë tek vendodhja e përdoruersit fundor për ti ofruar këto shërbime.

Akesi në rrjet teorikisht mund të perfitohet në disa nivele të hierarkisë së rrjetit ndaj infarstuktuarat e rrjetit janë segmentuar në produkte të aksesit, cdo e cila mund të replikohet nga akses kërkuesi. Zevendesimi i aksesit nga rrjetë tradicional të bakrit ne infasturkturë te re

fiber ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme dhe pritet që dhe në vitet në vijim të vazhdojë. Ky ndryshim gjithashtu ka sjelle edhe ndryshime thelbesore në dizenjimin e produktet e aksesit në rrrjet dhe ka nje impakt të dukshem në kufinjtë dhe zgjedhjen e prokukteve perkatese te aksesit me shumice.

Ne analizen e fundit u identifikuan dy tregjet me shumicë të lidhura më tregun me pakice të aksesit në broadband, tregu me shumice i aksesit ne infrastrukturen e rrjeteve fizike (perfshire aksesin e plote dhe te perbashket-LLU) nga vendodhje fikse dhe tregu me shumice i aksesit broadband (bitstream) me produkte qe dallohen sipas natyre fizike ose virtuale që dallohen nga mundesia e fleksibilitetit për te ofruar paketa ne pakice, që dallohen se nga kush nivel i hierkarkise ne rrjet eshte ofruar aksesi. Ndaj LLU dhe SLU janë ofruar perkatesisht ne MDF ose Cabinet street dhe jane prokukte fizike te aksesit që iu mundesojne kerkuesve te aksesit nje fleksibilite me te madh dhe nje kontroll me shume mbi sherbimin e broadband me pakice ofruar perdoruesit fundor sesa aksesi broadband me shumice, i cili i ofruar ne formen e sherbimeve jo fizike bitstrem, i cili mund të ofrohen nga MDF nga një nivel hierkarkik me i larte. Me implementimi e plote te NGA diferencimet midis produkteve te aksesit fizik të rrjeteve tradicionale dhe prokukteve te aksesit virtual tradicionale duke perdorur kriteret e mesiperme është bërë më pak e dallueshme.

Albtelecom ka deklaruar se ka implementuar një NGA me rrjet FTTC dhe rrjeti optik i fibres shtrihet nga centrali deri ne cabinet street-in me te afert me pajisjet e klinetit fundor. Pjesa tjeter nga cabinet deri tek klienti fundor është e përbere nga rrjet bakri. Për të përmirësuar shërbimin Albtelecom implementoi teknologjine VDSL me qellim rritjen e shpejtesise në maksimi nga kabllot e bakrit. Nga rreth 83 mije pajtimtare broadband qe ka pasur Albtelecom ne fund te vitit 2014, rreth 82 mije i ka me teknologji FTTC, 216 me teknologji FTTH dhe 565 wireless.

Me kalimin e kohes aksesi nga rrjetet e NGN do të rritet dhe si rrjedhim do të ndryshojë edhe stuktura korente e tregut të aksesit me shumicë broadband. Në të njëten kohë pritet që edhe tekonologjia e bazuar në tela bakri të luajë një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve të aksesit me shpejtësi të lartë duke mundësuar kështu edhe shtyrjen e jëtëgjatësisë të aksesit në rrjeteve bakri. Kundrejt kësaj kërkuesit e aksesit do të mbeshteten per momentin në dy inpute vertikale të ndryshme me shumicë të shumicës për të adresuar tregun e pakicës.

Më ecurinë e produkteve te aksesit virtual, nuk do të jetë e përshtatshme të mbështetemi akoma për të dalluar kufinjtë e tregut të prokukteve të aksesit me shumicë të përshtatshëm për të ofruar shërbime te broadbandit me pakicë, në dallimin midis aksesit fikiz dhe atij jofizik(virtual). Parë në këtë kendvështrim në analizat e mëposhtëm janë diferencuar sipas produkteve me shumicë qe mund të replikohen me produkte e ofruara nga aksesi fizik tradicional me ato të formave të tjera të aksesit. Për të dalluar këto dy produkte bazohemi ne disa karaktëristika.

- Karakteristika e parë lidhet me vendin ku behet takimi i akses kerkuesit me ofruesin e aksesit. Aksesi me shumicë i ofruar lokalisht është i ndryshëm nga ai i ofrua në nivele më të larta të hierkarkisë së rrjetit. Pra lokal kundrejt jo lokal është një faktor i rëndësishëm dallimi.

- Karakteristika e dytë ka të bëjë më tipologjinë edhe me mënyrën e transmetimit të rrjetit të produkteve të shumicës, sidomos më ato që kanë të bëjnë me network contention. Disa produkte janë me natyre contented dhe i mundësojnë akses kërkuesit të ofrojë shërbimë me pakicë të standardizuara, me karakteristika të kufizuar. Disa prokukte të tjera shfaqin karakteristika më të ngjashme me prokuktet e LLU-së, e cila është një akses më gjenerik, duke i ofruar akses kerkuesit nje kapaciet te ditur dhe uncontended. P.sh. duke i siguruar brez sipas nevojave te akses kerkuesit kur kerkesat perkatese për akses janë subjekt i parimit te proporcionalitetit, normalisht nuk do të kërkohet nga operatori FNT(Albtelecom) të zhvillojë një infrastukture fizike të re.

- Karakteristika e tretë lidhet me gradën e fleksibilitetit që i lëhet për kontroll akses kërkuesit nga ofruesi me shumicë për të nryshuar oferta e tij në tregun me pakicë. Në këtë kuptim është e rëndësishme të vlerësojmë së cilat elementë të rrjetit dhe inpute ndihmëse të aksesit me shumicë mbeten në kontroll të plotë nga operatori FNT(Albtelecom) dhe cilat do të jenë në kontroll të akses kërkuesit.

Nisur nga këto karakteristika dallohen dy tregje:

1. Tregu me shumicë i aksesit lokal nga vendodhje fikse (WLA), i cili përfshin prokukte të aksesit që i mundësojnë akses kërkuesit një kontroll më të madh dhë më fleksibël mbi linjën/linjat e aksesit.
2. Tregu i aksesit qendror nga vendodhje fikse(WCA), i cili përfshin produkte e aksesit që i mundësojnë kërkuesit të aksesit një kontroll më vogël dhe më shumë të standardizuar mbi linjën e aksesit

Pra për tregun më pakicë të mass market, në mungesë të rregullimit të përshtatshëm me shumicë të incumbent-it te rrjetit fiks, i cili është operatori më rrjet të përhapur në të gjithë Shqipërinë, sidomos në zona ku platformat e operatorëve alternativë nuk janë të pranishmë, incumbent mund të ushtojë presion mbi konkurrencën duke u sjellë si monipolist. Në lidhjë me tregun më pakicë të high-quality, operatori incumbent i rrjetit fiks do të jëtë edhe më pak i detyruar, për faktin së shërbimët e ofruar nga platformat alternative nuk janë në gjendje të konkurojnë në nivel pakice dhe të ofrojnë produkte me karakteristika si kapacite i dedikuar dhe diapazon frekuence simetrike

Indikatoret kryesore te tregut qe kane te bejne me teknologjine (teknologjite mbi te cilat ofrohet aksesi ne broadband Albtelecom + Operatoret Alternative), si: xDSL & Fiber, Kabllore, 4G, shkallen e penetrimit per aksesin broadband (popullsia dhe familje), perbejne edhe faktoret influencues ne zhvillimin e konkurrences ne kete treg. Analizat ne aspektin e rritjes se konkurrences pas analize 2014, te cilat te konsideruara se bashku, do të percaktojne ne se eshte e nevojshme per nderhyrje ex-ante ne tregjet e nivelit te shumices (tregjet e shumices te aksesit lokal dhe qendror).
Qellimi i kesaj analize të mass market me pakice nuk është të përcaktoje nje treg relevenat, por më shumë të japë një përshkrim së si janë të nderlidhuar vertikalisht ky treg me pakice dhe dy tregjet më shumicë që shërbejnë si input në këtë treg.

AKEP ka mbajtur ne vemendje dhe ne fokus zhvillimin e tregut te aksesit broadband si per mass market ashtu edhe per highlity quality dhe për te dy nivelet e tij, pasi kjo eshte percaktuar edhe nga strategjia kombetare per zhvillimin e broadband ne Shqiperi, si dhe nevojat gjithnje e ne rritje per kryerjen e sherbimeve bazike te konsumatoreve te mbeshtetura nga sherbimet qe mundeson aksesi ne broadband.

AKEP ne menyre periodike ka publikuar raporte statistikore dhe kryesisht vitet e fundit konstatohet:

- Rritje e kerkeses per akses ne broadband, per rrjedhoje ka rritje te penetrimit te aksesit ne broadband;
- Krahas rritjes se kerkeses per akses per te dhena, konstatohet dhe kerkese per akses ne broadband me shpejtesi te larte, duke eliminuar edhe kerkesen e aksesit ne brez te ngushte. Kerkesa per shpejtesi dhe kapacitete te pakushtezuar vjen edhe si pasoje e kerkeses të kliente rezidente dhe biznese qe plotesojne nevojt e tyre më shërbime pakice te standartizuara dhe klienteve biznes qe kerkojne sherbime te ndryshme te kushtezuara per kapacitet te larte ;

- rritja e kerkeses per keto sherbime ka zhvendosur kurben e ofertes duke i orientuar ofruesit te zhvillojne produkte e tyre drejt kerkesave te konsumatoreve me tekonologji me te avancuara per te bere te mundur maksimizimin e te ardhuarve dhe reduktimin e kostove shtese;
- Vihet re nje rritje e shtrirjes gjeografike te sherbimit te aksesit broadband. Per vitin 2014 gati 8% e pajtimtareve broadband jane ne fshat dhe rreth 92% janë ne qytet;
- Kemi ndryshim të pjesëve të tregut të matura sipas numrit të pajtimatrëve broadband fiks, Albtelecom nga 59% pjesë tregu në 2010 në fund të tremujorit të trete 2015 shkoi në 39%;
- Është rritur sasia e të dhëva gjatë këtyre, sidomos e hyrjen te treg te shërbimeve nga teknologjia 4G, por përsëri në krakasim më sasinë e trasferuar nga rrjete fikse është më e vogël;
- Zhvillime te rendesishme te paketave "bundle", ofertave qe plotesojne kerkesen konsumatore per telefoni dhe internet kryesisht, por nga 2014 e vijim të paktën katër operatore ofrojne sherbimin IPTV si me vete ashtu edhe në paketa të integruara. Nga 230 mije pajtimare broadband nga rrjete fikse, 135 mije janë të abonuar në shërbime të integruara(paketa triplay dhe double) në fund të 3 mujorit të tretë 2015.

AKEP gjykon se faktoret e mesiperm perbejne faktoret baze mbi te cilet mbeshtetet zhvillimi tregut te aksesit broadband ne nivelin e pakices, dhe bazuar edhe ne objektivin shteteror dhe strategjine e zhvillimit te broadband, mund te parashikohet se ne vitet e ardhshme do te kete rritje te ndjeshme te penetrimit te aksesit ne broadband, kjo vleresuar edhe si penetrim ne aksesin e linjave, gje e cila do te percaktoje ne menyre te natyrshme rritje te penetrimit te perdoruesve te sherbimeve qe mundeson aksesi ne broadband.

Trendi i rritjes se investimeve ne zhvillimin e infrastruktures mbi te cilen mundesohet aksesi ne broadband, perben edhe premisen kryesore mbi te cilen mbeshteten e ardhmja e zhvillimit te tregjeve broadband. Kjo vihet re si ne investimet e bera ne NGN, investime te cilat bazojne rrjetet e tyre kryesisht ne (IP), te cilat ne fund te fundit orientojne tregjet edhe ne konvergjence te sherbimeve te cilat mbeshteten ne (IP). Nje zhvillim i tille, terheq kerkesen konsumatore ne akses me kapacitet te larte, por percakton edhe zhvillimin e rendesishem te ofertave ne kete drejtim, pasi vihet re se kemi rritje te ndjeshme te kapacitetit te ofruar (upload dhe doënload), pothuajse ne te njejtin nivel cmimi. Kjo perben nje zhvillim te rendesishem ne kete drejtim, gje e cila percakton qarte tregues te rritjes se konkurrences ne kete treg.

Tarifimi i shërbimeve

Pavarësisht nga gjetja e zëvendësimit në aspektin e performancës funksionale në mes të shërbimeve të ofruara për përdoruesit e rezidenciale, biznesit të vogla dhe të mesme, dhe korporatave te medha disa operatorë ofrojnë kanë politika marketingu të ndryshmë duke ofruar një shumëllojshmëri të shërbimeve të tjera, duke përfshirë në ofertë, në varësi të grupit të konsumatorit për të cilin është fokusuar shërbimi.

Nga një monitorim i faqeve zyrtare të disa operatorëve ne lidhje me cmimet e shërbimeve të ofruara sipas dy kategorive kryesore, biznes dhe familjare, vihet re se:

- Diapazoni i ofertave per biznesin perfshin shpejtesi shume me te larta se per perdorues familjare. Per familjare dhe biznese te vogla aksesi broaband me shpejtesi deri ne 12 apo 16 Mbps eshte i mjaftueshem per plotesimin e kerkesave dhe nuk ka dallime ne cmime. Por vihet re se oferta e biznesit permban akses broadband edhe per shpejtesi shume te larta si 30 Mbps apo me shume. Numri i ulet i pajtimtareve ne

shpesjtesi 30 Mbps apo me shume, tregon se keto lidhje perdoren kryesiht nga biznesi dhe jo nga familjaret.

- Shumica e operatoreve ne faqet web kane seksione te vecante per pajtimtare Familjare dhe Biznes, dhe seksioni i pajimatreve Biznes pervec aksesit broadband fiks perfshin shume me teper sherbime specifike (lidhje direkte me fiber optike, transmetim te dhenash, sherbime hostimi etj), se seksioni i pajtimtareve Familjare.
- Tarifat per Biznesit jane objekt negociatash/procedurash konkurrimi. Perdoruesit biznes (institucione publike dhe korporata te medha) ne shumicen e rasteve perdorin procedura prokurimi per zgjedhjen e operatorit ofrues te sherbimit et aksesit broadband dhe/oses sherbime te tjera specifike te lidhura me te, dhe cmimet jane objekt i kontratave individuale te lidhura midis perdorueist Biznes dhe operatorit ofertues. Keto cmime jane dhe objekt negociatash dhe te ndryshme nga ato te publikuara.

Një korporatë për të siguruar akses në broadband nuk e ka të mjaftuëshëm shërbimi e standartizuar duke qëne së ky i fundit nuk i plotëson nevojat specifike. Nga të dhënat e mësipërme verehet se kërkesa për këto shërbime është fokusuar tek dizenjmi i shërbimit të dedikuar, duke qënë të gatshëm të paguajnë një tarifë ndjeshërisht më të lartë për abonimin mujor, si dhe tarifa më të larta për instalimin në krahasim me çmimet për sherbimin standard broadband te projektuar për përdoruesit e zakonshëm familjar. Zevendesueshmeria ne anen e kerkeses midis perdoruesve Biznes dhe Familjare ekziston per sherbimin standard me shpejtesi jo-te larte, por per sherbime me shpejtesi te larte zevendesueshmeria eshte e ulet ne anen e kerkeses.

Konkuluzion

Bazuar në sa më sipër, si dhe ne rekomandimin e KE te vitit 2014, AKEP arrin në përfundimin se nuk ka zëvendësueshmëri në drejtim të kërkesës për shërbimet standarde për akses në internet për pajtimtarët rezidenciale dhe të biznesit (te madh), dhe për këtë arsye këto produkte nuk i përkasin të njëjtit treg. Për shkak të dallimeve në karakteristikat funksionale dhe çmimit të shërbimeve për konsumatorët e biznesit (aksesit të dedikuar në veçanti) e të shërbimeve për konsumatorëve në masë, të dy shërbimet nuk duhet të konsiderohet në të njëjtin treg.

<u>Zëvendësueshmëria nga ana e ofertës</u>

Sipas të dhënave të deklaruar nga operatorët e rrjeteve fikse në fund të vitit 2014 kanë ofruar akses interneti rreth 80 operatorë. Nga këta rreth 50 operatorë kanë ofruar shërbim për bizneset.

Akses në internet për përdoruesit e biznesit dhe aksesit në internet për masën e gjerë kanë teknologjikisht të njëjtën mënyrë ofrimit. Operatorët përdorin të njëjtat pajisje dhe ndërfaqe te rrjet për të siguruar aksesin si për përdoruesit e rezidenciale edhe për ata biznes. Në këtë drejtim, ka përparësi teknologjike në ofrimin e shërbimeve për kategoritë e ndryshme të publikut të gjerë. Shërbimi për përdoruesit familjarë mund t`i ofrojne shërbime për konsumatorët e biznesit të vogel ose SME në afat të shkurtër, pa kosto të rëndësishme ose nuk ndërmerren rreziqe të konsiderueshme.

Bazuar në këtë, AKEP konsideron se epërsi në segmentin e shërbimeve të komunikimeve elektronike për akses në internet për përdoruesit në shtëpi dhe shërbimeve të aksesit në internet për përdoruesit e biznesit që përdorin shërbimet standarde mund të konsiderohet të jetë mjaftushëm të këmbyeshëm në aspektin e furnizimit që të konsiderohet si një treg.

Nga ana e ofertës, në aspektin e shërbimeve për publikun e gjerë dhe shërbimeve për konsumatorët me kërkesat specifike, nevoja për të menaxhuar një numër të madh të linjave,

në krahasim me numrin e linjave për përdoruesit e mëdha të biznesit mund të kërkojnë investime burimet njerëzore dhe logjistike (p.sh. Help Desk-s, shërbim për kliente), të cilat përbëjnë një alternativë më pak tërheqës në afat të shkurtër për një operator që ofron shërbime vetëm për klientët e mëdha të biznesit të përshatatet për të ofruar shërbim në tregun për publikun e gjerë.
Në anën tjetër, një operator që ofron shërbime për tregun masiv nuk do të kishte hyrë në një afat të shkurtër të ofrojë shërbime në tregun për përdoruesit ndërmarrje(biznes), për shkak se një sipermarrje e tillë kërkon investime në lidhje me aftësinë për të krijuar fonde për të garantuar nivelin e shërbimit (p.sh.. gjatë shërimit, mbështetjen e klientëve, përshtatjen e produkteve).
Për sigurimin e burimeve të aksesit në internet për bizneset korporata operatorëve iu nevojite përdorimi i rrjeti të tyre të fibër-optike ose të kontaktojnë kapacitete transmetuese nga operatorë të tjerë të tjera. Sipas informacionit të deklaruar në AKEP nga operatorët që ofrojnë akses të dedikuar, pwr t'i dhënë përdoruesit fundor mundësi aksesi, kur nuk kanë vetë rrjetin e tyre, përdorimin linjat me qira. Duke pasur parasysh afatet shtrënguese për të kapur treg dhe shpenzimet në mënyrë të konsiderueshme më të ulëta për linjat me qira në krahasim me ndërtimin e rrjeteve të veta, operatoret, me qëllim për të filluar shërbimin e dedikuar kanë barrierat më të ulëta në hyrje në shërbimet e aksesit me pakicë me cilësi të veçantë në krahasim me barriera ndaj penetrimit të tregut të aksesit broadband për publikun masiv. Përveç kësaj duhet theksuar se sigurimi i aksesit të dedikuar shpesh nuk është aktiviteti kryesor i këtyre operatorëve. Ato ofrojnë akses të dedikuar si pjesë e komplekse telekomunikacionit dhe zgjidhjeve IT duke e ofruar shërbimet cloud, mirëmbajtjen e serverëve dhe të tjerët.
Bazuar në sa më sipër, AKEP gjykon se shërbimet për konsumatorët e biznesit (aksesit të dedikuar) dhe shërbimeve për publikun e gjerë nuk duhet të konsiderohet i njëjtë tregu.

Konkuluzion
Si rezultat i analizës dhe duke marrë parasysh dallimet në çmim dhe karakteristikat e konsumatorëve të broadband të shitjes në masë me pakicë (familjarë, bizneset e vogla dhe të mesme) dhe aksesit të dedikuar i dizenjuar për përdoruesit e mëdha të biznesit, si dhe nga mungesa e zëvendësueshmërisë së ofertës, AKEP konsideron se tregu për akses broadband me pakicë nuk përfshin produktet dhe shërbimet e aksesit të dedikuar të cilat janë kufizues të shërbimeve për akses broadband të tregut me pakicë.

<u>Zëvëndësueshmëria midis llojeve të ndryshme të aksesit broadband</u>

Në tregun shqiptar sigurimi i aksesit broadband ne internet realizohet përmes teknologjive të ndryshme, të cilat ndahen në dy lloje aksesi: me tela (wire) dhe pa tel (wireless).
Në përcaktimin e tregut të produktit do të vlerësohet nëse ka zëvendësueshmëri dhe kërkesë për llojeve të ndryshme të aksesit broadband të ofruara nëpërmjet rrjeteve dhe teknologjive në dispozicion në përiudhën aktuale dhe në dy vitet e ardhshme.

- Përmbledhje

Në përgjithësi, në krahasim me periudhën e analizes pararëndëse u vereh një tëndëncë e rënies së cmimit të aksesit me tel dhe pa tel në internet broadband, rritjen e shpejtësisë të download-it në planet bundle dhe rritje e sasise të të dhënave të trasmetuara. Por ajo qw verehet ne lidhje me
Bazuar në argumenat e mësipërm në lidhje me llojet e ndryshme të aksesit mund të gjykohet se shërbimet e ofruara në vendodhje fikse nëpërmjet ADSL, LAN CATV dhe FTTx kanë karakteristika të ngjashme në përdorimin e pritshëm dhe kanë çmimeve të ngjashme. Nga njëra anë në këto lloje aksesi sigurohet një lidhje më e besueshme dhe sigurohet transmetimi me shpejtësi të lartë se sa aksesi mbi teknologjitë wireless. Nga ana tjetër, kushtet e çmimeve

për shfrytëzimin e aksesit në internet wired janë më të dobishme se sa kushtet e aksesit të bazuar në wireless duke pasur parasysh pajtimet mujore, tarifat e instalimit dhe kostoja e pajisjeve fundore.
Kjo jep arsye të gjykosh se për ndonje rritje te cmimit të vogël (5-10%), por jotranzitore të ndonjë nga llojet të aksesit Wired (ADSL, CATV, LAN dhe FTTx) përdoruesit do të jenë të gatshëm për të zhvendosur kërkesën për një nga llojet e tjera aksesi Wired, por nuk ka gjasa për të zëvendësuar aksesin wired me aksesn ne internet broadband wireless.
AKEP gjykon se përdoruesit fundorë e perceptojnë aksesin e internetit në celular më shumë si një shërbim plotësues për të hyrë në një vend të caktuar, në vend se zëvendësueshmërisë. Argument për këtë pretendim është fakti që tendenca e rritjes së pajtimeve ne akses në internet nga celularet dhe akses nga vendodhje fikse në të njëtën kohe. Pra nuk ka pajtimtar që të mohojë aksesin në internet nga rrjetet fikse në vend që të ketë akses në internet nga një llogari përmes rrjetit cellular. Të dhënat për penetrimin e aksesit broadband nga rrjetet fikse dhe aksesit nga rrjetet celuare në internet për periudhën 2010-2014, të paraqitur në Figurën mëposhtë është gjithashtu arsye për të besuar që konsumatorët perceptojnë këto dy shërbime si plotësuese.
Volume i të dhenvaë nga rrjet celulare u rrit nga vitit 2013 ne 2014 me rreth 2.43 here. Ne fundvitin e 2014 volumi i transmetuar nga rrjetet celulare zuri rreth 13 % te volumit total tw trasmetimit. Në fund të 2014 nga rrjete celulare u trasmetua me GPRS/UMTS një volum prejt rreth 6.3 milion Gbyte, kurse nga rrjetet fikse rreth 41.6 milion Gbyte. Duke pare pjeset e vogel që ze volume i te dhenave nga rrjet celulare në krahasim me totalin mund të themi se konsumatorët e kanë aksesin nga rrjet e celulare si shtesë të aksesit nga vendndodhje fikse, me qëllimin kryesor - aksesin në shërbimet që nuk kërkojnë shkëmbimin e një vëllim të madh të trafikut (të tilla si navigimi në web, aksesi në email, etj) dhe në pozicione ku ka mbulim me këtë shërbim.
Deri në raundin e ardhshëm të analizës së tregut pritet që aksesi nga celularet të ketë zhvillime pozitive duke pasur parasysh implementimin e teknologjisë LTE (4G) për të siguruar akses broadband internet. Kjo teknologji që mund të ndikojë në trendin e penetrimit të aksesit fiks dhe celuar dhe në konsumin e këtyre shërbimeve.
Përsa i përket karakteristikave që lidhen me produktet e aksesit, ai i realizuar përmes valeve ndryshon nga ai i realizuar nga vendodhje fikse permes rrjeteve kabllore, duke pasur parasysh përdorimin e ajrit gjatë kryerjes së transferimit të të dhënave nga lloje të ndryshme të aksesit pa tel. Ato janë të prekshme nga kushtet e motit, të cilat mund të shkaktojnë ndërprerje serioze në ofrimin e shërbimeve
Bazuar në informacionin e mesiper, AKEP konsideron se nuk ka asnjë zëvendësueshmëri nga ana e kërkesës midis aksesit në internet në një vendodhje fikse dhe aksesit në internet nga celularët në internet, sipas AKEP këto shërbime janë mjaftushëm komplementare.

Në një analizë të zëvendësueshmërisë nga ana e ofertës duhet të analizohet gatishmëria e një njësie ekonomike që nuk është aktive në tregun përkatës të produktit, për të hyrë në treg brenda një periudhe të shkurtër kohore pa kosto të rëndësishme si rezultat i një rritje të vogël, por të rëndësishme dhe të qëndrueshme të çmimeve.
Gjatë disa viteve të fundit, duke përfshirë periudhën që mbulohet nga kjo analyze ka pasur një proces të ndërtimit dhe përmirësimit të rrjeteve të ofruesve të aksesit wireline, i cili është rezultat i zhvillimeve teknologjike dhe kërkesave më të larta të konsumatorëve. Për shembull, për disa vjet Albtelecom zhvilloi paralelisht akses me rrjetin e bakrit dhe më rrjetin optik. Një pjesë e abonentëve zëvendësuan shërbimet për të hyrë në internet nga rrjetet tradicionale me ato nëpërmjet ADSL nëpërmjet ofertave individuale ose bundled shërbimeve të ofruara. Gjatë këtyre viteve gjithashtu u mor parasysh fakti se operatorët që ofrojnë akses në internet nëpërmjet rrjetit kabllor për transmetim dhe / ose shpërndarjen e programeve të radios dhe televizionit, ndërtuan rrjete lokale ose optike, paralel me rrjetet e tyre me bosht të përbashkët dhe ofruesit e aksesit LAN ose përmirësuan rrjetet e tyre me lidhje optike për përdoruesit fund apo në pikat e aksesit të rrjetit. Në funksion të kësaj, AKEP konsideron se në aspektin e

zëvendësueshmërisë së ofertës, lloje të ndryshme të aksesit Wired (ADSL, LAN, CATV dhe FTTx) bien në një treg përkatës të produktit.
AKEP shqyrtoi dhe zëvendësueshmërine e ofertës përmes aksesit broadband pa tel dhe aksesit me tel (përfshë edhe celularët) dhe beson se në mënyrë që të hyjnë në tregun e aksesit wired broadband, për një operator që ofron akses në internet wireless është e nevojshme për të ndërtuar rrjetin e tij fiks ose për të marrë një të tillë me qera. Duke pasur parasysh nevojën për të përdorur një sasi të konsiderueshme të investimeve, prania e kostove të zhytura ose të bllokuar dhe barrierat e natyrës ekonomike (të tilla si emir i mirë, ngurrimi nga ana e konsumatorëve për të transferuar nga një ofrues tek tjetri, etj), AKEP konsideron se nuk ka gjasa që një operator që ofron akses broadband në intenet pa tel (përfshirë atë celular), për të hyrë në tregun aksesit broadband nga rrjete fikse në përgjigje të një rritje të vogël, por të rëndësishme dhe të qëndrueshme të çmimeve brenda një kohe të shkurtër dhe pa pësuar shpenzime të mëdha. E kundërta është gjithashtu e vërtetë, se ofrimi i aksesit të broadband wireless nga operatorë që ofrojnë akses wired broadband në internet është i lidhur me përdorimin dhe caktimin individualisht të burimeve të pamjaftueshme si p.sh spektrit të frekuencave të radios (për aksesin celular), si dhe investime të konsiderueshme në ndërtimin e rrjeteve pa tel (përfshirë këtu edhe shërbimet fikse ofruar mbi rrjete celulare).
Bazuar në sa më sipër, AKEP konsideron se llojet e analizuara të aksesi pa tel (BWA / FWA, UMTS / HSPA + dhe 4G LTE) nuk janë të zëvendesueshmë në aspektin e produktit me pakicë të aksesit broadband në internet ëireless.

Konkluzion

Duke krahasuar karakteristikat funksionale dhe çmimet e llojeve të ndryshme aksesit bradband pa tel dhe me tel nga rrjete fikse, AKEP gjykon se nuk ka zëvendësueshmeri në kërkesës dhe ofertë për akses broadband Wired dhe Wireless. Përveç kësaj, AKEP analizoi dhe vendosi që aksesi në internet nga rrjetet celulare është një shërbim plotësues, duke pasur parasysh se tregu me pakicë i aksesit në internet ofron paketa ku përfshihen dhe aksesi Wired në internet edhe aksesi celular në internet.
Tregu me pakicë për aksesin broadband në internet përbëhet nga produkte standarde dhe shërbime të ofruara më vete ose/dhe në bundle me shërbime të tjera të komunikimeve elektronike në tregun masiv (përdoruesit e familjarë dhe biznes) nëpërmjet rrjetit telefonik tradicional (ADSL), rrjetit fibër-optike (FTTH, FTTB, FTTC / FTTN), rrjetit të transmetimit dhe / ose shpërndarjes së programeve të radios dhe televizionit, bazuar në teknologji kabllore (CaTV) me kabllo koaksiale ose sistemet koaksiale hibride (HFC) dhe rrjetit të bazuar mbi teknologjinë Ethernet LAN.

<u>Dimensioni gjeografik i tregu përkatës</u>

Sipas rregullores se anaizës së tregut duhet përcaktuar edhe dimensioni gjeografik i tregut përkatës, i cili përfshin një zone të caktuar gjeografike të tregut përkatës, në të cilin produket dhe/ ose shërbimet e zëvendësueshme të rrjeteve të komunikimeve elektronike të ofruara në kushtet konkurruese janë të njëjta ose të ngjashme dhe ndryshojnë nga ato në zonat fqinje gjeografike.
Caktimin i fushëveprimit gjeografik të këtij tregu përkatës është bazuar në dy kritere:

- mbulimi territorial i rrjeteve publike të komunikimeve elektronike;
- prania e të njëjtave kërkesa statutore dhe rregullatore për sigurimin e rrjeteve dhe / ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Bazuar në këto dy kritere, tregu gjeografik mund të përkufizohet si territori lokale, rajonale ose kombëtare

1. Shtrirja territoriale e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike

Duke marrë parasysh legjislacionin aktual, AKEP duhet të përcaktojë nëse ekzistojnë kushte të ngjashme konkurruese mbi kërkesën dhe ofrimin e shërbimeve që janë brenda fushës së veçantë të produktit (tregut broadband pakicë në vend). Në këtë drejtim, Shënimet shpjeguese

të Rekomandimit 2014 mbi tregjet relevante ka përcaktuar se duhet të merret parasysh shtrirja e rrjetit të operatorit me pjesën më të madhe të tregut në tregun përkatës të produktit, dhe nëse kjo kompani ofron shërbimet e veta në të njëjtat kushte në në të gjithë vendin, duke pasur parasysh mbulimin kombëtare të rrjetit të saj.

Sipas të dhënave të deklaruara nga operatorët pjesët e tregut sipas numrit të pajtimtarëve me akses broadband fiks të Albtelecom janë 39%. Rrjeti i Albtelecom ka shtirje gjeografike në të gjithe vendin dhe sjellja tregtare e Albtelecom për të ofruar shërbime që bien brenda fushës së tregut të shitjes me pakicë në vend të aksesit broadband në internet është e njëjtë. Në paragrafin e mësiperm janë analizuar më në detaje çmimet e shërbimeve të ofruara nga incumbent. Albtelecom ofron të njëjtat shërbime, tarifave / çmime dhe kushte për përdorimin e shërbimeve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
Bazuar në sa më sipër mund të arrijmë në përfundimin se duke pasur parasysh fushëveprimin kombëtar të rrjetit të operatorit incumbent dhe karakteristikat uniforme të produkteve dhe të shërbimeve në lidhje me çmimet dhe kushtë e ofrimit në nivel kombëtar, fushëveprimi gjeografik i tregut është kombëtar.

IV.2 Perkufizimi i Tregjeve me shumicë

Meqenese ne perkufizimin e tregjeve me pakice, te kryer ne seksionin e mesiperm, AKEP arriti ne perfundimin se nuk ndryshime te ndjeshme nga vlersimi i KE per tregjet perkates ne shenimet shpjeguese te rekoamdnimit te vitit 2014, edhe per tregjet me shumice AKEP vlereson te ri-formuloje keto tregje sipas rekomandimit te fundit te KE, pra si me poshte:

1. Tregu me shumice i aksesit ne nivel lokal ne vendndodhje fikse (WLA-tregu 3/a rec.2014 KE)

2. Tregu me shumice i aksesit ne nivel qendror per produkte te tregut te pergjithshem (WCA- tregu 3/b rec.2014 KE)

3. Tregu me shumice i aksesit me cilesi te larte ne vendndodhje fikse (WHQA- tregu 4/a rec.2014 KE)

Produktet dhe sherbimet qe bejne pjese ne keto tre tregje mund te permblidhen si me poshte:

- Tregu perkates me shumice i aksesit lokal nga vendndodhje fikse (WLA) perfshin te gjitha sherbimet/produket fizike dhe virtuale te cilat mundesohen nga aksesi ne nivel local (shared + full LLU, tubacione ne zona urbane etj), produkte dhe sherbime te cilat mundesojne perfituesin e aksesit te ofroje sherbime broadband perdoruesve te tregut masiv dhe me nivel te larte kontrolli ne QoS;
- Tregu perkates me shumice i aksesit qendror nga vendndodhje fikse (WCA) perfshin te gjitha sherbimet/produket fizike dhe virtuale si aksesi bitstream, te cilat i mundesojne perfituesit te aksesit te ofroje sherbime broadband perdoruesve ne zona te ndryshme/te medha gjeografike per tregun masiv te aksesit broadband me pakice, te cilat nuk mundesohen nga aksesi ne nivel local, dhe qe nuk bejne pjese ne tregun e aksesit me cilesi te larte per biznese (WHQA).
- Tregu me pakice per sherbime me cilesi te larte (WHQA) perfshin produkte/sherbime qe jane te projektura per nevojat specifike te klienteve individuale duke perfshire nivele te larta te QoS, disponibilitet te larte, shpejtesi te larta download dhe upload, nivel te ulet te konfliktit (contention) ne transmetimin e te dhenave, etj. Keto jane sherbime qe kerkohen nga biznese te medha dhe qe kerkojne edhe lidhjen midis pikave te ndryshme te prezences se biznesit, dhe qe zakonisht ofrohen nepermjet

linjave me qira apo lidhjeve broadband (LLU, ethernet etj). Ne kete treg me pakice perfshihen edhe institucionet publike me prezence ne shume qytete/fshatra qe kane nevoje per lidhje te ketyre pikave te prezences, kerkese e cila pritet te rritet me rritjen e dixhitalizmit te sherbimeve dhe games dhe cilesise se sherbimeve e-government.

- Tregu i aksesit me cilesi te larte ne vendndodhje fikse eshte i lidhur me ofrimin e konektivitetit te bizneseve te mesme/te medha per akses broadband dhe sherbime te tjera te dhenash. Ne nivel me shumice ne rekomandimet e meparshme te KE, ky treg eshte perkufizuar si tregu i segmenteve terminuese te linjave me qira, nepermjet te cilave operatore te ndryshem kane mundesine te ofrojne sherbime me cilesi te larte bizneseve, pasi linjat me qira sigurojne bivele te larta QoS, bandwidth simetrik dhe te dedikuar.
- Dimensioni gjeografik i te tre tregjeve tregut eshte kombetar, pavaresisht se ka variacion te madh te konkurrences/prezences me rrjete lokale te aksesit midis zonave te ndryshme gjeografike (qytete kryesore si Tirana v qytete te vogla)

Sipas Rregullores se Analizes se Tregut, AKEP kryen testin e tre kritereve nese nje treg i analizuar nuk eshte pjese e listes se tregjeve perkates te pikes 1, Neni 3 i Rregullores si dhe per tregjet qe nuk jane pjese e *listës së tregjeve përkatës të Rekomandimit të KE, që është në fuqi*.

Meqenese tre tregjet e mesiperme jane pjese e listes se rekomandimit ne fuqi te KE per tregjet perkates, AKEP vlereson se nuk eshte e nevojshme te kryesje testin e 3 kritereve per keto 3 tregje.

IV.3 Analiza per FNT ne tregjet me shumice

Megjithe ndryshimin e perkufizimeve te tregjeve perkates nga KE ne vitin 2014, sherbimet/produket baze te tregjeve perkates te riformuluar jane te ngajshme me ato te rekomandimit te meparshem 2007, mbi te cilat eshte bazuar Analiza e tregut te AKEP ne Shkurt 2014. AKEP gjykon se ne treg nuk kane ndodhur dhe nuk pritet te ndodhin ndryshime te rendesishme qe te reduktojne deri ne eliminim poziten e FNT te Albtelecom ne keto tregje te analizuar ne vitin 2014. Nder keta faktore permendim:

- megjithe zhvillimin dhe dinamikat e tregut me pakice braodband nga rrjete fikse, Albtelecom ka pasur pjese tregu te qendrueshme ne nivelin 40% ne tregun me pakice te aksesit broadband;
- megjithe rritjen e zonave te mbulimit te disa operatoreve altrenative, Albtelecom eshte i vetmi operator rrjeti fiks me prezence ne zona urbane dhe nder-urbane, me infrastrukture aktive dhe pasive kombetare dhe lokale njekohesisht;
- prezenca e ATU ne treg me rrjet kombetar (nderurban) nuk duket se ka ndikuar ne tregun me shumice te aksesit broadband;
- migrimi i plote ne NGN/NGA i rrjetit te Albtelecom ka krijuar avantazhe dhe kapacitete te medha ne ofrimin e sherbimeve te aksesit broadband me shumice;
- megjithe renien e numrit te linjave te telefonise fikse, Albtelecom vazhdon te kete prezence te forte ne segmentin lokal me linja te perdoruesit fundor (rreth 70%), shume me te larte se operatoret e tjere alternative, duke pasur dominance ne ofrimin e segmenteve terminuese te linjave me qira si dhe per LLU;
- tendenca e tregut me pakice drejt ofrimit te paketave te sherbimeve te integruara (bundles) ka krijuar avantazh per Albtelecom si sipermarres ofrues i sherbimeve te aksesit broadband, telefoni fikse dhe sherbime celulare. Rritja me 3 here ne vitin 2015 e pajtimtareve te Albtelecom me paketa trefishe (Internet, telefoni dhe IPTV) tregojne per

pozita te forta te Albtelecom ne tregjet perkates me pakice dhe avantazhe ndaj operatoreve te tjere, te cilet nuk mund te replikojne lehtesiht keto oferta.

- Fillimi i ofrimit te sherbimeve 4G nga rrjetet celulare dhe ritja e ndjeshme e perdorimit te aksesit broadband nga keto rrjete, rrisin presionin konkurrues per aksesin broadband nga rrjete fikse. Megjithate, keto sherbime te aksesit broadband nga rrjete celulare 3g?4G konsiderohen me shume si komplementare dhe jo zevendesues te aksesit broadband nga rrjete fikse.
- megjithese aksesi ne LLU nuk ka pasur rezultat dhe aksesi bitstream ka filluar te perdoret vetem ne vitin 2014, AKEP gjykon se perdorimi/interesi i ulet per keto sherbime nuk vjen per shkak te mungeses/eliminimit se dominances se Albtelecom por per shkaqe historike te investimeve paralele ne rrjete lokale nga operatoret alternative.
- Presioni konkurrues nga platforma te tjera alternative ne aksesin broadband me shumice eshte ende i ulet per te ndikuar ne reduktimin e pozites dominuese te Albtelecom.
- Megjithese Albtelecom ka prezence te ulet ne tregun me pakice te linjave me qira, ne nivel me shumice Albtelecom eshte ofruesi me i madh me pjese tregu 60% per kapacitetet e dhena me qira, 49% per numrin e linjave dhe numrin e operatoreve qe i ka ofruar linja/kapacitete me qira.
- Megjithe numrin e madh te operatoreve te rrjeteve fikse me infrastrukturen e tyre, prezenca e tyre eshte fokusuar ne qytete te caktuar apo zona te caktuar abrenda qyteteve, dhe vetem Albtelecom ka infrastruture rrjeti me mbulim te madh ne te gjitha qytetet, te mebeshtetur dhe nga rrjeti/lidhjet nderurbane. Migrimi i rrjetit fiks te Albtelecom ne NGN/NGA ka rritur kapacitetet e lira ne infrastrukturen fizike (sidomos ne zonat urbane/lokale) si dhe mundesite per produkte aksesi me shumice te shtreses 2 (layer 2 wholasale access products-WAP), dhe kjo infrstrukture dhe produkte jane te padulplikueshem nga operatoret e tjere te rrjeteve fikse.

Per sa me siper, AKEP vlereson se Albtelecom ploteson kriteret per FNT ne tregjet perkates te meposhtem:

1. Tregu me shumice i aksesit ne nivel lokal ne vendndodhje fikse (WLA)

2. Tregu me shumice i aksesit ne nivel qendror per produkte te tregut te pergjithshem (WCA)

3. Tregu me shumice i aksesit me cilesi te larte ne vendndodhje fikse (WHQA);

V. ANALIZA E TREGUT TE AKSESIT NE INFRASTRUKTURE PASIVE NE NIVEL KOMBETAR

Perkufizmi i tregjeve me shumice eshte i lidhur identifikimin e inputeve te nevojshme per te ofruar sherbime/produkte ne tregun/tregjet perkates me pakice. Per sherbimin e aksesit broadband me pakice dhe sherbime te tjera te te dhenave te lidhura me kete treg, ne nivelin me pakice AKEP vleresoi ne kapitullin meparshem se edhe ne Shqiperi (si edhe ne rekomandimin 2014 te KE) ekzistojne kushtet per te dalluar dy segmente te pergjithshsme te kerkeses se tregut: kerkesa e perdoruesve te zakonshem te aksesit broadband pra tregu masiv/i pergjithshem me pakice, dhe kerkesa e bizneseve te medha per sherbime me cilesi te larte, pra tregu per akses bradband dhe sherbimesh te dhenash me cilesi te larte. Njekohesisht, per sa i perket nivelit te aksesit, AKEP vlereson se ekziston nje ndarje per aksesin ne nivel lokal dhe ne nivel qendror per sherbimet broadband nga rrjete fikse, duke i pershtatur me perkufizimet e reja te rekomandimit te KE, per heqjen e ndarjeve te meparshme midis aksesit virtual (bitstream) dhe fizik (LLU), per pershtatje me zhvillimet ne rrjette fikse NGA.

Tregu i aksesit me cilesi te larte ne vendndodhje fikse eshte i lidhur me ofrimin e konektivitetit te bizneseve te mesme/te medha per akses broadband dhe sherbime te tjera te dhenash. Ne nivel me shumice ne rekomandimet e meparshme te KE, ky treg eshte perkufizuar si tregu i segmenteve terminuese te linjave me qira, nepermjet te cilave operatore te ndryshem kane mundesine te ofrojne sherbime me cilesi te larte bizneseve, pasi linjat me qira sigurojne bivele te larta QoS, bandwidth simetrik dhe te dedikuar.

Rekomandimi 2014 sqaron se ne perkufizmin e tregut me cilesi te larte, nje ceshtje qe mund te trajtohet nga rregullatoret kombetare eshte nese ka nevoje per nderhyrje ex-ante ne tregun e aksesit ne infrastrukture per backhaul (i ndryshem nga aksesi ne rrjete fikse) me qellim lehtesimin ose rritjen e konkurrences ne ofrimin e sherbimeve te komunikimeve elektronike (nga rrjete fikse dhe celulare). Inputet me te rendesishme te ketij tregu konsiderohet infrastruktura pasive apo aksesi pasiv ne infrastrukture si tubacione dhe fiber optike e erret (dark fibre). Rregullimi ex-ante i ketij tregu do te sillte perfitime:

- per operatoret e rrjeteve celulare ne menaxhimin e trafikut te te dhenave, te cilat kane rritje shume te madhe ne vitet e fundit me 3G/4G dhe kjo tendence pritet te vazhdoje edhe ne vitet e ardhme
- per operatoret alternative te rrjeteve fikse per te rritur prezencen e rrjeteve te tyre duke lidhur pjese te rrjeteve te tyre ne zona gjeoagrafike te ndryshme, perfshire ne zona te largeta.

Rregullimi i aksesit ne elementet pasive te rrjeteve (tuba, shtylla, dark fibre etj) ka marre nje rendesi te madhe ne nivel te KE pasi ky akses mundeson zgjidhje per akses broadband me shpejtesi te larte dhe ne reduktim te kostove per aksesin broadband. Per te realizuar kete KE ne Direktiven vitit 2014 (Directive 2014/61/EU) ka rekomanduar madje perdorimin e infrastruktures se rrjeteve te tjera te utiliteteve si energji elektrike, uje etj, per zhvillimin e rrjeteve broadband.

V.1 Perkufizimi i tregut

Perkufizmi i ketij tregu perkates perfshin vleresimin e produkteve/sherbimeve qe mund te konsiderohen si te zevendesueshme dhe pjese e te njejtit treg. Si pikenisje, AKEP vlereson te perkufizoje tregun me shumice te aksesit ne infrastrukture pasive te rrjeteve te komunikimeve elektronike qe perfshin tubacionet dhe fibrat optike jo-te ndricuara (dark fiber) ne nivel kombetar, pra zonat nder-urbane. Per produktet/sherbimet e zvendesueshme AKEP vlereson se produkte/sherbimet me te rendesihme per analize zevenesueshmerie jane sa me poshte:

- Infrastruktura lokale v kombetare;
- Infrastruktura kombetare aktive v infrastruktura kombetare pasive
- Aksesi ne tubacione v aksesi ne fibra optike te pandricuara
- Aksesi ne tubacione v shtylla

- **Infrastruktura lokale v kombetare;**

AKEP nepermjet analizave te meparshme per LLU ka vendosur masa rregulluese per Albtelecom edhe per aksesin ne elementet pasive te infrastruktures se rrjetit te Albtelecom. Megjithate keto masa jane vetem per rrjetin lokal dhe nuk perfshijne aksesin ne infrastrukturen pasive kombetare apo nder/urbane. Sic eshte theksuar ne dokumenta te tjera te analizave te tregut dhe ne seksionet e meparshme te ketij dokumenti, karakteristike e tregut fiks ne Shqiperi eshte se shume sipermarres (rreth 80) kane investuar ne rrjetet e tyre fikse neprmjet et cilave ofrojne sherbime te telefonise fikse dhe aksesit broadband, per perdorues familjare dhe biznesi. Megjithate gjurma e pothuajse te gjitha rrjeteve fikse alternative eshte e kufizuar ne zona lokale si qytet apo zona atraktive rurale. Ne keto zona operatoret kane rrjetet e tyre te aksesit, dhe ky ka qene nje nder faktoret kryesore qe interesi per aksesin e hapur ne rrjetin lokal te Albtelecom (LLU) ka qene shume i ulet dhe ende nuk ka perdorim te LLU.

Megjithe investimet e shumta te operatoreve alternative ne rrjete lokale, investimet ne rrjet kombetar nga keta operatore jane inekzistente. Nje ofrues rrjeti lokal rezulton se ka te veshtire qe te investoje ne rrjet kombetar/nder-urban per te ndertuar infrastrukture pasive/mbeshtetese me tubacione/fiber optike. Pra, operatoret alternative qe zoterojne rrjet lokal nuk mundet qe lehtesisht te investojne ne lidhje nder-urbane.
Edhe ATU qe zoteron infrastrukture pasive me tuba dhe fiber optike ne nivel kombetar, nuk ka prezence ne zona urbane me rrjet lokal tubash/fibra optike. Pra, edhe ofruesit e infrastruktures kombetare te tubave/fibrave optike e kane te veshtire te ofrojne kete infrastrukture ne nivel lokal. Keto kufizime te zevendesueshmerise ne anen e ofertes jane te lidhura edhe me lejet e ndertimit: lejet e ndertimit ne infrastruktura ne nivel lokal mund te sigurohen nga organet e pushtetit vendor, ndersa per lidhjet/rruget kombetare lejet mund te merren nga organe te pushtetit qendror. I vetmi operator qe zoteron infratsrukture pasive ne nivel lokal dhe kombetar eshte Albtelecom. Kjo rezulton pasi Albtelecom eshte operatori incumbent dhe historikisht ka qene monopol i rrjetit fiks kombetar ne Shqiperi.

Ne anen e kerkeses, eshte e qarte se nuk ka zevendesueshmeri midis aksesit ne infrastrukture pasive ne zona lokale dhe lidhjet nder-urbane, pasi ato sherbjne per qellime te ndryshme. Ne zona lokale aksesi ne tubacione perdort kryesiht per rrjetin lokal dhe lidhjen me perdoruesit fundor, ndersa ne zona nder-urbane ai sherben per lidhje me pjese te rrjetit ne zona te tjera gjeografike dhe/ose per zgjidhje ne backhaul.

Si perfundim, aksesi ne infrastrukture pasive lokale dhe kombetare nuk jane pjese e te njejtit treg perkates.

- **Infrastruktura kombetare aktive v infrastruktura kombetare pasive**

Aksesi ne infrastrukturen pasive kombetare perben nje input qe mund te perdoret nga rrjette fkse dhe celulare per te zgjeruar gjurmen e prezences se rrjteve fikse te operatoreve altrenative si dhe per zgjidhje backhaul per operatoret celulare. Ky akses mun te zvendesohet me akses ne infrastrukture aktive, ne formen e linjave me qira apo kapaciteteve te dedikuara. Megjithate, aksesi ne infrastrukture pasive ofron fleksibilitet me te madh per operatoret, pasi mund te kryejne vete konfigurimet e rrjetit aktiv dhe zgjidhjet backahaul duke i pershtatur me rrjetin e tyre dhe kerkesen ne tregun me pakice. Njekoheisht, diferencat e medha ne tarifat e aksesit ne infratsrukture aktive dhe pasive, cojne ne nivel te ulet zevendesueshmerie per tu

konsideruar pjese e te njejtit treg perkates. Pra ne anen e kerkeses, aksesi ne infrastrukture aktive nuk mund te konsiderohet zevendesues i afert per aksesin ne infratsrukture pasive.

Ne anen e ofertes, nje zoterues i infratsruktures pasive mund te ofroje edhe infratsrukture aktive, ne formen e kapaciteve transmetuese dhe zgjidhje te tjera teknike. Megjithate, nje ofrues i aksesit ne fibra te pa-ndricuara (dark fiber) duhet te kryeje investime te konsiderueshm per te ofruar fibra te ndricuara (lit fiber), pasi pajisjet terminale dhe zgjerimi i kapacitetit te fibres kane kosto te konsiderueshme.

Si perfundim, aksesi ne infrastrukture aktive dhe pasive nuk jane pjese e te njejtit treg perkates.

- **Aksesi ne tubacione dhe fiber optike te pandricuar (dark fiber)**

Aksesi ne fiber te pandricuar nuk konsiderohet si pjese e te njetit treg perkates me fibren optikr te pandricuar (dark fiber). Nderkohe aksesi ne tubacione dhe aksesi ne dark fiber mund te konsiderohen si zevendesues, pasi:

- Kostot me te medha te infrastruktures pasive jane punet civile, dhe ne tubacionet e instaluara mund te vendosen lehtesisht dhe pa kosto te larta shtese fibra optike te pandricuara apo edhe lloje te tjera kabllosh. Pra nje zoterues i tubacioneve lehtesisht mund te ofroje edhe fibra optike te pandricuara.
- Ne anen e kerkeses, aksesi ne tubacione eshte i nevojshem per te shtrire kabllot optike qe mundesojne zgjidhjet teknike per rrjetin e operatorit qe perfiton kete akses. Meqenese fibra optike e pandricuar i mundeson operatorit tjeter konfigurimet dhe zgjidhjet teknike te nevojshme per rrjetin e tij, operatori kerkues i konisderon zvendesues te afert aksesin ne tubacione dhe aksesin ne fibra optike te pandricuara, ne kushtet kur tarifat e dy sherbimeve nuk kane diferenca te medha.

- **Tubacione v Shtylla**

Tubacionet dhe shtyllat jane dy menyra per shtrirjen e kabllove te telekomunikacioneve, perfshire fibren optike. Tubacionet perdoren per shtrimin nen-toke te infratsruktures, qe eshte menyra me siguri teknike, cilesi dhe kosto me te larte, ndersa shtyllat perdoren per lidhje ajrore te kabllove. Lidhjet ajrore mund te kene kosto me te ulet, por kane edhe probleme te sigurise teknike dhe njekohesisht kabllot ajrore kane amortizim me te shpejte, pasi per shkak te demtimeve duhet te zevendesohen me shpejt se kabllote nen-tokesore. Pra ne perspektive afat-gjate, kabllote e shtrira ne tubacione jane me ekonomike dhe eficente.

Ne terma te zevendesueshmerise, te dy menyrat jane zevendesuese te njera tjetres dhe ne disa akse te rrugeve kombetare, ka edhe fibra optike ajrore duke perdorur shtyllat. Meqenese si shtyllat dhe tubacionet perdoren per te njejtin qellim final dhe si alternativa zevendesuese te njera tjetres, ato mund te konsiderohen si pjese e nje tregu perkates.

Ne anen e ofertes, nje operator me rrjet nen-tokesor mund te ofroje edhe rrjet me lidhje ajrore nepermejt shtyllave, por eshte e veshtire qe nje operator qe ka rrjet ajror te kaloje lehtesisht ne ofrim te rrjetit ne rruge nentokesore. Pra ne anen e ofertes, nuk ka zevendesueshmeri midis dy llojeve te infrastruktures pasive: tubacione dhe shtylla.

Dimensioni gjeografik

AKEP ne perkufizimin e dimensionit te produkteve/sherbimeve te tregut perkates te akseist ne infrastrukture pasive kombetare, arriti ne konkluzionin se ky treg perfshin aksesin ne tubacione dhe fiber te pandricuar. Per sa i perket dimensionit gjeografik, AKEP gjykon se ai eshte kombetar duke perfshire vetem lidhjet nder-urbane, dhe jo rrjetin lokal me tubacione ne zona urbane. Dimensioni gjeografik i ketij tregu eshte i kufizuar vetm ne gjurmen e rrjetit te operatorit perkates qe zoteron infrastrukture me tubacione dhe/ose fiber optike ne akset e rrugeve kombetare apo qe lidhin zonat urbane.

V.2. Panorame e tregut me shumice te aksesit ne infrastrukture pasive ne nivel kombetar

Oferta dhe kapacitet e lira ne tubacione/fibra optike

Gjate vitit 2015 ka pasur rritje te perdorimit te tubacioneve. Albtelecom ka lidhur marrveshje me 4 operatore dhe deri ne fund te 2015 Albtelecom ka dhene akses ne 36 km tubacion, ndersa nga te gjithe operatoret raportohet se eshte dhene akses ne 61 km tubacione. Nje faktor qe ka ndikuar ne rritjen e perdorimit te perbashket te tubacioneve eshte edhe veprimtaria e AKEP per rritjen e sigurise teknike te rrjeteve te telekomunikacioneve/k.elektronike qe ka cuar ne heqjen e shume kabllove ajrore jashte kushteve te sigurise teknike.

Shumica e operatoreve te rrjeteve fikse zoterojne infrstrukturen e tyre ne nivel lokal, ndersa ne nivel kombetar, ofruesit e vetem te infrastruktures pasive jane Albtelecom dhe ATU.

Albtelecom

Gjatesia totale (lokale dhe kombetare) e rrjetit te tubacioneve te Albtelecom eshte rreth 1600 km, dhe me migrimin e plote te rrjetit ne NGN/NGA, Albtelecom ka hapesira te lira ne tubacione, urbane dhe nderurbane, qe kryesisht jane me diameter 100 mm, duke mundesuar vendosjen e disa kabllove ne keta tuba te lire.

ATU

Ministria e Puneve Publike dhe Transportit me Urdherin nr.120, date 23.08.2010 ka miratuar dhenien e lejes per ATU per ndertimin e rrjetit me fibra optike ne akset kombetare te Republikes Shqiperise (8 akse). Sipas kesaj leje:

- ATU do te ndertoje rrjet me fibra optike ne akset kryesore rrugore kombetare;
- ATU do te instaloje 6 kabllo/fibra optike, prej te cilave 2 jane per perdrorim nga vet ATU dhe 4 te lira per perdorim nga operatore te tjere, jo te lidhur me ATU;
- ATU i paguan shtetit Shqiptar pagese vjetore perj 4% te te ardhurave te realizuara nga perdorimi i infrastruktures se instaluar;
- Operatoret e tjere qe perdorin kabllote e lira optike paguajne 6% te te arrdhuarve te tyre, por jo me pak se 330 mije euro ne vit;

- Ne rast deshtimi te negociatave (3 muaj afat) per cmimin midis ATU dhe operatorit tjeter, mosmarrveshja zgjidhet vetem nga Gjykata e Tiranes.

- Afati i lejes per ATU eshte 20 vjet me te drejte rinovimi edhe 20 vjet te tjera.

ATU ka ndertuar rrjetin me fibra optike, dhe tubacione ne akset kryesore te rrugeve kombetre me gjatesi 750 km dhe rreth 20 pika prezence ne qytetet kryesore. Sic eshte cituar me siper, ne kete gjatesi ATU zoteron 6 tuba/kabllo optike, prej te cilave 2 jane per perdorimin nga vet ATU dhe 4 duhet te jepen per perdorim operatoreve te tjere.

Perdorimi i tubacioneve fibrave optike

Tabela e meposhteme paraqet dhenien e aksesit ne infrastrukturen pasive te tubave dhe fibres optike te pandricuar (ne zona urbane dhe nderurbane) per te gjithe tregun ne teresi dhe tre operatoret kryesore. Nga te dhenat vihet re se perdorimi i dark fiber eshte ne nivel te larte (rreth 920 km) dhe ofruesi kryesor eshte Albtelecom me rreth 67% pjese tregu.

TABELA V.1: AKSESI NE INFRASTRUKTURE PASIVE (2014-2015)

	2014				2015			
	Total tregu	Albtelecom	Abcom	ATU	**Total tregu**	Albtelecom	Abcom	ATU
Dark fiber	**927.00**	621.00	124.00	152.00	**924.00**	622.00	132.00	137
Akses ne tubacione	**19.00**	19.00	-	-	**61.00**	36.00	-	-
Total Fiber Optike		1500		752		1500		752
Total Tubacione		1600		752x6 (2+4)		1600		

Burimi: Te dhenat e operatoreve per Atlasin e AKEP

Nderkohe dhenia e aksesit ne tubacione eshte ne nivel shume te ulet. Megjithe rritjen ne 2015, perdorimi i perbashket tubacioneve arriti ne 61 km per te gjithe tregun, ku Albtelecom ka peshen kryesore me 60%. Bie ne sy ATU e cila megjithese ka ne dispozicion per operatoret e tjere 4 tuba 40mm x 750 km, nuk ka dhene akses ne tubacione.

Megjithese ne 2015 ka pasur rritje te perdorimit te perbashket te tubacioneve, proporcioni i tyre ne raport me totalin e tubacioneve te instaluara eshte shume i ulet si dhe vleresohet qe Albtelecom dhe ATU si dy ofruesit dominante te aksesit ne tubacione ne zona urbane dhe nderurbane (ATU vetem ne zona nderurbane) kane kapacitete te lira te paperdoruara ne tubacione. **Kapacitetet e lira eshte nje nga kriteret e rendesishme ne vleresimin e dominances se bashkuar.**

Tarifat e aksesit ne tubacione

Tabela e meposhteme paraqet tarifat e aplikuara nga Albtelecom per akses ne tubacione apo perdorim te perbashket te tubacioneve te rrjetit te Albtelecom. Ne dokumentin e nxjerre ne keshillim publik, AKEP paraqiti informacion per tarifat per vendosjen e nje kablli me diameter 20 mm ne tub me diameter 100 mm. Ne vijim te komenteve te keshillimit publik si dhe informacionit me te fundit te marre nga Albtelecom (shkresa e Albtelecom me Nr.8005 Prot., date 27.09.2016, njoftim i derguar operatoreve dhe AKEP per tarifat e reja te perdorimit te infrastruktures se lire ne tuba), AKEP ka perditesuar informacionin per tarifat e aplikuara nga Albtelecom, sipas tabeles se meposhteme. Tabela ne dokumentin e keshillimit

publik kishte vetem tarifat per vendosjen e nje kablli me diameter 20 mm te operatorit perfitues ne tub me diameter 100 mm te Albtelecom, ndersa tabela e re permban tarifat sipas tre kategorive te diametrave te tubave.

TABELA V.2: TARIFAT E AKSESIT NE TUBACIONE NE RRJETIN ALBTELECOM (2015-2016)

		Tarife Fillestare (Euro/km)	Tarifa Mujore (euro/km)							Ndryshimi ne %
			Deri me 30.09.2015	1.10.2015			1.10.2016			
	Distanca (Km)	Diametri (mm)	20 mm	deri ne 10 mm+0.5	>10-20 mm+0.5	>20-30 mm+0.5	deri ne 10 mm+0.5	10-20 mm+0.5	20-30 mm+0.5	20 mm
D1	<0.2	100	200	180	190	220	**80**	**90**	**100**	**-55%**
D2	0.2-5	80	160	120	145	179	**60**	**73**	**90**	**-54%**
D3	5-20	80	150	109	136	170	**55**	**68**	**85**	**-55%**
D4	20-40	80	140	104	128	160	**52**	**64**	**80**	**-54%**
D5	40-80	80	130	96	120	144	**48**	**60**	**72**	**-54%**
D6	80-160	80	120	88	112	136	**44**	**56**	**68**	**-53%**
D7	160-300	80	110	80	99	120	**40**	**50**	**60**	**-55%**
D8	>300	80	100	64	92	104	**36**	**46**	**52**	**-54%**

Shenim: Tarifat ne Euro pa TVSH

Nga informacioni i derguar nga Albtelecom per tarifat e tubave mund te vihet re se ne Tetor 2015 tarifat jane reduktuar me 5-10 % ne krahasim me tarifat e meparshme. Nderkohe reduktimi i kryer nga Albtelecom ne Tetor 2016 eshte shume i ndjeshem pasi tarifat e perdorimit te tubave reduktohen kryesisht me 50% (reduktimi varion nga 44% ne 56% dhe shumica kane 50% reduktim) ne krahasim me nivelin e Tetor 2015. Per kabllot 20 mm reduktimi i tarifes eshte 53-55% ne krahasim me Shtator 2015.

Me qellim krahasimin e tarifave te aplikuara ne Shqiperi per tubacionet me vendet e tjera, AKEP ka marre informacion nga Cullen International. Nga informacionet e marra rezulton se:

1. Detyrimi për të dhënë akses në tuba eshte vendosur kryesisht si pjese e detyrimeve ne tregun nr.4 (rekomandimi i 2007 te KE), d.m.th ne aksesin fizik ne infrastrukture te rrjeteve fikse, perfshire LLU, ne rrjetin lokal te operatorit incumbent deri në pikën e hyrjes në ndërtesë (up to the building entry point)
2. Informacioni për tarifat i referohet aksesit në tubacione në pjesën e rrjetit local pra nuk përfshihen tarifat për tuba në rrjet kryesor dhe në shumicën e rasteve janë tarifat të publikuara në ofertën referencë të operatorit incumbent;
3. Tarifat shprehen në varësi të diametrit të tubit dhe/ose në varësi të sipërfaqes së prerjes tërthore të kabllit/tubit, si dhe në disa raste tarifat janë në varësi të vendndodhjes gjeografike të tubit.
4. Në shumë raste aplikohen tarifa one-off për procesimin e kërkesës dhe planin teknik
5. Një factor i rëndësihëm për stimulimin e përdorimit të përbashkët të tubave është regjistri i infrastrukturës (ATLASI).

Informacioni i permbledhur per tarifat mujore te aksesit ne tubacione në vendet evropiane paraqitet ne tabelen dhe figurat e meposhteme. Tarifat janë në euro/km në muaj. Tarifa

minimale i referohet kryesisht tubave me diametër të vogël sipas sqarimeve në dy kolonat e fundit.

TABELA V.3: TARIFAT MUJORE TE AKSESIT NE TUBACIONE NE VENDET BE DHE RAJONIT

Shteti	Minimum monthly fee	Maximum Monthly fee	Min Diameter (mm)	Max Diameter (mm)
AT	850.00	850.00		
BG	25.56	107.37	20	40
CH	132.30	132.30		
CZ	59.17	554.73	40/33 mm	100-120 mm
DE	90.00	90.00	25	
DK	207.76	245.29		
EE	48.00	48.00	30 (tub 100mm i ndare ne 6 seksione me 30mm)	30 (tub 100mm i ndare nw 6 seksione me 30mm)
ES	62.00	62.00	40	40
ES 2	8.00	18.00	per cm2 ne tub 110 mm	per cm2 ne tub 63 mm
FI	150.00	300.00	zona 3	zona1
FR	21.00	21.00	per CM2 ne segmentin feeder	per cm2 ne segmentin terminues
GR	120.00	120.00		
HR	24.81	152.03	3-16mm	63-110 mm
HU	76.30	76.30		
LT	27.00	27.00		
LU	130.00	130.00		
LV	74.96	74.96		
MK	29.86	77.00	10	40
NO	115.47	829.26	Rurale	City centre
PT	7.50	10.60	ne cm2 zona te tjera	ne cm2 ne Lisbon dhe Porto
SI	266.54	266.54		
SK	922.00	1,900.00		
TR	39.42	60.36	per cm2 ne tub >29mm zone jo metropol apo city centre	per cm2 per dimater >29mm ne zone metropol
UK	40.02	90.87		
AVG ALL	**153.03**	**270.68**	Mesatarja e te gjitha vendeve ne tabele (pa ES 2)	
AVG no Outliers	**90.48**	**121.18**	Mesatarja e te gjitha vendeve pa qelizat me hije gri dhe font te kuq	
AVG Region	**39.19**	**94.61**	Mesatarja e vendeve me hije te verdhe	
AVG cm2	**12.17**	**16.53**	Mesatarja e vendeve me tarifa per cm2, me font te kuq	
AVG Cm2 20 mm	**48.67**	**66.13**	Mesatarja e vendeve me tarifa per cm2 shumezuar me 4	
AVG Region 20-40	**67.04**	**67.04**	Mesatarja e tarifave te Maqedonise, Kroacise dheTurqise per tuba 20-40 mm	
Albtelecom 20 mm (31.09.2015)	**100.00**	**200.00**		
Albtelecom 20 mm (1.10.2016)	**46.00**	**90.00**		

Burimi: Cullen International Prill 2016 dhe AKEP

Sic mund te vihet re nga tabela dhe nga grafiket e meposhtem, niveli i tarifave ka diapazon shumë të madh dhe mënyra e tarifimit ka variacione të mëdha dhe eshte komplekse. Meqenese kostot e ndertimit te infrastruktures se tubacioneve (dhe rrjedhimisht tarifes se aksesit per perdorim te perbashket) varen ne mase te madhe nga kostot e puneve civile, eshte e arsyeshme qe ne krahasimin e tarifave te merret ne konsiderate edhe mesatarja e vendeve te rajonit. Njekohesisht ne tabele tarifat e paraqitura per disa vende jane te shprehura ne euro per km dhe cm^2, praktike tarifimi e cila perdoret kryesisht per rastet kur ne nje tub bashkevendosen disa kabllo (te nje apo disa operatoreve) me diameter me te vogel se i tubit.

FIGURA V.1: TARIFAT MINIMALE MUJORE PER AKES NE TUB



Burimi: Cullen International

FIGURA V.2: TARIFAT MAKSIMALE MUJORE PER AKES NE TUB



Burimi: Cullen International

Bazuar ne te dhenat e mesiperme AKEP ne tabele ka perfshire tarifat mesatare si me poshte:

1. AVG ALL: Tarifa mesatare te te gjithave vendeve te paraqitura ne tabele
2. AVG no Outliers: Tarifa mesatare e te gjithave vendeve te paraqitura ne tabele pa vendet qe kane tarifa qe jane dukshem shume te larta si Austria, Cekia, Norvegjia dhe Sllovakia (te evidentuara me kolona te kuqe ne grafiket e mesiperm) dhe vendet qe kane tarifat te shprehuara ne km dhe cm2 (Franca, Portugalia dhe Spanja (ES2)).
3. AVG Region: Tarifa mesatare e Maqedonise, Kroacise, Bullgarise, Turqise dhe Hungarise.
4. AVG cm2: Tarifa mesatare (euro per cm2 dhe km) e aksesit ne tubacione e Frances, Portugalise dhe Spanjes (ES2)
5. AVG cm2 20 mm: Tarifa mesatare ne euro per cm2 dhe km (pika 4 me siper) shumezuar me 4, per te llogaritur tarifen per nje kabell 20 mm. Eshte perdorur koeficenti 4 si diametri ne cm ne katror dhe jo siperfaqja e prerjes terthore te kabllit (πr^2) per te lehuar per siperfaqe te lire ne tub.
6. AVG Region 20-40 mm: Tarifa mestare e aksesit ne tuba 20-40 mm e aplikuar ne Maqedoni, Kroaci dhe Turqi.

Tabela e meposhteme paraqet nje informacion me te detajuar te tarifave te aksesit ne tubacione te aplikuar ne vendet e rajonit, ne te cilat AKEP ka shtuar edhe informacion te marre kohet e fundit per Malin e Zi.

Tabela 1: Tarifat mujore te aksesit ne tubacione ne vendet e rajonit

	Diametri i Tubit	Tarifa Mujore (Euro/km)
Kroacia	3-16 mm	26
	20-40 mm	46
	50 mm	133
	63-110 mm	158
Maqedonia	5 mm	20
		29
	10 mm	29
	32 mm	61
	40 mm	77
Turqia	29 mm	60
		92
Mali i Zi	20mm	30
	40 mm	81
AVG Region 1	20-40 mm	64
AVG Region 2	20 mm	49
AVG Region 3	40 mm	74
Albtelecom	>10 – 20 mm	46-73
	>20-30 mm	52-90

Nga te dhenat e tabeles dhe tarifat e aplikuara nga Albtelecom vihet re se:

- Tarifat ne disa vende jane shume me te larta se mesatarja dhe ne disa vende jane te shprehura edhe per cm2, dhe ne kete menyre me e pershtashme eshte krahasimi me AVG No Outliers se sa me AVG ALL.

- Tarifat e Albtelecom deri ne vition 2015 fillojne me nivelin 190-200 euro/km ne muaj per nje kabell me diameter 20 mm per 1000 metrat e para dhe me pas pershkallezohen duke u reduktuar deri ne 92-100 euro/km per distancat mbi 300 km.

- Tarifat e Albtelecom per kabllo 20 mm deri ne Shtator 2016 ishin me te larta se mesatarja e te gjitha vendeve AVG no Ouliers (ku perfshihen edhe vende me kosto te puneve civile disa here me te larta se ne Shqiperi) dhe disa here me te larta se sa tarifat ne vendet e rajonit per akses ne tuba 20-40 mm (67 Euro/km).

- Tarifat e Albtelcom kane pesuar reduktim me rreth 50% ne Tetor 2016 dhe per tarifa e Albtelecom per kabllo 20 mm eshte me e ulet se mesatarja e te gjithave vendeve AVG no Outliers dhe eshte e perfaert me mesataren e rajonit.

Krahasimi i mesiperm tregoi se tarifat e Albtelecom per aksesin ne tubacione ishin shume me te larta se vendet e rajonit, deri ne Shtator 2016. Me reduktimin e ndjeshem te tarifave ne Shtator 2016, tarifat e aplikuara nga Albtelecom jane perfaruar ndjeshem me nivelin mesatar te vendeve te rajonit.

V.3. Zhvillime pas keshillimit publik

AKEP publikoi dokumentin e Analizes se tregut per keshillim publik ne periudhen 15.06-15.08.2016. Gjate kesaj periudhe ne treg pati dy zhvillime te rendesihme qe lidhen me tregun e aksesit ne infrastrukture pasive:

1. Njoftimi i Albtelecom me shkresen Nr.8005 Prot., date 27.09.2016, per tarifat e reja te perdorimit te infrastruktures se lire ne tuba.
2. Miratimi dhe hyrja ne fuqi e Ligjit Nr. 120/2016 "*Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit*".

Sic eshte theksuar ne seksionin e tarifave V.2 me siper, Albtelecom me shkresen Nr.8005 Prot., date 27.09.2016, derguar operatoreve dhe AKEP, ka njoftuar tarifat e reja te perdorimit te infrastruktures se lire ne tuba qe hyne ne fuqi me 1.10.2016, te cilat perbejne reduktim me rreth 50% nga tarifat e meparshme. AKEP ka perfshire informacionin per tarifat e reja te aplikuara nga Albtelecom per aksesin ne tuba, ne Tabelat perkatese te seksionit te meparshem te analizes se tregut.

Me 24.11.2016, Kuvendi i Republikes se Shqiperise miratoi Ligjin Nr. 120/2016 "*Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit*", i cili perben transpozim ne legjislacionin kombetar te Direktivës 2014/61/BE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 15 Maj 2014, "*Mbi masat për reduktimin e kostove të ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë*".

Ligji 120/2016 ka për qëllim të lehtësojë e nxisë ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë, duke promovuar përdorimin e përbashkët të infrastrukturës fizike ekzistuese dhe një zhvillim më efikas të infrastrukturës fizike të re, nëpërmjet ndërtimit të rrjeteve të shpejtësisë së lartë me kosto më të ulët, reduktimit të procedurave, si dhe sigurimit të së drejtës së kalimit për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë. Ky ligj synon te rregulloje jo vetem aksesin ne infrastrukturen fizike (pasive) te rrjeteve te sipermarresve te komunikimeve elektronike por edhe aksesin ne llojet e tjera te infrastruktures fizike qe jane pjese e rrjeteve qe zoterohen nga sipermarres/subjekte ne sektore te tjere si energji, gaz, uje dhe transport, qe mund te perdoren nga operatoret e komunikimeve elektronike per te instaluar rrjetet e komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë (rrjete qe kanë kapacitetin të ofrojnë akses në shërbime me brez të gjerë, me një shpejtësi, të paktën, 30 Mbps).

Pra me objektivin e rritjes se mbulimit me rrjete broadband, shpejtesise se aksesit per perdoruesit fundor dhe uljen e kostove per aksesin broadband ne Inetrnet me shpejtesi te larte, ligji parashikon rregullimin e aksesit ne infrastrukturen fizike te rrjeteve edhe te te subjekteve qe nuk jane pjese e ligjit te komunikimeve elektronike si sipermarresit/subjektet juridike te rrjeteve te tilla si prodhimi, transporti ose shperndarja energjise elektrike, gazit dhe ujit, transporti rrugor dhe hekurudhat etj., pershire dhe bashkite si dhe çdo subjekt juridik publik ose shtetëror që ka në pronësi apo administron infrastrukturë pasive të tubacioneve, që mundësojnë vendosjen e rrjetit të

komunikimeve elektronike. Elementet e infrastrukturës fizike te ketyre rrjeteve ku mund te perfitohet akses nga sipermarresit e rrjeteve te komunikimeve elektronike perfshihen tubacionet, kanalet/gypat, pusetat, instalimet e antenave, kullat, godinat ose hyrjet në godina.

Ligji ne nenin 7 permban procedura per zgjidhjen e mosmarrveshjeve në rast refuzimi të së drejtës për akses në infrastructure, duke percaktuar dhe autoritetet perkatese per zgjidhjen e ketyre mosmarrveshjeve, dhe ne piken 6 te ketij neni, parashikon qe metodologjia e përcaktimit të çmimit dhe çmimet referuese (per aksesin ne infrastrukturen pasive) miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës, ndersa cmimet referuese rishikohen periodikisht, por jo më pak se çdo dy vjet. Autoritetet pergjegjese per zgjidhjen e mosmarrveshjeve kane detyrimin e perdorimit metodlogjive dhe tarifave reference per aksesin ne infrastrukturen fizike (te rrjeteve perkatese) sipas percaktimeve qe do jepen ne dokumnetin e miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave, i cili duhet temiratohet brenda 6 muajve nga hyrja ne fuqi e ligjit 120/2016.

V.4. Perfundim per Analizen e tregut te infrastruktures pasive nder-urbane (kombetare)

AKEP ne dokumentin e nxjerre ne keshillim publik propozoi se ATU dhe Albtelecom plotesojne kriteret per FNT (dominance te bashkuar), bazuar nder te tjera ne faktoret e meposhtem:

- Albtelecom dhe ATU jane ofruesit e vetem te infrastruktures pasive ne nivel kombetar;
- Megjithe kapacitetet e medha ne tubacione (sidomos ATU), perdorimi i tyre eshte shume i ulet;
- Tarifat e aksesit ne tubacione nga Albtelecom jane shume te larta ne krahasim me vendet e rajonit;
- Tarifat e ATU nuk jane publike/transparente.

Ne vijim te komenteve te keshillimit publik dhe zhvillimeve ne treg ne lidhje me aksesin ne infrastrukturen fizike (pasive), AKEP vlereson si te arsyeshme qe te ri-konsideroje perfundimet per kete treg, per arsyet e meposhtme:

- Informacioni per infrastrukturen pasive (tubat) eshte marre nga Atlasi i AKEP sipas deklarimeve te operatoreve, por ky informacion rezulton te jete i kufizuar (nuk ka detaje per numrin e tubave ne nje interval te caktuar, apo per kapacitetin e lire ne tub, nuk ka ndarje ne zone urbane dhe inter-urbane etj.) si dhe nuk permban informacion per subjektet e tjera qe ofrojne sherbime te ngjashme por qe nuk jane ofrues sherbimi sipas ligjit 9918;
- Nje nder problemet kryesore te evidentuara ne dokumentin e keshillimit publik, niveli i larte i tarifave te aksesit ne tubacione te Albtelecom, eshte zbutur ndjeshem per shkak te reduktimit te madh (rreth 50%) te tarifave nga vet Albtelecom duke filluar nga muaji Tetor 2016;
- Rregullimi i aksesit ne tuba ne zonat kombetare/nder-urbane duket se eshte i parakohshem ne kushtet kur ne BE ky rregullim eshte i kufizuar ne zona lokale (rrjeti

lokal) dhe kur ende ne AKEP nuk ka pasur kerkesa per zgjidhje mos-marrveshje midis operatoreve per kete lloj aksesi.

- Faktore te rendesishem ne perdorimin dhe kerkesen e kufizuar te tubave rezultojne te jene:
  - shume operatore zhvillojne rrjetet lokale me rrjet ajror si metode me cmim me te ulet fillestar;
  - ne zona kombetare operatoret mbeshteten fuqishem ne perdorimin e radiofrekuencave (ka perdorim shume te larte te radiofrekuencave mikrovalore).
  - Sherbimet e infrastruktures aktive (si linja me qira, lidhjet ethernet LAN etj) rezultojne te jene aktualisht alternativa me ekonomike, pasi aksesi ne tuba, pervec qirase mujore kerkon investime te tjera te medha si blerjen dhe instalimin e fibres optike dhe terminaleve perkates qe kane kosto te larta fillestare.
- Perdorimi i perbashket i tubave ne Shqiperi, rezulton se eshte nje sherbim qe eshte ne fillimet e veta, dhe eshte ende shume shpejt per te arritur ne konkluzione mbi deshtimin e ketij tregu. Ofrues te tjere te mundshem te aksesit ne infrastrukture pasive ne nivel kombetar, pervec Albtelecom dhe ATU jane dhe sipermarres ne sektore te tjere te ekonomise si operatori i transmetimit te energjise elektrike, ofrues te rrjeteve te ujesjellesit, autoritete rrugore dhe bashkite.
- Me 24.11.2016, Kuvendi i Shqiperise miratoi Ligjin Nr. 120/2016 "*Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit*". Ky ligj ka për qëllim të lehtësojë e nxisë ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë (broadband), dhe synon te rregulloje jo vetem aksesin ne infrastrukturen e rrjeteve te sipermarresve te komunikimeve elektronike por edhe aksesin ne llojet e tjera te infrastruktures qe zoterohen nga sipermarres ne sektore te tjere si energji, uje, transport rrugor etj, dhe qe mund te perdoren per rrjetet e komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë. Ligji ne nenin 7, pika 6, parashikon qe metodologjia e përcaktimit të çmimit dhe çmimet referuese (per aksesin ne infrastrukturen pasive) miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës. Çmimet referuese rishikohen periodikisht, por jo më pak se çdo dy vjet.
- Adresimi i problemeve te ketij tregu (aksesi ne infrastrukturen fizike pasive kombetare) ne lidhje me dhenien dhe cmimin e aksesit mund te kryhet nepermjet instrumentave te tjere te zgjidhjes se mosmarrveshjeve te percaktuara ne Ligjin 9918, Rregulloren e AKEP Nr.35, Datë 10.07.2015 si dhe se fundmi nepermjet instrumentave te parashikuara ne Ligjin 120/2016.

Sipas Ligjit 9918 dhe dhe Rregullores se Perdorimit te Perbashket te Infrastruktures Pasive (Rregullore Nr.35, Datë 10.07.2015), secili operator ka detyrim te jape akses ne infrastrukturen e lire pasive, pavaresisht se si eshte krijuar apo statusit me FNT ose jo. Keto detyrime jane simetrike dhe jane te aplikueshme edhe per ATU, pavaresisht percaktimeve te lejes se dhene nga Ministria e Transportit dhe Puneve Publike ne vitin 2010. Njekohesisht, miratimi dhe hyrja ne fuqi e ligjit 120/2016, shtojne bazen ligjore per zgjidhjen efektive te ketyre mosmarrveshjeve si dhe rrisin fushen e veprimit per rregullimin e aksesit ne infrastrukture fizike duke perfshire dhe rrjete/sipermarres qe nuk jane pjese e ligjit 9918, duke shmangur cdo paqartesi juridike ne lidhje me rregullimin e mundshem te dhenies dhe tarifave te aksesit per infrastrukturen fizike (pasive) qe mundson zhvillimin e rrjeteve te komunikimeve elektronike te shpejtesises se larte dhe rritjes se konkurrences per akses broadband ne nivel me pakice.

Baza ligjore dhe nen-ligjore aktuale per rregullimin e aksesit ne infrastrukture fizike (pasive) per zhvillimin e rrjeteve te komunikimeve elektronike te shpejtesises se larte, perfshin nder te tjera:

- Ligjin 9918/2008, neni 22;

- Ligjin Nr. 120/2016 "*Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit*";
- Rregulloren e AKEP me Nr Rregullore Nr.35, Datë 10.07.2015, "*Rregulla për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike*";
- Rregulloren e AKEP me Nr. 27 datë 21.09.2012 "*Mbi Publikimin e informacionit për tarifat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike".*

Per sa me siper AKEP vlereson se perdorimi individualisht apo ne kombinim i procedurave te zgjidhjes se mosmarrveshjeve sipas akteve te mesiperme, perfshire informacionit per tarifat e aksesit ne tuba dhe rregullimit te tyre ne nivel lokal/urban, jane aktualisht te mjaftueshme per adresimin e problematikes se mundshme per aksesin ne tuba ne nivel kombetar (zonat nder-urbane) per te gjithe operatoret, pavaresisht statusit me FNT ose jo.

VI. MASAT RREGULLUESE PER FNT

Ky seksion permban masat rregulluese te propozuara nga AKEP per sipermarresit me FNT ne tregjet perkates te analizuar ne kete document. Ne baze te analizes se kryer ne kapitujte e meparshem, AKEP arriti ne perfundimin se Albtelecom ploteson kriteret per FNT ne tregjet perkates te meposhtem:

1. Tregun me shumice te aksesit ne nivel lokal ne vendndodhje fikse (WLA)

2. Tregun me shumice te aksesit ne nivel qendror per produkte te tregut te pergjithshem (WCA)

3. Tregun me shumice te aksesit me cilesi te larte ne vendndodhje fikse (WHQA);

Ne vijim te perfundimeve te analizes se kryer, AKEP propozon qe Albtelecom te kete detyrimet e meposhtme per statusin e FNT ne tregjet perkates te analizuar ne kete document.

1. <u>Detyrimet e propozuara per FNT te Albtelecom ne tregun e aksesit lokal (WLA):</u>

- Mos-diskriminim
- Transparence (publikim RUO/tarifa dhe perditesim RUO per aksesin dhe cmimet ne tuacione dhe sherbime te tjera objekt rregullimi si LLU)
- Akses per LLU ne nivel MSAN (detyrimet e Analizes 2014),
- Akses ne infrastrukturen fizike (tubacione/shtylla per lidhje te POI me MSAN per te lidhur klientet broadband)
- Kontroll/rregullim i tarifave te LLU dhe aksesit ne tubacione ne nivel local.

Detyrimet e propozuara nga AKEP per Albtelecom ne kete treg (WLA) perbejne pjeserisht lehtesim nga detyrimet aktuale/te meparshme pasi nuk perfshijne detyrime per ndarjen e llogarive (AS/CA), nderkohe qe shtohen disa detyrime ne lidhje me aksesin ne tubane infrastructure fizike te tubave ne nivel lokal.

Albtelecom ka pasur detyrime per te dhene akses ne tubacione ne kuader te LLU dhe migrimit ne NGA, por me tarifa te vendosura ne negociata me operatoret perfitues.
Megjithe reduktimin e ndjeshem nga Albtelecom te tarifave te aksesit ne tuba ne Tetor 2016, AKEP vlereson se keto tarifa aksesi ne infrastrukturen fizike te tubave ne nivel local te Albtelecom duhet te jene nen-rregulim, pasi reduktimi i ndjeshem rezulton te kete ndodhur pas publikimit te analizes se tregut te AKEP dhe cmimeve reference/benchmark ne vendet e BE dhe rajonit. Ne mungese te kesaj transparence dhe presioni per rregullim ex-ante te ketyre tarifave, Albtelecom mund te vazhdonte te aplikonte tarifa shume te larta per keto sherbime, si dhe ne mungese te rregullimit te tyre ne te ardhmen, nuk ka garanci apo siguri qe tarifat e Albtelecom do vijojne te jene te arsyeshme per tregun Shqiptar, perfshire normen e arsyeshme te fitimit te Albtelecom per keto sherbime. Metoda dhe rregullimi i tarifave t eaksesit ne tuba ne nivel local te Albtelecom jane objekt i vendimit te vecante te AKEP, sic eshte sqaruar ne kete document. Gjithshesi, ne kuader te detyrimeve te mos-disktriminimit dhe transaprences, Albtelecom do te duhet te perfshije keto tarifa te tubacioneve si dhe kushtet dhe procedurat e dhenies se aksesit ne tubacione per aksesin local ne oferten reference RUO.

Aksesi virtual ne qarkun lokal (VULA-Virtual Unbundling of Local Access) perdoret si mase rregulluese ne rastet kur aksesi fizik ne LLU nuk eshte i mundur. Ky lloj aksesi virtual perdoret kur qarku lokal i operatorit me FNT eshte me fibra optike (FFTH) dhe topologji

PON (rrjet me fibra optike pasive ku nje fiber optike e vetme perdoret nga disa perdorues fundore me spliter) si dhe ne rastet kur VDSL e operatorit incumbent me FNT ofrohet me vektorizim, e cila kerkon qe sinjalet e te gjitha kabllove te bakrit qe dalin nga nje kabine (MSAN) te jene te koordinuara. Per rastin e Albtelecom qe ka topologji rrjeti lokal FTTC mund te diskutohet mundesia e vendosjes se detyrimit te aksesit virtual VULA per VDSL. Megjithate VDSL akoma eshte ne fillimin e aplikimit dhe vetem nje pjese e vogel e pajtimtareve te Albtelecom kane akses broadband me teknologjine VDSL. Njekohesisht ky detyrimi eshte i mundur vetem nese operatori incumbent perdor vektorizimin ne VDSL. BEREC ne dokumentin BoR (16) 162 "*Common Position on Layer 2 Wholesale Access Products*" te dates 6.10.2016, citon se masa rregulluese e dhenies se aksesit ne Layer 2 ne nivel lokal mund te mos jete e justifikuar ne rastet kur masat rregulluese ne infrastrsukturen pasive jane te mjaftueshme per te siguruar konkurrence ne tregjet me pakice, p.sh. rastet kur operatoret alternative investojne ne rrjetet e tyre FTTC/FTTH/B dhe perdorin sherbimet e LLU/SLU dhe aksesin ne tubacione. Situata e tregut ne Shqiperi tregon se operatoret alternative kane investuar fuqishem ne rrjetet e tyre lokale dhe ka nje rritje te perdorimit te tubave te Albtelecom, si dhe proporcioni i linjave VDSL ne rrjetin Albtelecom eshte shume i vogel ne totalin e linjave XDSL. Njekohesisht aksesi virtual ne nivel lokal ne Shqiperi eshte ekonomikisht jo i favorshem per shkak se perfitimi nga ekonomite e shkalles eshte shume i ulet ne krahasime me vendet e medha kur ne nivel lokal mund te arrihen nje numer i madh pajtimtaresh. Ne keto kushte AKEP gjykon se aksesi virtual ne nivel lokal nuk eshte mase rregulluese proporcionale dhe e justifikueshme per Albtelecom.

2. <u>Detyrimet e propozuara per Albtelecom ne tregun e aksesit ne nivel qendror (WCA):</u>

- Mos-diskriminim
- Transparence te tarifave dhe sherbimeve (publikim i tyre)
- Detyrime per dhenie akses bitstream (vazhdim i detyrimeve te analizes 2014)
- Kontroll/rregullim i tarifave te aksesit bitstream

Ne lidhje me detyrimin per akses bitstream, pervec detyrimeve te vitit 2014, AKEP vlereson te specifikoje si detyrim per Albtelecom qe te jape akses bitstream ne minimumi 12 pika ne rajonet kryesore te Shqiperise, sipas adresave aktuale te Pikave te Interkoneksionit (POI) te perfshira ne RIO/RUO. Nepermjet seciles nga keto pika aksesi, operatori perfitues duhet te kete mundesine e ofrimit te sherbimeve broadband pajtimtareve te tregut masiv ne te gjithe territorin ku ka mbulim me rrjet lokal te Albtelecom. Ky eshte nje sherbim ne Nivel 2 (Layer 2) per ethernet dhe nivel 3 per IP Bitstream dhe rezulton te kete pasur interes nga operatoret pasi mundeson ofrimin e sherbimeve ne nivel me pakice nje numri te madh te pajtimtareve nepermejt aksesit ne nje ose disa pika dorezimi (PoH) rajonale/kombetare, pra duke mundesuar ekonomi shkalle shume me te larta se aksesi ne nivel lokal.

Ne lidhje me detyrimin e mos-diskriminimit Albtelecom duhet te aplikoje tarifa dhe kushte te njejta aksesi per te gjithe operatoret kerkues/perfitues te aksesit bitstream, ne kushte dhe rrethana te njejta.

3. Detyrimet e propozuara per Albtelecom ne tregun e aksesit me cilesi te larte (WHQA):

- Mos-diskriminim
- Transparence te tarifave dhe sherbimeve (publikim i tyre)
- Detyrime per akses per linjat me qira (vazhdim i detyrimeve te analizes 2014)
- Detyrime per akses ne linja me qira ne nivel kombetar/lidhje nderurbane dhe lokale (segmentet terminuese)
- Kontroll/rregullim i tarifave te aksesit ne linja me qira

Ne lidhje me detyrimin e ndarjes së llogarive per Albtelecom, AKEP gjykon ta heqe kete detyrim per shkak te kostove te larta te implementimit te tij, ne kohen qe perdorimi i sherbimeve te LLU/akses bitstream dhe linja me shumice me qira jane ne nivel shume te ulet (LLU nuk perdoret fare) per te justifikuar kete detyrim si mase rregulluese proporcionale per Albtelecom.

AKEP ne percaktimin e masave rregulluese per aksesin ne keto 3 tregje ka shqyrtuar dhe dokumentat:

- *Common Position on Layer 2 Wholesale Access Products (6 October 2016)*
- *COMMISSION RECOMMENDATION of 11 September 2013 on consistent non-discrimination obligations and costing methodologies to promote competition and enhance the broadband investment environment (2013/466/EU)*

Ne lidhje me alternativat me te mira per rregullimin e sherbimit te aksesit bitstream, keto dokumenta rekomandojne nder te tjera heqje e detyrimit te kontrollit te tarifes dhe orientimit ne kosto, por duke shtuar detyrimet e mos-diskriminimit, (EoI-Equivalence of Inputs, Replikueshmeri teknike dhe replikueshmeri ekonomike). Heqja e detyrimit te kontrollit te tarifes rekomandohet te jete e kushtezuar me zbatimin ketyre tre detyrimeve shtese per mos-diskriminim nga operatori me FNT i cili duhet te kete barren e vertetimit te zbatimit te tyre. Megjithate, bazuar ne komplikacionet e zbatimit te ketyre detyrimeve dhe problematiken e vertetimit te orientimit ne kosto, AKEP ka perzgjedhur si metode me te mire, menyren aktuale te rregullimit te tarifave nepermjet kontrollit te tyre sipas nenit 57. Metodat alternative te rekomanduara ne dokumentat e mesiperme mund te jene objekt diskutimi te AKEP me operatoret (Albtelecom dhe operatoret e tjere te interesuar) ne nje periudhe tjeter te mevonshme kohore.

Ne lidhje me tregun e aksesit ne tubacione ne nivel kombetar, ne vijim te perfundimeve te Kapitullit V te ketij dokumenti, AKEP vlereson qe te analizoje kete treg per FNT ne nje kohe tjeter ne te ardhmen e afert (1-2 vjet). Nderkohe analiza e tarifave te tubave dhe masat rregullatore per aksesin ne tuba ne aksesin lokal, mund te sherbejne si cmime reference dhe rregulla per aksesin ne tuba ne zona kombetare (inter-urbane), si dhe ne procedurat te zgjidhjes se mosmarrveshjeve midis operatoreve. Rregullimi i tarifave per kete akses mund te imponohet nepermjet procedures se zgjidhjes se mosmarrveshjeve dhe rregulloreve perkatese te AKEP si dhe percaktimeve dhe akteve nen-ligjore te parashikuar ane Ligjin 120/2016.

Sic eshte theksuar ne hyrje te dokumentit te analizes, ky dokument eshte pergatiur pas procesit te keshillimt publik ne lidhje me perfundimet e AKEP per perkufizmin e tregjeve, FNT dhe masat rregulluese te propozuara per FNT. Ne lidhje me metoden e kontrollit te tarifave te sipermarresve te propozuar per status me FNT, AKEP ka zhvilluar nje proces te vecante keshillimi publik, ne perputhje me percaktimet e nenit 57 e ne vijim te Ligjit 9918. Ky proces u krye me publikimin nga AKEP te dokumentit "*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT ne tregjet me shumice te aksesit broadband dhe në infrastrukturen aktive dhe pasive në rrjete fikse*" per keshillim publik me 8.07-15.09.2016.

ANEKS 1: KOMENTET E KESHILLIMIT PUBLIK DHE QENDRIMI I AKEP

AKEP me VKD nr.2681, datë 8.06.2016 miratoi publikimin e dokumentit "Miratim për këshillim publik të Dokumentit: "Analizë e Tregjeve me Shumicë të Aksesit Broadband në Internet dhe Linjave me Qera – Këshillim Publik". Në këtë dokument të publikuar në faqen zyrtare www.akep.al, AKEP kishte hartuar disa pyetje për të marrrë opinionin e palëve të interesuara. Në përfundim të fazës së këshillimit publik (15.06-15.08.2016) në AKEP depozituan komente:

- Albtelecom sh.a., nëpërmjet shkresës me Referencë Nr. Prot 7162, datë 10.08.2016 (Referencë e AKEP Nr.1382 Prot., datë 10.08.2016);
- Telekom Albania sh.a., me shkresën Nr. 4061/1 Prot., datë 20.07.2016 (Referencë e AKEP, Nr. 1313 Prot., datë 27.07.2016);
- Vodafone Albania sh.a., me shkresës Nr. LRD/0091/OX, datë 16.08.2016 (Referencë e AKEP Nr.1398 Prot., datë 16.08.2016);
- Plus Communications sh.a., me shkresën Nr. Prot. 947, datë 15.08.2016 (Referencë e AKEP Nr.1423 Prot., datë 22.08.2016).

AKEP i falenderon të gjithë pjesëmarrësit për kontributet e dhëna në proçesin e këshillimit publik.

Ky dokument permban komentet e permbledhura sipas pyetjeve te keshillimit publik dhe qendrimin e AKEP per komentet e derguara.

1. A janë pasqyruar drejt zhvillimet e tregut me pakicë të aksesit broadband nga rrjetet fikse në Seksionin III.1?

ALBTELECOM

Zhvillimet dhe ecuria e tregut janë pasqyruar përgjithësisht qartë dhe në mënyrë të detajuar të dhënat në lidhje me zhvillimet në tregun me pakicë të aksesit broadband. Albtelecom shpreh shqetësim për normën e ulët të penetrimit të fiksit dhe ulja e përdormit mesatar mujor të telefonisë fikse. Albtelecom shprehet se që prej vitit 2014 ka lançuar në treg paketat trefishe (triple play) që ofrojnë shërbime telefonie, internet dhe TV të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e numrit të përdoruesve të internetit broadband dhe në ndryshimin e zgjedhjes së konsumatorit nga paketat dyfishe në paketat trefishe. Kjo zgjedhje e re teknologjike e ofruar nga Albtelecom (IPTV) ka bërë të mundur mbajtjen e pjesës së tregut të tij konstante në 40% për sa i përket numrit të përdoruesve të aksesit broadband në tregun me pakicë, si dhe ka ndikuar në rritjen e përqindjes së pajtimtarëve që përdorin shpejtësi interneti 4 Mbps-10 Mbps. Lidhur me tarifimin e shërbimit të aksesit broadband Albtelecom mendon se analiza dhe krahasimi i bërë lidhur me aksesin broadband (standalone) është i pavend sa kohë që përqindja e abonentëve që janë të regjistruar në këtë shërbim është më pak se 4.8% për vitin 2015 , dhe më e vogël se 0.5% për tremujorin e dytë të vitit 2016 (deri 30 qershor vetëm 435 persona).

PLUS

PLUS gjykon se zhvillimet e tregut me pakicë të aksesit broadband nga rrjetet fikse janë pasqyruar në mënyrë të detajuar dhe të plotë, përfshirë këtu edhe ecurinë e normës së penetrimit të telefonisë fikse për popullsi në Shqipëri dhe në botë, informacionin në lidhje me pjesën e tregut të aksesit broadband në Shqipëri nga rrjetet fikse, tarifat e aksesit broadband, ofertat bundle (triple pay) të krahasuara me vendet e Europës (për paketat e integruara), pasqyra e aksesit më vete (stand alone), etj.

TELEKOM ALBANIA

Telekom Albania gjykon se zhvillimet e tregut me pakicë të aksesit broadband nga rrjetet fikse janë pasqyruar në mënyrë korrekte dhe në lidhje me këtë përshkrim nuk ka ndonjë objeksion për të bërë ose shtuar ndonjë element tjetër në lidhje me dinamikat e tregut me pakicë të aksesit broadband. Telekom Albania vë në dukje se vitet e fundit ecuria ka qënë shumë dinamike, rritje karakterizuar nga një sërë faktorësh sic janë: rritja e numrit të pajtimtarëve me akses broadband , numri i madh i ofruesve për shërbimin e aksesit broadband me anë të rrjeteve të tyre, gama e gjerë e shërbimeve të ofruara, investimet e konsiderueshme në rrjetet NGN dhe të bazuar më së shumti në fibrat optike, dhe këtu duhet shtuar dhe teknologjia 4G ofruar së fundi nga operatorët celularë

që për nga shpejtësia e shërbimit i afrohet aksesit broadband nga rrjetet fikse, duke e bërë akoma më konkurrues këtë treg. Por pavarësisht këtyre zhvillimeve, përsëri në tregun me pakicë të aksesit broadband fiks nuk ka ndryshime sinjifikative në terma të penetrimit të internetit në të gjithë territorin e vendit. Telekom Albania gjykon se situata e konkurrencës ndërmjet Albtelecom dhe operatorëve të tjerë fiks është ende larg asaj efektives dhe kjo për shkak se operatorët alternativë mbulojnë pjesërisht territorin me rrjetet e tyre, ndërsa operatori Albtelecom ka një shtrirje gjeografike më të madhe të rrjetit dhe gjithashtu shpreh shqetësim për normën e ulët të penetrimit për popullsi dhe për familje. Si konkluzion, pavarësisht zhvillimeve sinjifikative ne terma te progresit teknologjik, uljes se cmimeve, numrit te madh te konkurrenteve, investimeve ne treg, etj, Telekom Albania kërkon që AKEP të krijojë më shumë mundësi dhe hapsira për promovimin e investimeve në teknologji dhe në rrjet nga operatorët me qëllim që konkurrenca midis operatorëve të jetë efektive.

VODAFONE ALBANIA

Vodafone gjykon se zhvillimet në tregun e pakicës janë pasqyruar në mënyrë të drejtë. Pavarësisht progresit kohët e fundit, niveli i aksesit broadband në internet nga vendodhje fikse është ende larg mesatares së vendeve të BE; rritja ekziston por ajo është e moderuar. Ka një numër të madh të operatorëve aktivë, megjithatë operatori incumbent, është i vetmi që ka shtrirje pothuajse në të gjithë territorin e vendit dhe ka pjesë tregu ende në nivele dominuese dhe të pakonkurrueshme nga operatorët ndjekës, teksa konkurrentët ofrojnë mbulim të kufizuar rajonal. Pozita e avantazhuar e operatorit inkumbent është përforcuar dhe më tej falë teknologjisë së rë qe ai ofron NGN. Tregu i aksesit broadband në internet nga vendndodhje fikse nuk është ende plotësisht konkurrues, por shfaq shenja dominance dhe penetrim të ulët. Vodafone i kërkon AKEP të monitorojë me kujdes dhe në vazhdimësi tregun, pasi pozita e operatorit inkumbent (në nivelin e pakicës dhe në nivelin e shumicës), infrastruktura e tij e padublueshme, shtrirja kombëtare e rrjetit fibër dhe integrimi vertikal i garantojne ketij lojtari nje avantazh të dukshëm në tregjet e pakicës, e për rrjedhojë krijon kushtet për zbatimin e mundshëm të praktikave antikonkurruese 'margin squeeze' nga ky i fundit.

Qëndrimi i AKEP

Ne lidhje me komentin e Albtelecom per krahasimin e tarifave te aksesit broadband si sherbim me vehte (standalone) AKEP ka bere sqarime per rendesine me te ulet te ketij krahasimi ne versionin final te dokumentit te Analizes se tregut. Megjithate, nivelet shume te larta te tarifave te aksesit broadband ADSL te Albtelecom perbejne problem qe duhet adresuar, pavaresisht se jane nje pjese shuem e vogel e pajtimtareve qe perdorin keto tarifa. Për sa kohë që cmimet e shërbimit standalone vijojnë të jënë shume të larta, pajtimtarët janë të kushtëzuar të kontraktojnë shërbime të integruara edhe pse deshirojne te perdorin vetem nje sherbim.

Në lidhje me pjesët e tregut të Albtelecom në pakicë, diferenca ndërmjet pjesës se tregut të incumbent dhe të lojtarëve të tjerë është një tregues aftesise ndikuese te ketij operatori ne tregun me pakice. Rezultatet për llogaritjen e indeksit Herfindahl-Hirschman treguan se tregu me pakicë është relativisht konkurrues në krahasim me nivelin mesatar të përqendrimit të vendeve antarë të BE.

Ofrimi i paketave te integruara me disa sherbime eshte tendence jo vetem e Albtelecom por edhe operatoreve te tjere alterantive. Ofrimi i paketave trefishe nga Albtelecom (Telefoni, Internet dhe IPTV) ka filluar me vone se operatoret kryesore Alternative si Abcom, ASC, Abissnet etj. AKEP ka evidentuar zhvillimet e tregut broadband dhe faktin qe ne tregun me pakice zhvillohet konkurrencë mbi bazë të infrastrukturës së vet operatorit. Operatorët konkurrues ende ofrojnë llojë të ndryshmë aksesi xDSL për përdoruesit fundorë. Shumica operatoreve alterenative vazhdojnë të ndërtojnë infrastrukturën e tyre me teknologjitë e reja që mundësojnë ofrimin e shumë shërbimeve me cilësi më të mirë dhe të përfitojnë vetëm mundësinë e përdorimit të përbashkët të infrastrukturës pasive (rrjeti kanalet/tubacionet/dark fiber) të Albtelecom. Megjithe keto tendenca AKEP ka evidentuar avantazhet e Albtelecom ne tregun me pakice dhe me shumice te lidhura me aksesin broadband, qe vijne per shkak te infrastruktures active dhe pasive, perfshire migrimin ne NGN/NGA, dhe bazuar ne keto perfunime ka percaktuar ALbtelcom me FNT dhe vendosur masa rregulluese te cilat sigurojnë transparencën e kushteve për përdorimin e rrjetit aktiv dhe pasiv te Albtelecom dhe trajtimit të barabartë të konkurrentëve, kontroll të çmimeve, për t`i lejuar një normë fitimi të arsyeshme si incumbent-it dhe operatorëve me qellim edhe të investimit në teknologji të reja. Pra persa cituam mesiper, bazuar edhe ne Rekomandimin e KE, vendosja e detyrimeve ne tregjet me shumice qe sherbejne si input per tregjet me pakices, do te adresoje problemet qe mund te lindin ne tregun me pakice dhe rrisin konkurencen ne kete treg.

2. Si vleresoni se është niveli i tarifave me pakicë të aksesit broadband në Shqipëri në krahasim me vendet e tjera të rajonit dhe BE, dhe a janë të përballueshme për konsumatorët Shqiptarë?

ALBTELECOM

Niveli i tarifave me pakicë të aksesit broadband në Shqiperi vit pas viti po bëhet gjithmonë e më i përballueshëm për konsumatorin shqiptar. Kjo gjë, është më se e evidentueshme nga statistikat dhe trendi në rritje i përdoruesve dhe i normës së penetrimit të internetit broadband. Gjithashtu, kjo duket qartë dhe në grafikët III.7dhe III.8, ku tarifa mujore për nje bundle 2-play (internet dhe telefoni), apo 3-play (internet, telefoni dhe TV), duke marr parasysh edhe kursin e këmbimit për fuqi blerëse për Shqiperinë është në të dy rastet më e ulët se mesatarja e EU27.

PLUS

Nga niveli i tarifave me pakicë të aksesit broadband ne Shqipëri krahasuar me vendet e tjera të rajonit dhe BE pasqyruar në këtë dokument, dhe analiza përkatëse e tyre verejmë se:

i. Për aksesin broadband *stand alone*, ku është marrë tarifa standard e Albtelecom prej 4799 lek/muaj për akses 8 Mbps pa limit, vihet re se kjo tarifë që pas korrektimeve përkatese për fuqinë blerëse në Shqipëri është 77 Euro, është rreth 3 herë më e lartë se mesatarja e vendeve të BEREC.
ii. Për aksesin broadband (telefoni + inernet), tarifat mujore të aplikuara në Shqipëri për shpejtësinë 8-12 Mbps janë shumë më të larta krahasuar me vendet e BEREC.

TELEKOM ALBANIA

Për sa i përket nivelit të tarifave me pakicë të aksesit broadband në Shqipëri në krahasim me vendet e tjera të rajonit dhe BE, nga të dhënat e paraqitura nga ana e AKEP, këto tarifa janë të krahasueshme me atë të vendeve të tjera të rajonit dhe të BE-së (kryesisht për paketat e integruara), përvec atij të shërbimit standart të aksesit në internet të ofruar nga Albtelecom për shpejtësinë 8-12 Mbps i cili rezulton të jetë 3 herë me i lartë krahasuar me vendet e tjera të BEREC të marra për referencë në këtë dokument.

Niveli i krahasueshem i çmimeve kryesisht tek paketat bundle përkthehet në një konkurrencë të fokusuar kryesisht në ofrim in e këtyre shërbimeve për konsumatorin nga ana e operatorëve duke lënë jashtë vemendjes shërbimet standart stand alone, që rezultojnë shumë të larta për abonentin. Por duke pasur parasysh nivelin më të lartë të zhvillimit ekonomik të vendeve të tjera të BE-së, të perphapjes më të madhe të internetit në këto vende, niveli i tarifave me pakicë të aksesit broadband në Shqipëri janë ende jo të kënaqshme raportuar me ato standart, të ofruara nga operatori inkumbent Albtelecom, edhe pse është shtuar ndjeshëm gama e shërbimeve dhe e kombinimeve të ndryshme të paketave të integruara të hedhura në treg për konsumatorin final, duke bërë që të ulen disi çmimet per të.

Telekom Albania gjykon që ka ende hapësira për politika tarifore më të përballueshme për nevojat e konsumatorit shqiptar dhe zhvillimi i mëtejshem i rrjeteve NGN, i investimeve në fibra optike dhe në teknologji më të avancuara, por dhe përphapja e teknologjisë LTE do të ndikojë në mënyrë shumë pozitive në reduktimin e mëtejshëm të tarifave për shërbimet e aksesit broadband nga rrjetet fikse pasi rrit më shumë shumë opsionet e zgjedhjes së shërbimeve broadband nga ana e abonentëve.

VODAFONE ALBANIA

Cmimet janë rezultat i konkurrencës në treg dhe ofertës/kërkesës, dhe në parim janë elementi i fundit rregullator, ku AKEP duhet të ndërhyjë, pasi të ketë ezauruar çdo masë tjetë rregullatore që ka përfunduar pa sukses. Në këtë drejtim Vodafone sugjeron që AKEP duhet të jetë i kujdesshëm dhe në bashkëpunim me Autoritetin e Konkurrencës të monitorojë aktivisht tregun dhe në rastet kur dyshohet për sjellje anti-konkurruese të zbatojë testin e 'margin squeeze'.

Qëndrimi i AKEP

AKEP i qëndron mendimit së cmimet për aksesin broadband standalone janë në nivël më të lartë se kur ky shërbim përfshihet në paketa te integruara (bundles), por sjell në vemendje se në vendet anëtare të BE me të cilat është berë edhe krahasimi, cmimet e aksesit broadband standalone kanë pasur normë rënie më të u ulët së ato bundle, përkatësisht 2.4% vs. 22.8%[2]. Një pritje kjo që evidenton faktin se edhe ne tregun rajonal dhe më

[2] Broadband Internet Access Cost (BIAC) 2015, A study prepared for the European Commission DG Communications Networks, Content & Technology

gjerë, në BE, konkurenca është fokusuar drejt shërbimeve të intergruara dhe më konkretisht drejt paketave bundle.

3. Cili është opinioni i palëve të interesuara për përkufizimin e tregjeve përkatës me shumicë të aksesit broadband:

ALBTELECOM

Tregu me shumicë i aksesit në nivel qendror për produkte të tregut të përgjithshëm është ripërkufizuar sipas Rekomandimit. Në shënimet shpjeguese (Explanatory Note of Eu Rec 2014/710/EU) të këtij Rekomandimi, ky treg korrespondon me tregun nr.5 sipas Rekomandimit 2007/879/EC "Wholesale broadband access". Por ajo që është për tu evidentuar në këtë Analizë të rradhës, lidhet me përfshirjen e detyrimit për akses në tubacione /fibër optike në nivel urban në përkufizimin e tregut WCA-tregu 3/b rec.2014 KE (Wholesale broadband access). Albtelecom gjykon se ky detyrim jo vetëm që përbën barrë të rëndë dhe një detyrim jo propocional për Albtelecom, por përcaktimi i këtij detyrimi në këtë treg vjen në kundërshtim me Rekomandimin e 2014 për tregjet dhe produktet përkatëse. Po ashtu edhe dokumenti shoqërues Shënime shpjeguese (Explanatory Notes) i këtij Rekomandimi nuk parashikon në përshkrimin dhe në përkufizimin e tregur 3b, përfshirjen edhe të aksesit në tubacionet e rrjetit lokal si pjesë përbërëse e këtij tregu.

i. A është i arsyeshëm / nevojshëm riformulimi i tregjeve përkates sipas rekomandimit të vitit 2014 të KE?

Ligji për Komunikimet Elektronike parashikon në nenin 7, pika 1 e tij se AKEP merr parasysh rekomandimet e KE dhe BEREC. Ndodhur në kushtet e këtij përcaktimi ligjor, AKEP është i detyruar të marrë në konsideratë për sa lejojnë apo deryrojnë rrethanat dhe karakteristikat e tregut kombetar Rekomandimet e KE. Për sa me lart, Rekomandimi i vitit 2014 të KE dhe dokumentet shoqëruese duhet të shërbejnë për të udhehequr proçesin e Analizave të Tregut.

ii. Mendoni se tregu për akses në LLU (akses lokal) duhet të jetë ende nën-rregullim ndërkohë që interesi për këtë shërbim ka qenë shumë i ulët, pasi shumica e operatorëve alternativë fiks kanë mjetet e tyre të aksesit lokal?

Duke konsideruar të gjithë faktorët e analizuar nga Albtelecom si dhe faktet se Albtelecom po tregohet vetë proaktiv në ofrimin e shërbimeve bitstream, shërbim i cili gjithashtu ofrohet nën kushte dhe terma të rregulluara, Albtelecom pret me të drejtë dhe në menyrë të arsyeshme heqjen e statusit me FNT të Albtelecom në *WLA* dhe revokimin e të gjtha detyrimeve në këtë treg. Në kohën kur EU po redukton masat rregullatore ne këto tregjge për të nxitur investimet në infrasturkture dhe njëkohesisht nuk ka pasur interes ne kete treg Albtelecom kerkon revokimin e fuqise se ndjeshme ne kete treg dhe si rrjedhim revokimin e te gjitha detyrimeve ne kete treg. Detyrimet e vendosura në këtë treg Albtelecom i shikon si barrë e rëndë dhe jo proporcionale. Në lidhje me detymimin për akses në tubacion, Albtelecom gjykon se ky segment tregu është i rregulluar me dispozita ligjore, duke mos parë të justifikushme përfshirjen e këtij detyrimi në WLA.

PLUS

i. PLUS gjykon të nevojshëm ri-formulimin e tregjeve përkatës sipas rekomandimit të vitit 2014 të KE, Rregullores së Analizës së Tregut dhe kushteve aktuale të tregut të komunikimeveelektronikenë Shqipëri, duke ri-perkufizuar tregjet perkatëse të lidhura me aksesin broadband si më poshtë:

   1. Tregu me shumicë i aksesit në nivel lokal në vendndodhje fikse (WLA)

   2. Tregu me shumicë i aksesit në nivel qendror për produkte të tregut të perqjithshëm (WCA)

   3. Tregu me shumicë i aksesit me cilësi të lartë në vendndodhje fikse (WHQA);

   4. Tregu me shumicë i aksesit në elementet pasive të infrastrukturës së rrjeteve në nivel kombëtar.

ii. Në lidhje me pyetjen tjetër nëse tregu për akses në LLU (akses lokal) duhet të jetë ende nën-rregullim apo jo, PLUS mendon se kjo mbetet në gjykimin e AKEP dhe në funksion të kërkesave të operatorëve të rrjeteve fikse.

TELEKOM ALBANIA

i. Telekom Albania është e mendimit që rishikimi dhe ripërkufizimi i tregjeve të reja nën rregullim, duke i përshtatur ato sipas rekomandimeve përkatëse të KE-së është një proçes shumë i rëndësishëm në fushën e komunikimeve elektronike. Përpara se AKEP të kryente analizen e tregjeve përkatës me shumicë të aksesit broadband për një riformulim të tyre sipas rekomandimit të KE-së të vitit 2014, do të ishte e nevojshme së pari që AKEP të rishikonte Rregulloren e analizës se tregjeve miratuar me anë të Vendimit nr.2342, datë 31.01.2013 "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren nr.9, datë 11.01.2009 "Për analizën e tregut", duke qënë se tregjet e reja të riformuluara sipas Rekomandimit të KE-së të vitit 2014 nuk janë të përfshira në rregulloren ekzistuese për analizën e tregjeve, e cila është e bazuar në Rekomandimin e KE-së të 2007.

ii. Telekom Albania gjykon se tregu për akses në LLU duhet të vazhdojë të mbetet ende nën rregullim pasi Albtelecom si operatori më i madh është dominues në këtë treg për shkak të shtrirjes më të madhe të rrjetit në territorin e vendit dhe të numrit të linjave për përdorues fundor në nivel afërsisht 70%, siç evidentohet dhe në këtë analizë tregu. Ndaj duke pasur parasysh situatën në të cilën vazhdon të gjendet tregu me shumicë i aksesit në LLU, është i nevojshëm një monitorim i vazhdueshem i tij nga ana e AKEP, duke e mbajtur akoma nën rregullim, pasi shfaq probleme të konkurrencës dhe një pozitë dominante të theksuar nga ana e operatorit inkumbent kundrejt operatorëve të tjerë aktiv në këtë treg, edhe pse interesi i treguar për këtë shërbim ka qënë i ulët.

VODAFONE ALBANIA

i. Vodafone mbështet AKEP në lidhje me referencën udhëzuese drejt Rekomandimit të KE të vitit 2014 në lidhje me përkufizimin e tregjeve objekt për rregullim ex-ante. Vodafone gjithashtu është dakord me gjetjen paraprake të AKEP për identifikimin, analizimin dhe rregullimin ex-ante të 4 tregjeve në fjalë. I njëjti përfundim për rregullim paraprak arrihet edhe nëse AKEP zbaton testin e 3 kritereve, ku operatori inkumbent shfaqet me pozitë dominuese në keto tregje.

ii. WLA duhet ende të jetë nën rregullim ex-ante ashtu siç edhe udhëzon Rekomandimi i KE-së i vitit 2014. Vodafone Albania mbështet analizën dhe përfundimin e AKEP se operatori inkumbent është operator me fuqi të ndjeshme në tregun me shumicë të aksesit në rrjetin lokal (LLU), dhe si i tillë duhet t'i nënshtrohet detyrimeve rregullatore që parashikon Ligji 9918. Operatorët e tjerë kanë shtrirje të vogël rajonale dhe e vetmja mundësi optimale për rritjen e konkurrueshmerisë eshte aksesi ne rrjetin e inkumbentit. AKEP duhet ta mbajë këtë treg të rregulluar derisa të arrihet konkurrencë e kënaqshme në treg, të ulet pozita dominuese, dhe të rritet përdorshmëria e shërbimeve në nivel shumice nga operatorët alternativë.

Qëndrimi i AKEP

AKEP sqaron TA, se procedura e ndjekur nga AKEP është në përputhje me pikën 4, të nenit 3, të Rregullores nr. 9, të ndryshuar, konkretisht "*…Nëse AKEP analizon një treg që nuk është pjesë e listës së pikës 1 ose e listës së tregjeve përkatës të Rekomandimit të KE, që është në fuqi, atëhere AKEP vlerëson gjithashtu nëse ky treg plotëson testin e tre kritereve te mëposhtme…"* . Duke qënë se këto tregje janë pjesë e Rekomandimit ne fuqi të KE (vitit 2014) dhe ndodhur në kushte e nenit të sipërpërmendur, AKEP e gjykoi të mos kryejë amendim të Rregullores.

Albtelecom ofron shërbimin "akses te hapur (unbundled) ne qarkun lokal" dhe nuk ka paur interes nga operatoret alternative, per LLU, ndonëse detyrimi i vendosur per Albtelecom, per hapje aksesi ne qarkun lokal ofroi mundesi pozitive në aspektin e transparencës, barazisë dhe çmimeve të rregulluara. Kjo është për shkak të faktit se AO kanë ndërtuar një pjesë të konsiderueshme të rrjeteve të tyre përpara analizën dhe vendosjes se ketij detyrimeve per Albtelecom.

Theksojmë se ofrimi i aksesit të hapur me shumicë i Albtelecom është rezultat i imponuar nga vendimet e AKEP ne kuader te tregjeve të rregulluar. Albtelecom është lojtari i vetëm në treg, me 100% pjesa tregu te vlefshme, dhe nqs AO duhet te hyne ne marrjeveshje mbi baza komerciale, ne mungese te rregullimi te tregut as incumbent as operatoret alternative nuk mund te bejne marrveshje mbi baza te interesit komercial. Faktori i marre parasysh nga AKEP eshte vet furnizimi i incumbent dhe vet-furnizimin i konkurrenteve kur rrjetet e tyre jane perfshire ne nje treg relevant. Duke qene se aksesin me shumice ne qarkun lokal Albtelecom eshte i vetmi që ofron dhe nga te dhena rezulton se edhe ne aksesin me pakice broadband ka pjesen me te madhe te tregut rreth 40%, kjo con ne perfundimin se mund te ushtroje nje pozite dominuese individuale. Pervec te tjerash AKEP edhe mori parasysh edhe kritere te tjera. Për Albtelecom përparësia me e madhe, në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve në aksesin lokale me shumicë në vendodhje fikse, është i lidhur me perpahpjen e gjere te

infrastrukturen FTTN dhe rrjetin e tubave (infrastruktura pasive). Dublikimi i këtij rrjeti të Albtelecom do të kërkonte investime të konsiderueshme dhe burime financiare. Prandaj, AKEP është i mendimit se nuk është ekonomikisht alternativë e zbatueshme për çdo operator të riprodhoje rrjetin Albtelecom. AKEP është i mendimit se kostoja e rrjetit të bazuar në kabllo bakri/fibrash, e kombinuar me koston e rrjetit të tubacioneve, të cilat janë të nevojshme për të hyrë në tregun përkatës dhe nuk mund të rikuperohen me daljen nga tregu te hyresive te rinj, pra paraqesin një pengesë të lartë të hyrese ne tregjet relevante dhe të lidhura. AKEP gjykon se në mungesë të rregullimit, integrimi vertikal i Albtelecom, duke u bazuar kryesisht në kontrollin e infrastrukturës që nuk mund të dublikohet lehtë, mund të ndikojë negativisht në mjedisin konkurrues ne tregjevet me pakicë, ku Albtelecom është një lojtar kyç. Infrastruktura në pronësi të Albtelecom paraqet pengesë për hyrjen dhe/ose zgjerimin e tregut, veçanërisht në zonat ku konkurrentët e Albtelecom nuk kane alternativë tjetër për të arritur shpejt tek përdoruesit fundore. Në këtë drejtim, ofrimi i shërbimeve me shumicë nga infrastruktura ekzistuese Albtelecom është jashtëzakonisht e rëndësishme për zhvillimin e tregut te aksesit lokale me shumicë nga vendodhje fiks. Kalimi edhe në infrastrukturave optike kthehen në një levë shtesë, përmes të cilit Albtelecom është në gjendje të ushtrojë presion mbi konkurrentët e saj, duke marrë parasysh se rrjetet fibër-optike janë bazë për zhvillimin e ardhshëm të broadband.

4. Cili është opinioni juaj në lidhje me tarifat aksesit në tubacione dhe analizën e AKEP për këto tarifa në Seksionin V.3?

ALBTELECOM

Nga inforrnacioni i plotë i dhënë në dokumentin e Cullen, Albtelecom vëren si më poshtë:

- Tarifat janë në shumicën e rasteve të bazuara në diametrin e tubacionit/tubit, ndërkohë që tarifat e Albtelecom janë sipas trashësisë së kabllit që do të vendoset në tub.
- Përgjithësisht operatorët aplikojnë tarifa të konsiderueshme one-off të tilla si proçesim kërkese, studim fizibiliteti, plan teknik, zbatim etj të konsiderueshme, ndërkohe që Albtelecom nuk ka tarifa të tilla;
- Për kostot e punimeve civile, lejeve të ndryshme për tubacionet, etj nuk mund të konsiderohet asnjëherë referenca në shtete të veçanta, ndërkohë që realisht njihen vështirësitë në vite të Albte1ecom për paisjen me leje, për demtimet e shpeshta të infrastrukrurës së vet, etj.

Sa më siper, për shkak të ndryshimeve të theksuara dhe mospasjes së të njëjtës bazë krahasimi apo reference, Albtelecom gjykon se nga tabela mund të shkohet deri në konsiderimin e Mesatares së Përgjithshme të tarifave ne EU-27, edhe kjo me rezerva.

Pikërisht, nëse i referohemi kësaj tarife mesatare të EU-27, tarifat respektive të Albtelekom aktualisht të aplikuara janë më të vogla. Konkretisht tarifa minimale e Albtelecom është 64 Euro kundrejt 153.03 Euro që është tarifa mesatare minimale e EU-27 dhe tarifa maksimale e Albtelecom është 220 Euro kundrejt 270.68 Euro që është tarifa mesatare maksimale e EU-27.

PLUS

Në lidhje me tarifat e aksesit në tubacione të aplikuara nga Albtelecom dhe analizën e AKEP për këto tarifa në Seksionin V.3, shprehemi se tarifat e Albtelecom për aksesin në tubacione janë shumë më të larta se vendet e rajonit, gjë që ka sjellë edhe përdorimin e kufizuar të përbashkët të tubave dhe pjesëve produkteve/shërbimeve të tjera bazë të infrastrukturës aktive të Albtelecom.

TELEKOM ALBANIA

Në tregun e aksesit në tubacione Albtelecom dhe ATU janë të vetmit of rues duke pasur një situatë të qartë monopoli në këtë treg, dhe për këtë shkak tarifat e ofruara nga këta operatorë janë shumë të larta në krahasim me ato të vendeve të BE-së por edhe të rajonit me karakteristika të ngjshme me vendin tonë.

Prandaj, Telekom Albania gjykon se tarifat e aksesit në tubacione janë shumë të larta duke rritur së tepërmi kostot për çdo operator që kërkon të ofrojë shërbimet në tregun e broadband dhe që për këtë është e nevojshme të kërkojë akses në rrjetin e infrastrukturës fizike të operatorit Albtelecom për shkak të pamundësisë financiare. Në ketë mënyrë hyrja në treg për një konkurrent të ri është shumë e veshtirë duke hasur në barriera të larta financiare për të qënë efiçent në treg.

VODAFONE ALBANIA

Vodafone Albania rezervon të drejtën të japë komente të zgjeruara në lidhje me tarifat përgjate konsultimit publik mbi "Rregullimin e tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse (VKD nr. 2682 date 07.07.2016), në përputhje me afatet e përcaktuara nga AKEP.

Qëndrimi i AKEP

AKEP, pas marrjes se komenteve nga operatoret, reduktimit te ndjeshem te tarifave ne Shtator 2016 nga Albtelecom, te cilat u perafruan ndjeshem me nivelin mesatar te vendeve te rajonit, ka rishikuar pjesne e dokumnetit ne lidhje me krahasimin e tarifave duke perdirtesuar me tarifat e reja te Albtelecom, si dhe duke pasyruar dhe nivelin me star te tarifave te tubave ne vendet e rajonit. AKEP i qendron vleresimit te tij te dhene gjate keshillimit, ne lidhje me tarifat mesatare te aplikuara ne vendet europiane por duke vene theksin ne nivelin mesatar te tarifave ne vendet e rajonit, per shkak te ngjashmerises em et madhe te kostove te puneve civile qe jane element kryesor i kostove te aksesit ne tubacione.

5. A jeni dakort me përfundimin e AKEP për testin e 3 kritereve se tregu me shumicë i aksesit në infrastrukturë pasive (tuba, dark fiber etj) në nivel kombëtar është një treg i justifikueshëm per ndërhyrje ex-ante?

ALBTELECOM

Lidhur me përfundimin e AKEP për testin e 3 kritereve se, tregu me shumicë i aksesit në infrastrukture-pasive (tuba, dark fibër, etj) në- nivel kombëtar është një treg i justifikueshëm për ndërhyrje ex-ante, Albtelecom e konsideron jo të bazuar dhe të pambështetur nga kuadri ligjor dhe rregullator. Nga faktet dhe argumentet e paraqitura nga Albtelecom, gjykojmë se analiza e tre kritereve për përcaktirnin e tregut dështon si për kriterin e parë ashtu dhe për kriterin e dytë e të tretë. Në vijm të komente Albtelecom sjell edhe problematikat për lejet e shtrimit të rrjetit dhe gjetja e zgjidhjeve alternative, demtimet e sjella nga punimet në akse kombëtare të caktuara të rrugeve ku është shtruar rrjeti fiber, dhe mamundësia e kthimit të investimeve miliona Eurosh më këtë rrjet.

Kriteri i parë dështon sepse te gjithe operatoret kanë arritur të pajisen me leje në zonat ku kane pasur interes dhe në aspektin ekonomik Albtelecom po detyrohet të ndajë këtë rrjet kur akoma nuk i është kthyer investimi. Nderkohe Albtelecom i referohet edhe ligjit, se detyrimet e vendosura duhet ti leje operatorit normen e arsyeshme te fitimit duke perfshire edhe riskun. Në lidhje me pëngesat strukturore Albtelecom i referohet ATU dhe qellimit të saj të ndërtimit të rrjetit, i cili është ndërtuar për ti shërbyer operatorëve në nivel shumicë duke qënëse ATU nuk ka pajtimatarë me pakicë. Leja e ATU dhënë nga MPPT përcakton së një pjesë e rrjetit fibër do të shërbeje për operatorët e tjerë dhe kërkesat e tregut tregojen se ATU mund ta përballojë këtë kërkesë duke qënëse kjo kërkesë nuk është më e madhe se oferta. Vendosja në rreguulim e këtij tregu dhe kontrolli i tarifave, nuk marrim në konsideratë kostot e ndërtimit nga të cilat varët nga disa faktorë të cilat nuk lejojnë arritjen e eficiencës së Albtelecom dhe operatorët kërkues të aksesit të përbashket në tubacion. Ndaj si rrjedhim për Albteleocn nuk plotësohet kushti i dytë. Në lidhje me kushtin e trete Albtelecom citon se në AK nuk janë adresuar problematika të tilla, por vec kësaj ligji Nr. 9121, parashiko qartë dhe ka dispozita për të adresuar këtë problem.

PLUS

PLUS është dakord me përfundimin e AKEP se tregu me shumicë i aksesit në infrastrukturë pasive (tuba, dark fiber etj) në nivel kombëtar plotëson të tre kriteret për të qënë i justifikuar për ndërhyrje ex-ante, pasi ka pengesa të larta ligjore dhe ekonomike për hyrjen në të e për rrjedhoje vetëm dy ofrues aktuale në nivel kombëtar Albtelecom dhe ATU, të cilët plotësojnë kushtet për dominancë të bashkuar në këtë treg. Sa më lart, PLUS është dakord me ndërhyrjen e AKEP në këtë treg dhe vendosjen e masave përkatëse rregullatore në nivel shumice dhe pakicë.

TELEKOM ALBANIA

Tregu me shumicë i aksesit në infrastrukturën pasive në nivel kombëtar nuk është pjesë e listës së tregjeve nën rregullim as në listën e rregullores për analizën e tregjeve, as të asaj sipas Rekomandimit të KE-së të vitit 2014. Ndaj është e nevojshme kryerja e testit të 3 kritereve për të përcaktuar nëse ky treg ka nevojë për një ndërhyrje rregullatore ex-ante.

Telekom Albania mendon se tregu me shumicë i aksesit në infrastrukturën pasive në nivel kombëtar është i justifikueshëm për ndërhyrje rregullatore ex-ante duke qënë se plotëson të treja kriteret e testit.

VODAFONE ALBANIA

Vodafone mbështet analizën e AKEP dhe faktin që tregu me shumicë i aksesit në infrastrukturë pasive (tuba. dark fiber, etj) duhet të jetë i rregulluar, edhe pse nuk është identifikuar në këtë përkufizim të veçantë nga Rekomandimi i KE 2014 si treg i rekomanduar për rregullim ex-ante. Por praktika europiane e ka rregulluar këtë treg duke e përfshirë atë brenda konceptit të WLA.

AKEP duhet ta monitorojë me kujdes tregun dhe në menyrë të vazhdueshme, dhe të ndërhyjë kur e sheh të nevojshme nëpërmjet kryerjes së testit të 'margin squeeze'. Vodafone gjykon se tregu shqiptar e ka të domosdoshëm që të jete plotësisht i rregulluar në nivel aksesi lokal, kurse për aksesin në infrastrukturë pasive (tuba, dark fiber, etj) të garantohet e drejta për akses, kurse rregullimi i tarifave është i rendësisë dytësore.

Qëndrimi i AKEP

Ne vijim te komenteve te keshillimit publik dhe zhvillimeve ne treg ne lidhje me aksesin ne infrastrukturen fizike (pasive), perfshire miratimin dhe hyrjen ne fuqi te ligjit 120/2016, AKEP vlereson si te arsyeshme qe te ri-konsideroje perfundimet per kete treg, duke pasqyruar keto vleresime ne dokumentin perfundimtar te analizes se tregut.

6. A jeni dakort me përfundimin e AKEP se Albtelecom përmbush kriteret për FNT në:

1. Tregun me shumicë të aksesit në nivel lokal në vendndodhje fikse (WLA)
2. Tregun me shumicë të aksesit në nivel qendror për produkte të tregut të përgjithshëm (WCA)
3. Tregun me shumicë të aksesit me cilësi të lartë në vendndodhje fikse (WHQA)

ALBTELECOM

1. Albtelecom shpreh mosdakortësinë e tij për përcaktimin e AKEP se Albtelecom përmbush kriteret për FNT në tregun me shumicë të aksesit në nivel lokal në vendndodhje fikse (WLA).

   Për më tepër, bazuar në kriteret e parashikuara në nenin 33, pika 1 e 2 e Ligjit për Telekomunikacionet për tu shpallur operator me FNT në një treg të caktuar, Albtelecom parashtron si më poshtë:

   - Në mungesë të plotë të kërkesës për akses LLU pavarësisht pozitës së tij, Albtelecom nuk mund ketë asnjë lloj zgjerimi, për më tepër të ndjeshëm, në të kundërt të parashikimeve në pikën 1 të nenit 33, si pasojë e kësaj mungese praktikisht bëhet i pamundur zhvillimi i elasticitetit të kërkesë ofertës;
   - Pavarwsisht detyrimit nga AKEP nuk ka refuzim pwr akses nga ana e Albtelecom;
   - Nje pjesë e operatorëve kanë zgjedhur përgjithësisht të ndertojne rrjetet e veta, dhe të marrin nga Albtelecom sherbime të tjera të infrastrukturës, pra kanë zëvendësuar aksesin në LLU me shërbime të tjera, si bitstream;
   - Persa i takon integrimit vertikal, është me se e qartë se Albtelecom ka zhvilluar politikat e tij tarifore në tregun e pakicës totalisbt i pandikuar nga përcaktimet rregullatore në nivel shumice, dhe plotësisht i ndikuar nga konkurrenca efektive dhe zhvillimet në tregun e pakicës.
   - Pra adresimi i problematikave në tregun e aksesit LLU dhe arritja e konkurrencës eficiente në një treg ku nuk ka kërkesë për shërbimin e tregtuar, ku pritshmeritë që prej 5 vitesh dhe zhvillimet e tregut tregojnë për mungese në vazhdimesi të saj, nuk mund të bëhen duke përcaktuar Albtelecom si operator FNT në këtë treg.

   Në përfundim, Albtelecom mendon se nuk i përmbush kritetret për FNT në tregun e aksesit LLU.

2. Duke u nisur nga rrethanat dhe zhvillimet më të fundit në tregun e aksesit broadband, WCA sipas ri-përkufizimit të ri, Albtelecom nuk është dakort me përfundimin e AKEP se Albtelecom është FNT në këtë treg. Kështu bazuar në kriteret e parashikuara në nenin 33, pika 1 e 2 e Ligjit për Telekomunikacionet për t`u shpallur operator me FNT në një treg të caktuar, Albtelecom parashtron si më poshtë:
   - Megjithë ecurinë pozitive të numrit të kërkesave për shërbimin Bitstream që prej vitit 2014 e në vazhdim, duke qënë se një pjesë e operatorëve kryesisht kanë ngritur rrjetet e veta, dhe në kushtet kur kërkesat e përdoruesve fundor nuk janë në shifra të konsiderueshme në rritje,

ofrimi i këtij shërbimi në nivel shumicë nuk i mundëson Albtelecom zgjerim të ndjeshem pavarësisht nga konkurrentët, klientët apo përdoruesit fundorë.

- Në zbatim të detyrimit për rregullimin e tarifave në këtë treg, në vitin 2014 ofrimi i shërbimeve nga Albtelecom u shoqerua edhe me reduktime drastike të tarifave të deklaruara të Albtelecom. Ndërsa në vitin 2015, i ndikuar nga kërkesat e operatorëve, për të nxitur marrjen e këtij sherbimi nga ana e tyre, me iniciativë të vet Albtelecom ndërmori një proces të përditësimit të tarifave duke njoftuar zyrtarisht në AKEP dhe publikuar në faqen e tij zyrtare tarifat e reja të reduktuara deri në 28% për nivelin Ethernet, dhe deri ne 23% per nivelin IP.
- Albtelecom ka nenshkruar 5 kontrata bitstream dhe nuk ka pasur mosmarreveshje apo ankesa, si rrjedhim tarifat janw tw volitshme dhe nw tw njwjtwn kohw ligji i ofertw-kwrkesws funksionan duke dhwnw indikacion qw ka konkurrencw efektive
- Fuqia kundwrvepruese e bleresve tw kwtij shwrbimi sa vjen dhe rriet
- Zhvillimi i sherbimeve broadband nw tregun mw pakicw qw lidhet direkt me tregun me shumice ka shfaqur zhvillime pozitive.

Eshtë e qartë se masat rregullatore kanë arritur qëllimin për të cilat janë vendosur nga AKEP në vitin 2014 dhe tashmë, më shumë se sa rregullimet e AKEP jane ligjet bazë të ekonornisë së tregut kerkesë-ofertë që kanë përcaktuar sjelljen e Albtelecom në treg, ofrimin e tarifave të reja më të leverdisshme, discount-et për numër të madh portash, etj. Për të gjithë arsyet e renditura më sipër Albtelecom cmon se nuk eshtë FNT në tregun me shumicë të aksesit në nivel qëndror për produkte të tregut të përgjithshëm (WCA).

3. Albtelecom nuk është dakort me përcaktimin si operator FNT në tregun me shumicë të aksesit me cilësi të lartë në vendndodhje fikse (WHQA).

Në vijim, për të mbështetur mosdakortësinë e tij lidhur me gjetjen e AKEP dhe duke qënë se AKEP i është referuar Analizës së mëparshme në analizimin e këtij tregu, Albtelecom ka gjykuar mbi pjesën kryesore të kritereve sipas nenit 33, pika 2 e Ligjit për Komunikimet Elektronike, të cilat janë analizuar më gjerësisht në analizën e mëparshme të AKEP (Viti 2014).

- Nga vlerësimi për pjesët e tregut për linjat me qera me shumicë rezulton që Albtelecom e ka redukruar në mënyrë drastike me më shumë se 25% pjesën e tij të tregut krahasimisht me atë të vitit 2011 (që është dhe infomacioni më i fundit nga AKEP). Ndryshimi në pjesën e tij të tregut është gjithashtu i lidhur edhe me vendimin e Albtelecom për përditësimin e tarifave të linjave me qera dhe reduktimin e tyre me 70-90%. Pra bazuar në sa më siper Albtelecom nuk ka dominancë në tregun me shumicë të linjave me qera.
- Duke vlerësuar si pengesa të mundshme pengesat strukturore dhe ekonomike, pengesat e kushtëzuara nga parimi i asnjanësisë, pengesat e natyrës ligjore, avancimet e teknologjisë (4G /3G), dhe mosprezencën e plotë të Albtelecom në tërë territorin e vendit, tregu me shumicë i aksesit me cilësi të lartë në vendndodhje fikse (ËHQA) lejon hapesirat e duhura edhe për ofrues të tjerë, pra Albtelecom nuk është operator me FNT.
- Rritja e fuqisë kundërvepruese për blerjen në tregun me shumicë të aksesit me cilësi të lartë në vendndodhje fikse (konkretisht shërbimi i linjave me qira), e ka zbehur gjithmonë e më shumë dominancën e Albtelecom në këtë treg. Prezenca e operatoreve te rrinje dhe mundësia e perdorimit te teknologjise 3G/4G dhe ofrimit te shërbimit bazuar në këtë teknologji e kanë dobesuar fuqine e lartë të negacionit te Albtelecom
- Tarifat e zbatuar nga Albtelecom kanë pasu synuim tq qënurit proaktiv në treg për të garanruar konkurence dhe marzh fitimi të operatorëve të tjerë që mbeshteten në shërbimin më shumicë të Albtelecom. Albtelecom iu referohet të dhënave të statistikore dhe argumenton qe nuk krijon pengesë në treg, nisur nga numri i lartë i kontratave/linjave që kanë konkurentet e tij ne kete treg.

Albtelecom gjykon se dominanca individuale e Albtelecom në këtë treg është zvogëluar në mënyrë sinjifikative, dhe Albtelecom nuk përmbush kriteret për FNT në tregun me shumicë të aksesit me cilësi të lartë në vendndodhje fikse (WHQA).

PLUS

PLUS është dakort me përfundimin e AKEP se Albtelecom përmbush kriteret për FNT në tre tregjet e mësiperme.

TELEKOM ALBANIA

Situata në këto tregje nuk ka ndryshuar gjatë këtyre dy-tre viteve të fundit dhe problematikat në këto tregje (edhe pse të riformuluara) mbeten të njëjta: prezencë lokale në territor (kryesisht në zonat me dendësi të madhe popullsie) e operatoreve alternativë me rrjetin e tyre, nivel i lartë i prezencës së Albtelekom në nivel kombëtar dhe lokal në terma të shtrirjes së rrjetit, numrit të lartë linjave të aksesit për përdoruesit fundor (70%), numër më të madh pajtimtarësh krahasuar me konkurrentet e tjerë, etj, që përforcojnë pozitën dominante të Albtelekom në tregjet e mësipërme me shumicë. Bazuar në situaten në të cilën ndodhen këto tregje dhe në faktorët që i karakterizojnë ato, niveli i konkurrencës është i dobët dhe Telekom Albania gjykon se operatori Albtelecom i përmbush kriteret për FNT në të treja tregjet me shumicë të aksesit në nivel lokal në vendndodhje fikse (WLA), në nivel qendror për produkte të tregut të përgjithshëm (WCA) dhe të aksesit me cilësi të lartë në vendndodhje fikse (WHQA).

VODAFONE ALBANIA

Vodafone Albania mbështet përfundimin e AKEP se operatori inkumbent është operator me fuqi të ndjeshme në tregun me shumicë të aksesit në nivel lokal në vendndodhje fikse (WLA), të aksesit në nivel qendror për produkte të tregut të përgjithshëm (WCA) dhe të aksesit me cilësi të lartë në vendndodhje fikse (WHQA) dhe si i tillë duhet ti nënshtrohet detyrimeve rregullatore që parashikon Ligji 9918. Vodafone është e mendimit se detyrimi për akses në bistream mbi operatorin inkumbent duhet të qendrojë, deri në momentin që ky treg të shfaq shenja konkurrence të qëndrueshme.

Qëndrimi i AKEP

Lidhur me komente e Albtelecom, AKEP sqaron se:

Pavarësisht zhvillimit të infrastukturave paralele ne pjesen lokale, në mungese të heqjes se LLU Albtelecom eshte ofruesi i vetem potencial, duke qene se asnje operator nuk ka njoftuar per ofrim të këtij shërbimi deri tani. Nje operator mund të përdore aksesin fizik per te prodhuar ate jofizik, ndaj ky faktor eshte kyc në zhvillimin e produkteve virtuale. Duke qene se aksesin me shumice ne qarkun lokal Albtelecom eshte i vetmi që ofron dhe nga te dhena rezulton se edhe ne aksesin me pakice broadband ka pjesen me te madhe te tregut rreth 40%, kjo con ne perfundimin se mund te ushtroje nje pozite dominuese individuale. AKEP është i mendimit se kostoja e rrjetit të bazuar në kabllo bakri/fibrash, e kombinuar me koston e rrjetit të tubacioneve, të cilat janë të nevojshme për të hyrë në tregun përkatës dhe nuk mund të rikuperohen me daljen nga tregu te hyresive te rinj, pra paraqesin një pengesë të lartë të hyrese ne tregjet relevante dhe të lidhura.

Konkurenca potenciale mund të krijohet nga operatorët alternativë, kur ata janë në gjendje të ofrojne produkte dhe shërbime për akses me shumicë. Me qëllim krijimin e konkurrencë të barabartë mes të gjithë pjesëmarrësit e tregut është e nevojshme të sigurohen kushte të tilla në mënyrë që ofruesit e mundshëm të shërbimeve te aksesit me shumicë të jetë në gjendje të zhvillojnë rrjetin e tyre pa hasur presion nga incumbent-i, por për shkak të faktit, se per ofrimin e shërbimeve në tregun përkatës është e nevojshme prania e infrastrukturës te pershtatshme, ndërtimi i saj është i kushtushme dhe eshte nje procesi i gjatë e i komplikuar. Si rrjedhim AKEP gjykon se është shumë e vështirë për zhvillimin e konkurrencës potenciale në tregun me shumicë të aksesit lokal nga vendodhje fikse brenda një periudhe relativisht të shkurtër kohe.

Në lidhje me komentin e Albtelecom për fuqine kundër vepruese me fillimin e ofrimit të shërbimeve bazuar në teknologji 4G, AKEP gjykon se pavarësisht përmirësimeve në ofrim të shërbimeve që ka ofruar përsëri për aksesin nga rrjetet celulare 4G mbeten në fuqi karakteristika e dallueshme të këtij aksesi duke u kombinuar me mbulimin e dobët të rrjetit LTE, kështu që AKEP i qëndron mendimit ky lloj aksesi(pa tel) është mjaftushëm komplementare me LLU dhe Bitstream(me tel) dhe nuk është në një treg me LLU dhe Bistream, duke e argumentuar përgjigjen e saj në dokumenti e analizës. Si rrjedhim Albtelecom mbetet i vetmi operator që ka potencial dhe kapacitet të ofroje LLU, Bitstream, linja me qera, akese në rrjet tubacioni dhe të gjithe produkete ekuivalente me to.

Për të njëjtat arsyje të cituara më lart edhe në tregun WCA dhe WHQA Albtelecom ka pozitë dominuese dhe rezulton një operator me FNT.

Pra nga sa argumentuar mësiper dhe gjithashtu bazuar edhe në faktoret e analizaur në dokumentin e Analizes, AKEP i qëndron gjykimit të tij se Altelecom është FNT në këto tre tregje.

7. Cfarë mendoni për masat rregullatore të propozuara nga AKEP për Albtelecom në tre tregjet e cituar më sipër në pyetjen 6?

ALBTELECOM

Albtelecom ka argumentuar sipas tregjeve respektive se masat rregullatore të propozuara nga Albtelecom jane barrë e rënde për operatorin, jo proporcionale dhe nuk justifikojnë qëllimin për të cilin kërkojnë të vendosen. Në mënyrë specifike, ngarkimi nga ana e AKEP me detyrime rregullatore në lidhje me tubacionet në nivel lokal dhe veçanërisht edhe në nivel kombëtar është i papranueshem, i pajustifikuar dhe bie ndesh me nenin 34, pika 5 e Ligjit për Komunikimet Elektronike dhe Direktivën Kuadër të EU mbi Komunikimet Elektronike.

Një koment më të zgjeruar për këtë pyetje ka dhënë në pjesën hyrëse të qëndrimit të tij ndaj detyrimeve rregullatore, dukë mos pranuar asnjë masë rregulluese. Të përmbledhuar këto komente konsistojne në: mospasjen interes nga tregu per LLU dhe nuk ka pasur mosmarrveshje; bitstream ka ecur pozitivish; aksesi ne rrjetin e tubacionieve është i rregulluar nga dispozita ligjore; AKEP nuk ka marrë parasysh rekomandimet dhe direktivat e BE; qëndrimi i Albtelecom ka qënë proaktiv në treg, duke kundershtuar edhe tarifat e vendosura për keto shërbime.

PLUS

PLUS shprehet dakort me masat rregullatore të propozuara nga AKEP për Albtelecom në tre tregjet e cituar me sipër, pasi ky operator plotëson kriteret për FNT dhe ka pozitë dominuese individuale në treg. Ndërkohë nuk jemi dakord në lidhje me propozimin e AKEP për heqjen e detyrimit të ndarjes së llogarive (AS/CA) si dhe të detyrimit për përditësimin e RUO, pasi Albtelecom është operator me fuqi të ndjeshme në tregun me shumicë të aksesit në nivel lokal (WLA) , dhe si tille duhet ti nënshtrohet të gjithë detyrimeve rregullatore që parashikon Ligji 9918 përfshirë dhe detyrimin për ndarjen e llogarive dhe përditësimin e RUO-s së tij.

TELEKOM ALBANIA

Për shkak se Albtelecom si operatori më i madh ka një pozitë dominante në të tre tregjet e aksesit të përmendur në pyetjen nr.6 më sipër, Telekom Albania shprehet në favor të masave rregullatore të propozuara nga AKEP për operatorin Albtelecom, në përputhje me kuadrin rregullator dhe me situatën në të cilën operohet në të treja tregjet e aksesit me shumicë broadband nga një vendndodhje fikse.

Por Telekom Albania kërkon që detyrimi në lidhje ndarjen e llogarive (AS/CA) në tregun me shumicë të aksesit lokal (WLA) dhe të tregut me shumicë të aksesit me cilësi të lartë (WHQA) të mos hiqen duke mos qënë dakort me propozimin e AKEP, i cili e bazon heqjen e kësaj mase me kostot e larta të implementimit të saj por duke mos sjellë asnjë evidencë në lidhje me keto kosto, përllogaritjet e tyre dhe se si është arritur në një përfundim të tillë për të marrë këtë propozim.

VODAFONE ALBANIA

Vodafone Albania mbështet përfundimin e AKEP se operatori inkumbent është operator me fuqi të ndjeshme në tregjet e identifikuar dhe si i tillë duhet ti nënshtrohet detyrimeve rregullatore që parashikon Ligji 9918. Në rast të heqjes së detyrimit për ndarjen e llogarive si detyrim i rregullimit të tregut me shumicë të aksesit në nivel qendror për produkte të tregut të përgjithshem (WCA), AKEP duhet paralelisht të garantojë monitorimin e këtij tregu dhe përdorimin e testit 'margin squeeze' sa herë që të nevojitet, për të shmangur mundësitë për sjellje antikonkurruese nga operatori me pozitë dominuese.

Qëndrimi i AKEP

Në lidhje me komente e sjella nga Albtelecom për këtë pyetje AKEP pranon vetëm revokimin e detyrimit per akses ne tubacione/fiber optike ne nivel urban ne tregun e aksesit ne nivel qendror(WCA), sepse në aksesin qendron nuk ka nevoje për akses në infrastrukture lokale, pasi mund te aksesohesh virtualisht nga aksesi qendror. Gjithashtu nisur edhe nga ndryshimet e ndodhura ne treg gjate kohes kur dokumenti ka qene per keshillim publik, te cilat AKEP i ka sqaruar hollesisht ne dokumentin perfundimtar te analizes, vleresoi te ri-konsideroje edhe qendrimin e tij ne lidhje me tregun e infrastruktures pasive nder-urbane (kombetare) Në lidhje me detyrimet e tjera AKEP gjykon se janë vendosur në mënyrë proporcionale dhe të drejte. Më shumë argumenta janë dhënë në qëndrimet e mësipërme dhe në dokumentin perfundimtar te Analizës se tregut.

Në lidhje me pretedimin se aksesi në tubacione nuk është pjëse e Rekomandimit 2014 AKEP shpjegon se aksesi ne infrastrukture fizike ne nivel lokal (WLA) eshte pjese e rekomandimit 2014, dhe perfshin dhe aksesin ne tuba ne nivel lokal, dhe ne shumicen e vendeve europiane ky akses eshte i rregulluar dhe me detyrime per FNT per te dhene akses dhe me tarifa nen-rregullim. Bazuar edhe ne praktikat më të mira Europiane si dokumneti i BEREC "*Monitoring implementation of the BEREC Common Positions on Wholesale Local Access (WLA), Wholesale*

Central Access (WCA) and Wholesale High Quality Access at a Fixed Location (WHQAFL), BoR(15) 199" dhe kushteve te tregut ne Shqiperi, duke qarte qe vetem rregullorja Nr.35 nuk i adreson dot problemet qe mund te lidhin ne dhenie e askesit lokal si ne infrastukrure aktive ashtu edhe pasive. Si rrjedhim i ketyre qe permendem me siper dhe te argumentuara edhe ne dokumentin e analizes, AKEP, ne vendosjen e masa rregullatore, ka marre parasysh te gjithe faktoret e mundshem, perfshire Rregulloren nr.35, dhe ka vendosur masa detyruese te argumentuar mbi kushte aktuale te tregut dhe kopetencave qe i lejon ligji.

AKEP gjithashtu sqaron 3 operatorët e tjerë se revokimi i detyrimit për ndarje llogarie është bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe ne raport me masat rregulluese ne tregjet e tjere dhe në bazë të një analize cost-benefits.

8. A jeni dakort me përfundimin e AKEP se Albtelecom dhe ATU përmbushin kriteret për FNT në Tregun me shumicë të aksesit në elementët pasivë të infrastrukturës e rrjeteve fikse në nivel kombëtar

ALBTELECOM

Albtelecom ka shprehur së pari, në pjesën e konsideratave të përgjithshme mosdakortësinë e tij për rregullimin e tregut me shumicë të aksesit në elementët pasive të infrastrukrurës së rrjeteve fikse. Për më tepër, Albtelecom nuk është dakort me përfundimin e AKEP se Albtelecom përmbush kriteret për FNT në këtë treg.

Kështu bazuar në kriteret e parashikuara në nenin 33, pika 1 e 2 e Ligjit për Telekomunikacionet për tu shpallur operator me FNT në një treg të caktuar, Albtelecom parashtron si më poshtë:

- Duke marrë në konsideratë numrin e ulët të kerkesave për akses në tubacione në vite, duke qënë se pjesa më e madhe e operarorëve kryesisht operojnë brenda një zone gjeografike të caktuar pa patur nevojë të marrin shërbimin e aksesit të përbashket në tubacione nga Albtelecom, ofrimi i ketij shërbimi në nivel shumice realisht nuk i mundëson Albtelecom zgjerim të ndjeshëm pavarësisht nga konkurrentët, klientët apo përdoruesit fundorë.
- Faktori fuqi kundërvepruese për blerjen në tregun me shumicë të aksesit të përbashket në tubacione është një faktor që duhet marrë në konsideratë, pasi prezenca e ofruesve të rinj është rritur dhe kjo e ka minimizuar dominancën e Albtelecom në këtë treg.
- Lidhur me tarifimin e kwtij shërbimi dhe sjelljen e Albtelecom në treg është e rëndësishme të risjellim në vëmendje se Albtelecom është treguar proaktiv dhe ka ndërmarrë të paktën 2 herë ulje të tarifave të tubacioneve pavarësisht numrit të pakët të operatorëve që zotërojnë kapacitete të lira në infrastrukturë pasive. Rrjedhimish ndërmarrja e iniciativave të uljes së tarifave të këtij shërbimi dhe trajtimi komercial i tyre rast pas rasti duke ofruar tarifa edhe me të ulta tregojne se Albtelecom nuk është me fuqi të ndjeshme në treg.
- Duke konsideruar dhe kërkesën e ulët për shërbime në shërbimet me shurnicë të Albtelecom si pasojë edhe e ngritjes së infrastrukturave/ rrjeteve të veta nga një pjesë operatoresh, Albtelecom është shumë larg arritjes dhe përfitimit nga ekonomizimet e shkallës, ekonomitë e sektorit etj.
- Lidhur me fazën në tregun përkatës, nga ecuria e këtij tregu në këto vite, fluksi i kërkesave për këtë shërbim ka qënë i ulët dhe Albtelecom patjeter që i ka ofruar shërbim cdo operatori kërkues sa kohë që këto kërkesa kanë qënë të mundshme për dhënie aksesi nga Albtelecom, pa sforcuar operimin në rrjetin e tij.
- Lidhur me zhvillimin e elasticitetit të kërkesës dhe ofertës për këtë shërbim, Albtelecom ka vlerësuar rast pas rasti dhe ka negociuar me operatorët kërkues termat komerciale të këtij shërbimi, duke u treguar fleksibel dhe duke gjykuar me perparësi kërkesën, vendndodhjen e tubacionit, gjatesinë, mundesinë e Albtelecom, kostot perkatëse të mirëmbajtjes, etj duke u treguar elastik dhe duke ofruar tarifa edhe më të leverdisshme.

Në përfundim, Albtelecom gjykon se sipas dhe kritereve të analizuara më sipër, Albtelecom nuk është me fuqi të ndjeshme në FNT në Tregun me shumicë të aksesit në elementet pasive të infrastrukturës e rrjeteve fikse.

PLUS

PLUS është dakort me përfundimin e AKEP se Albtelecom dhe ATU përmbushin kriteret për FNT në Tregun me shumicë të aksesit në elementët pasivë të infrastrukturës e rrjeteve fikse në nivel kombëtar, pasi këta operatorë kanë një dominancë të bashkuar bazuar në sa me poshtë:

- Këta dy operatorë janë ofrueit e vetëm të infrastrukturës pasive në nivel kombëtar;
- Kanë në përdorim kapacitete të mëdha të tubacioneve, por përdorimi i tyre është shumë i ulët;
- Tarifat e aksesit në tubacione aplikuar për operatorët e tjerë (nga Albtelecom) janë shumë të larta krahasuar me vendet e tjera;
- Tarifat e aplikuara nga këta operatore nuk jane publike dhe transparente.

Sa më lart, gjykojmë se këta dy operatorë kanë një dominancë të bashkuar në Tregun me shumicë të aksesit në elernentët pasivë të infrastrukturës e rrjeteve fikse në nivel kombëtar dhe plotësojnë të gjitha kriteret për FNT në këtë treg dhe vendosjen e masave përkatëse rregullatore.

TELEKOM ALBANIA

Duke qënë se të vetmit operatorë që kanë shtrirje të rrjetit në pjesët ndërurbane dhe në akset kryesore të rrugëve nacionale janë Albtelecom dhe ATU, në mungesë të prezencës së operatorëve të tjerë në tregun me shumicë të aksesit në elementët pasivë të infrastrukturës së rrjeteve fikse në nivel kombëtar, ky treg karakterizohet nga një situatë e dominancës së bashkuar nga të dy operatorët.

Për rrjedhojë, sic dhe është evidentuar dhe në këtë analizë kemi një mungesë të konkurrencës, gjë e cila e bën të domosdoshme ndërhyrjen rregullatore dhe marrjen e masave përkatese nga ana e AKEP për të adresuar problematikat që shkaktohen nga mospasja e konkurrencës në këtë treg me një situatë duopoli të dominuar nga Albtelecom dhe ATU.

Në këtë mënyrë, referuar situatës aktuale në të cilën ndodhet tregu me shumicë i aksesit në elementët pasivë të infrastrukturës së rrjeteve fikse, Telekom Albania gjykon se të dy operatoret i përmbushin kriteret për FNT në këtë treg.

VODAFONE ALBANIA

Vodafone Albania ndan të njëjtin mendim me AKEP në lidhje me analizen e operatorëve që shfaqin fuqi të ndjeshme në treg; megjithatë propozimi ynë është që tregu i backbone nuk duhet rregulluar në nivelin e tregjeve të tjera më sipër pasi shfaq premisa për konkurrencë ne të ardhmen e afërt. Në vend të saj AKEP duhet të monitorojë tregun për të shmangur sjelljet antikonkurruese, nëpermjet testit të margin squeeze.

Qëndrimi i AKEP

AKEP sqaron se, bazuar ne zhvillimet e tregut gjate periudhe se keshillimit publik te dokumentit, ne komente e sjella nga operatoret, ka vleresuat te ri-konsideroje vleresimin per kete treg, duke argumentuar veprimet e tij dhe duke pasqyruar ndryshimet ne dokumenti perfundimtar te analizes se tregut.

9.Cfarë mendoni për masat rregullatore të propozuara nga AKEP për Albtelecom dhe ATU për aksesin në tubacione/dark fiber? A janë të mjaftueshme për të adresuar problmenin e përdorimit të ulët në nivel kombëtar të tubave?

ALBTELECOM

Propozimi i AKEP për të përkufizuar një treg të ri për infrastrukturën kombëtare dhe vendosja e detyrimeve përkatëse specifikisht për Albtelecom, ishte objektivisht jashtë çdo pritshmërie të Albtelecom dhe e pambështetur nga kuadri ligjor dhe rregullator për komunikimet elektronike.

Argumenta shtesë për këtë pyetje Albtelecom ka pasqyruar në qënrimin për gjithe dokumentin e Analizës. Ndërsa veçanërisht në lidhje me detyrimin për rregullimin e tarifave në këtë treg, Albtelecom shpreh kundërshtimin e tij duke argumentuar qëndrimin e tij në pergjigje të pyetjes 4.

Vendosja në rregullim e aksesit ne fibres nuk eshte e pajustifikueshme. Ky akses iu eshte ofruar operatoreve celulare dhe nuk e kane preferuar duke qene se kanë pasur mundësi zgjedhje të tjera. Albtelecom shprehet skeptik ne lidhje me perfitimiet qe mund te kene AO për të zgjeruar zonat e sherbimit nga urban ne nderurban duke qene se liberalizimi i tregut iu dha mundesi të shkojne edhe ne zona ku Albtelecom nuk ka rrjet. Problem per Albtelecom janë lejet per ndertimin e infrastruktures që shume AO i kanë përfituar më lehte se Albtelecom. Sturktura e rrjeti Albtelecom ka vend vetem per nje fiber tjeter e cila do te perdoret per back up per qellime te veta dhe ndertimi i saj ndryshon nga ai në nivel lokal, sespe nuk eshte e ndertuar me bateri. Ky treg eshte i

rregulluat tashme nga Rregulloreja nr.35 dhe detyrimi i vendosur i rrit barrren duke mos marre parasysh investimet e kryera. Albtelecom i referohet Direktivave te BE dhe kerkon te vendoset rregullim simetrik per te gjitha operatoret e infrastrukturave të tjera.

PLUS

Në lidhje me masat rregullatore të propozuara nga AKEP per Albtelecom dhe ATU për aksesin në tubacione/dark fibër, gjykojmë se këto masa janë të detyrueshme për tu aplikuar për të adresuar problemin e përdorimit tëulët në nivel kombëtar të tubave, pasi është i domosdoshëm aplikimi i masave rregullatore të detyrimit për transparencë në publikimin einformacionit për tarifat, dhënie informacioni për hapësirat e lira në tubacione/fibra optike në nivel kombëtar (lidhjet ndër-urbane), si dhe detyrimi për rregullimin e tarifave të aksesit në këtë infrastrukturë pasive duke ulur tarifat. PLUS gjykon se përdorimi shume i ulët i tubacioneve është për shkak të tarifave të larta të pa rregulluara të aplikuara deri më tani dhe vendosja e këtij detyrimi do të rrisë përdorimin e tyre dhe konkurrencën në këtë treg.

TELEKOM ALBANIA

Telekom Albania shprehet dakort në lidhje me masat rregullatore që duhen aplikuar për aksesin në tubacione/dark fibër për të dy operatorët Albtelecom dhe ATU duke mbajtur parasysh se janë të vetmit operator që dominojnë plotësisht këtë treg aksesi në nivel kombëtar. Vendosja e këtyre masave është e domosdoshme për të shmangur çdo lloj forme abuzimi apo mungese trasparence që mund të rrjedhin nga dominimi i tregut nga këta operatorë si dhe për të nxitur dhe rritur konkurrencën në treg.

VODAFONE ALBANIA

Në lidhje me këtë pyetje Vodafone ka dhene pergjigje te argumentuar në pikën 8.

Qëndrimi i AKEP

Ne vijim te komenteve te keshillimit publik dhe zhvillimeve ne treg ne lidhje me aksesin ne infrastrukturen fizike (pasive), AKEP vlereson si te arsyeshme qe te ri-konsideroje perfundimet per kete treg, per arsyet e dhena me hollesi ne dokumentin perfundimtar te analizes. AKEP vlereson se perdorimi individualisht apo ne kombinim i procedurave te zgjidhjes se mosmarrveshjeve sipas akteve te ligjore te permenduar ne dokument, perfshire informacionit per tarifat e aksesit ne tuba dhe rregullimit te tyre ne nivel lokal/urban, jane aktualisht te mjaftueshme per adresimin e problematikes se mundshme per aksesin ne tuba ne nivel kombetar (zonat nder-urbane) per te gjithe operatoret, pavaresisht statusit me FNT ose jo.

10. Cfarë masash/veprime shtesë gjykoni se mund të ndërmarrë AKEP për të rritur konkurrencën dhe njëkohesisht stimujt për investime në rrjetet fikse për akses broadband?

ALBTELECOM

AKEP duhet të vlerësojë maksimalisht investimet e Albtelecom dhe të mos bëhet pengesë për kthimin e investimit të Albtelecom duke i vendosur detyrim për rregullim të tarifave minimaliste në çdo treg të mundshëm pasi në të kundërt do të jetë e pamundur për Albtelecom të vazhdoje me planet e tij ambicioze për tregun shqiptar, për materializimin e të cilave duhen investuar me miliona euro të tjerë dhe njëkohësisht do i duhej të përballej me një pozicion tejet të dobët në treg.

Ndërsa Albtelecom detyrohet të përballet me detyrime të tepërta rregullatore, operatorë të tjerë dominante në tregun e komunikimeve elektronike apo edhe operatorë të tjerë alternativë vazhdojne rritjen e nivelit të ardhurave duke gëzuar statusin me FNT së shumti vetëm në 1 treg në pritje për përfitimin e shërbimeve " në kurriz" të Albtelecom.

Gjithashtu, AKEP duhet të sigurojë mbledhjen e plotë dhe të saktë të të dhënave për të ofruar një panoramë sa më të qartë të tregut dhe gjithashtu të sigurojëmos ofrimin e shërbimeve të kornunikimeve elektronike në informalitet, çka shkakton konkurencë të pandershme në dëm të operatorëve si Albtelecom që përveçse duhet të përballet me kësi rastesh duhet njëkohësisht të sigurojë zbatimin korrekt të detyrimeve ligjore dhe rregullatore.

TELEKOM ALBANIA

Në lidhje me këtë pyetje Telekom Albania nuk ka ndonjë sugjerim për masa të tjera rregullatore.

Qëndrimi i AKEP

Në lidhje me komente e Albtelecom AKEP sqaron se ka marrë parasysh të gjithë faktorët, përfshirë edhe investimet e tij. Heqja e disa masave si ndarja e llogarive dhe disa masave te propozuar ne fazen e keshillimit, evidentojnë faktin që vendosja e masave rregullatore është bërë në bazë të legjislacionit dhe kritereve perkatese. Ne lidhje me tarifat, komentet jane marre ne konsiderate ne dokumentin "*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT ne tregjet me shumice te aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse-Dokumenti Perfundimtar",* i cili miratohet pas nje procesi keshillimi publik te kryer paralelisht me dokumnetin e Anlizes se Tregut nga AKEP.